



NGA LETRA NË PRAKTIKË

KOSOVA DUHET T'I PËRMBUSHË ZOTIMET NDAJ TË MBIJETUARAVE
TË DHUNËS NË FAMILJE

AMNESTY
INTERNATIONAL



Amnesty International është lëvizje e 10 milion njerëzve që mobilizon njerëzimin e secilit dhe bën fushatë për ndryshim që të gjithë t'i gëzojmë të drejtat e njeriut. Vizioni ynë është për një botë ku ata që janë në pushtet i mbajnë premtimet, e respektojnë të drejtën ndërkombëtare dhe mbahen përgjegjës. Ne jemi të pavarur nga çdo qeveri, ideologji politike, interes ekonomik dhe financohemi kryesisht nga anëtarësimi dhe donacionet individuale. Ne besojmë se kur veprojmë në solidaritet dhe bashkëndejmë me njerëzit gjithkund mund t'i ndryshojmë shoqëritë tona për të mirë.

*Përveç në raste ku është vënë re, përmbatja e këtij dokumenti është e licencuar nën Creative Commons (kushtimi, jo-komercial, jo origjinal, ndërkombëtar 4.0) licensë. <https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/legalcode> Për më shumë të dhëna lutemi të shikoni faqen e lejeve në faqen e internetit: www.amnesty.org Kur materiali i është përkushtuar autorit të kopjes jashtë Amnesty International nuk është subjekt i licensës së Creative Commons. Publikuar për herë të parë në vitin 2023 nga Amnesty International Ltd
Peter Benenson House, 1 Easton Street
London WC1X 0DW, UK*

Indeks: EUR 73/7123/2023
Original language: English

amnesty.org



Fotoja në kopertinë: Protestueset marshojnë kundër dhunës sistematike ndaj grave për ta shënuar ditën ndërkombëtare të grave në Prishtinë, Kosovë, 8 mars 2023
© Uk Salihu

AMNESTY
INTERNATIONAL



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
METODOLOGJIA	10
FJALORTH I TERMAVE	13
SHKURTESAT	15
1. DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË:DEFINIMI I PROBLEMIT	16
1.1 DHUNA NË FAMILJE DHE EFEKTI I SAJ JOPROPORCIONAL NË INDIVIDË QË U PËRKASIN GRUPEVE MINORITARE	19
2. KORNIZA LIGJORE DHE E POLITIKAVE DHE INSTITUCIONET RELEVANTE NË KOSOVË	21
3. SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLEN TË MBIJETUARAT QË PËRPIQEN TË LARGOHEN NGA MARRËDHËNIET ABUZIVE	28
3.1 DËSHTIMI PËR T'U OFRUAR TË MBIJETUARAVE QASJE ADEKUATE NË INFORMATA	28
3.1.1 MUNGESA E NJË LINJE TË SPECIALIZUAR TË NDIHMËS	29
3.1.2 MUNGESA E INFORMATAVE PËR SHËRBIMET MBËSHTETËSE	31
4. DËSHTIMI I POLICISË NDAJ VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE	33
4.1 VIKTIMAT PËRBALLEN ME MOSBESIM DHE PARAGJYKIME NGA POLICIA	33
4.2 ZYRTARËT POLICORË ZVOGËLOJNË PËRVOJAT DHE DËSHMITË E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS	34
4.3 NEGLIZHIMI INSTITUCIONAL I TË MBIJETUARVE LGBTI	37
5. MUNGESA E MONITORIMIT DHE ZBATIMIT TË URDRHAVE MBROJTËS	41
6. STREHIMORET ME BURIME TË PAMJAFTUESHME TË PAAFTA PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT E TË MBIJETUARAVE	44
6.1 SFIDAT E QASJES NË STREHIMORE	45
6.2 TË SHKËPUTURA NGA BOTA: RREGULLAT E STREHIMOREVE SHKAKTOJNË NDJESI TË FORTË IZOLIMI	45
6.3 ZBRAZËTI NGULMUESE NË FINANCIMIN E STREHIMOREVE	47

6.4 MUNGESA E STREHIMOREVE PËR PERSONAT LGBTI TË MBIJETUAR TË DHUNËS NË FAMILJE	48
7. MUNGESA E MBËSHTETJES NGA QENDRAT PËR PUNË SOCIALE	50
8. RRETH VICIOZ: MUNGESA E MBËSHTETJES AFATGJATË PENGON TË MBIJETUARAT TË NDËRTOJNË JETË TË RE	52
9. VENDIMET E GJYKATAVE PËR ALIMENTACION TË VONUARA	56
10. TË MBIJETUARAT TË DETYRUARA TA NAVIGOJNË TË VETME NJË SISTEM KOMPLEKS TË DREJTËSISË	58
10.1 SISTEMI I MBËSHTETJES LIGJORE DËSHTON NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NDAJ TË MBIJETUARAVE	58
10.1.1 MBROJTËSIT E VIKTIMAVE - ME STAF TË PAMJAFTUESHËM, TË MBINGARKUAR DHE JO TË PRANISHËM	58
10.1.2 ZYRA PËR MBROJTJE DHE NDIHMË TË VIKTIMAVE DËSHTON NË DETYRIMET NDAJ TË MBIJETUARAVE	60
10.2 PËRGGJIGJJA E DREJTËSISË PENALE DËSHTON NDAJ TË MBIJETUARAVE	61
10.2.1 DËNIMET JOPROPORCIONALE ME PESHËN E VEPRËS PENALE	62
10.2.2 VLERËSIMI JOADEKUAT I RRETHANAVE LEHTËSUESE	64
10.3 DISA TË MBIJETUARA KONSIDEROHEN SI KRYESE TË DHUNËS NDAJ PARTNERIT INTIM	66
10.4 AKTGJYKIMET ZBULOJNË EMRAT E VIKTIMAVE DUKE SHKELUR TË DREJTËN E TYRE PËR PRIVATËSI	68
10.5 NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË KODIN PENAL DHE KODIN E PROCEDURËS PENALE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT	68
10.6 DËMSPËRBLIMI PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE POTHUAJSE JOEKZISTENT	69
10.6.1 ASNJË DËMSPËRBLIM PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE NGA GJYKATAT PENALE	69
10.6.2 VËSHTIRËSI NË MARRJEN E DËMSPËRBLIMEVE NGA FONDI PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE	71
11. PARANDALIMI	73
12. NË FJALËT E VETË ATYRE	75
13. REKOMANDIME	77

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

“Një grua e vetme në Kosovë nuk jeton. Ajo mbijeton... Nëse nuk ke mbështetje të fortë familjare dhe struktura të tjera mbështetëse rreth vetes, je shënjestër e lehtë në këtë shoqëri. Çfarë kemi këtu është dështim institucional për të mbrojtur gratë.”

“Diana”, e mbijetuar e dhunës në familje nga Kosova

Personat e mbijetuar të dhunës në familje në Kosovë, shumica e të cilëve janë gra dhe vajza, përballen me pasiguri dhe mungesë të mbështetjes kur përpiqen të largohen nga situatat abuzive. Të mbijetuarat i thanë Amnesty International se përgjigja e shtetit ishte e pamjaftueshme për t'i mbështetur që të jetojnë të pavarura, duke i detyruar shumë prej tyre të kthehen tek abuzimi.

Ekziston një mundësi monumentale në Kosovë për ta ndryshuar këtë. Qeveria e tanishme e ka bërë prioritet të qartë kombëtar adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe është zotuar që për ta bërë këtë ta marrë një qasje që vendos të mbijetuarat në qendër. Në mars të vitit 2022, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, që synon forcimin e reagimit institucional ndaj dhunës në familje dhe sigurimin që në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat të zbatohet qasja që vendos viktimat në qendër. Në mars të vitit 2023, Kuvendi miratoi gjithashtu në lexim të parë projektligjin e ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Këta hapa janë vazhdimësi e përpjekjeve të ndërmarra në nëntor të vitit 2020 nga Kuvendi i Kosovës për amendamentimin e Kushtetutës së vendit për t'i dhënë efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)¹.

Sidoqoftë, hulumtimi i Amnesty International zbulon se këto përpjekje nuk kanë qenë të mjaftueshme. Pavarësisht zotimit të fortë, shteti po dështon në përmbushjen e plotë të detyrimeve për të drejtat e njeriut për marrjen e të gjitha masave të duhura për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Këto kërkojnë që Kosova të zbatojë politika gjithëpërfshirëse të parandalimit dhe të sigurojë që të mbijetuarat të kenë mbrojtje dhe mbështetje të mjaftueshme dhe adekuate për t'u larguar nga situatat abuzive dhe për t'iu qasur drejtësisë dhe dëmshpërblimit në përputhje me nevojat dhe prioritetet e tyre. **Të mbijetuarat që përpiqen të largohen nga situatat abuzive përballen me pengesa të rënda.** Këto përfshijnë

¹ Për shkak të mungesës së njohjes universale, Kosova nuk ka nënshkruar apo ratifikuar traktatet kyçe ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, por Kushtetuta e Kosovës parashihet zbatimin e drejtpërdrejtë të tërë instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale të drejtave të njeriut, duke u dhënëfuqi mbizotëruese ndaj ligjit vendor. Në nëntor 2020, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Kushtetutën duke e bërë drejtpërdrejtë të zbatueshme Konventën e Stambollit.

mungesën e informacionit për asistencën që kanë në dispozicion, keqtrajtimin nga zyrtarët policorë, punëtorët socialë të mbingarkuar dhe shërbimet e pamjaftueshme mbështetëse. Po ashtu përballen me pengesa në sigurim të mbrojtjes dhe qasjes në drejtësi dhe mjete juridike, duke përfshirë mbështetjen afatgjatë dhe mundësitë ekonomike për një jetë të pavarur pa dhunë. Përgjigjja e shtetit pengohet më tej nga mungesa e burimeve të mjaftueshme dhe kapaciteteve institucionale për zbatim të duhur.

Për më shumë, fillimi dhe vazhdimi i një jete të pavarur pa dhunë është detyrë e vështirë për shumë gra të mbijetuara në Kosovë pasi shumica varen ekonomikisht nga familjet e tyre të lindjes, bashkëshortët ose vjehërrit. Sipas të dhënave zyrtare, vetëm 17% e grave ishin të punësuar zyrtarisht krahasuar me 50% të burrave në vitin 2017, dhe në vitin 2021 vetëm 18% e pronës zotërohej nga gratë ndërsa 79% nga burrat. Përveç kësaj, gratë shpesh përjashtohen nga trashëgimia familjare ose heqin dorë nga e drejta për të trashëguar për shkak të trysisë sociale, megjithëse ligjet u garantojnë atyre barazi me burrat në këto çështje. Ndarja e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve në procedurat e shkurorëzimit gjithashtu ka prirje të dëmtojë gratë.

Në veçanti, hulumtimi tregon se përgjigjja shtetërore ndaj dhunës në familje nuk është mjaftueshëm e përqendruar te të mbijetuarat: politikat e Kosovës për t'iu përgjigjur dhunës në familje kanë përqëndrim të fortë në drejtësinë penale, por neglizhojnë nevojat e të mbijetuarave për mbështetje afatgjatë dhe kapacitet për të jetuar një jetë të pavarur. Fushatat informuese të sponsorizuara nga shteti përqendrohen pothuajse ekskluzivisht në inkurajimin e të mbijetuarave për të raportuar rastet në polici. Megjithatë, pasi personat e mbijetuar largohen nga situata abuzive, ato pranojnë vetëm mbrojtje fillestare dhe mbështetje afatshkurtër dhe më pas lihen vetëm për ta rindërtuar jetën me ndihmë të pamjaftueshme afatgjatë, nëse jo pa ndihmë fare, për qasje në strehim, kualifikime profesionale apo punësim. Legjislacioni për të drejtat e njeriut kërkon që shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i ndihmuar viktimat të kenë qasje në mbështetje dhe shërbime për të lehtësuar rikuperimin e tyre nga dhuna, duke përfshirë ndihmën financiare, strehimin, arsimin, trajnimin dhe ndihmën për gjetjen e punësimit.

Përgjigjja e Kosovës ndaj dhunës në familje, duke përfshirë politikat shtetërore dhe masat e tjera, po ashtu janë formësuar pa pjesëmarrjen kuptimplotë ose konsultimin me shoqërinë civile, apo vetë të mbijetuarat. Kjo ka rezultuar në dështimin për të integruar në mënyrë adekuate perspektivat, shqetësimet dhe nevojat e të mbijetuarave në politikat specifike.

METODOLOGJIA

Të mbijetuarat e dhunës në familje kanë të drejtë të përfshihen në çdo proces vendimmarrës nga i cili ndikohen. Duke ndjekur këtë parim, ky hulumtim mori një qasje të përqendruar te të mbijetuarat për të siguruar që perspektivat e tyre të pasqyrohen plotësisht në dokumentim, analizë, përfundime dhe rekomandime.

Hulumtimi u krye mes qershorit 2022 dhe korrikut 2023 dhe përfshiu 77 intervista. U intervistuan 20 të mbijetuara të dhunës në familje, tetë prej të cilave ishin nga pakicat etnike, gjuhësore ose fetare, si dhe të mbijetuarat LGBTI, në gjashtë qytete të Kosovës. Të mbijetuarat u intervistuan për përvojat e tyre dhe gjithashtu u pyetën lidhur me prioritetet e tyre për përgjigje të përmirësuar shtetërore. Amnesty International po ashtu intervistoi 22 përfaqësues/e të OJQ-ve, 15 zyrtarë/e shtetërorë/e, nëntë persona që menaxhojnë strehimoret e dhunës në familje, gjashtë akademikë/e, dy aktivistë/e lokalë/e, një gazetar/e, një ekspert/e të mjekësisë ligjore dhe një avokat. Për më shumë, hulumtimi përfshiu analizë sasiore të një mostre përfaqësuese prej 197 vendimesh gjyqësore për rastet e dhunës në familje për të analizuar praktikatat e gjykatave për dënim dhe dëmshpërblim, praninë e të mbijetuarave në proceset gjyqësore dhe përfaqësimin e tyre ligjor, ndër të tjera. U përfshinë po ashtu kërkesa zyrtare për informacion tek autoritetet përkatëse dhe rishikimi i literaturës në dispozicion dhe i raporteve mediale.

DËSHTIMI I SHTETIT PËR TË MBËSHTETUR NË MËNYRË TË DUHUR TË MBIJETUARAT QË LARGOHEN NGA SITUATAT ABUZIVE

Mungesa e informatave. Të mbijetuarat duhet të dinë se çfarë shërbimesh shtetërore mbështetëse dhe mbrojtëse kanë në dispozicion për të marrë vendime të informuara në lidhje me opsionet e tyre për t'u larguar nga situatat abuzive. Mirëpo shumica e të mbijetuarave të intervistuar raportuan se nuk kishin

informacion për të drejtat e tyre ose shërbimet e disponueshme përpara se t'i raportonin rastet e tyre te autoritetet. Hulumtimi gjeti se autoritetet përgjegjëse shpesh dështojnë të sigurojnë që informacioni përkatës të jetë i disponueshëm dhe lehtësisht i qasshëm për personat që kanë nevojë; për shembull, nuk ka një linjë të specializuar të ndihmës për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Dështimi i policisë për të mbrojtur të mbijetuarat. Shumica e të mbijetuarave dëshmuar se policia prirë t'i nënçmonte përvojat e tyre dhe i merrte seriozisht vetëm kur kishin shenja të dukshme fizike të dhunës. "Diana" nga Prishtina raportoi bashkëshortin pas dhunës së përsëritur për shumë vite. Ajo i tha Amnesty International se kur më në fund shkoi në polici dhe u tha se kishte frikë për jetën e saj, zyrtarët e policisë e vunë në pikëpyetje karakterin e saj dhe e pyetën nëse ajo ishte në ndonjë lidhje jashtëmartesore. Ata filluan t'i besojnë vetëm kur ajo ua tregoi lëndimet.

Shumë të mbijetuara, veçanërisht të mbijetuarat nga grupet e marginalizuara, treguan gjithashtu për paragjykimet, mosbesim dhe keqtrajtim nga policia. "Pati", një grua trans u soll në një stacion policor pasi babai i saj e sulmoi fizikisht dhe thirri policinë për t'u thënë se kishte në plan ta "përzinte djalin e tij sepse ishte gej". Edhe pse ajo ishte sulmuar, policia e mori në pyetje si të ishte e dyshuar dhe kërkoi të dinte për orientimin e saj seksual. Zyrtarët i thanë se nëse nuk pranonte se ishte gej, ata do të sillnin mjekë ligjorë për të "verifikuar orientimin e saj seksual".

Urdhrrat mbrojtës vështirë të zbatueshëm. Të mbijetuarat ishin të kënaqura që urdhrat e mbrojtjes ishin lëshuar me shpejtësi nga gjyqësori. Megjithatë, të mbijetuarat dhe të intervistuarat/it e tjera/ë theksuan problemet me shtrirjen e urdhrave të mbrojtjes, duke përfshirë faktin se gjykatat rrallëherë urdhërojnë kryesin e dyshuar të largohet nga vendbanimi i përbashkët, duke e detyruar të mbijetuarën – dhe në disa raste fëmijët e saj – të largohen nga shtëpia. Për më tepër, urdhrat mbrojtës shpesh dështojnë të mbulojnë masa të tjera si urdhërimi i kryesit për të paguar alimentacionin ose për të paguar qiranë e të mbijetuarës ose për ta kompensuar viktimën për daljen nga shtëpia, të cilën kanë mundësi ta bëjnë sipas ligjit. Së fundi, duket se nuk ka monitorim dhe zbatim efektiv të urdhrave mbrojtës, gjë që mund t'i ekspozojë të mbijetuarat ndaj dhunës dhe abuzimit të mëtejshëm.

Strehimoret e pamjaftueshme dhe të nënfinancuara. Aktualisht ekziston vetëm një strehimore e licencuar në secilin nga tetë rajonet e Kosovës dhe pothuajse të gjitha janë në dispozicion vetëm për të mbijetuarat që janë të gatshme ta raportojnë rastin në polici. Kjo kërkesë përbën pengesë të madhe për ato që mund të mos jenë gati ose mund të mos duan ta raportojnë dhunuesin e tyre, duke lënë shumë të mbijetuara pa mbështetje. Situata për personat e mbijetuar LGBTI është edhe më e pasigurt pasi nuk ka asnjë strehë të specializuar LGBTI në Kosovë dhe ata/ato janë të detyruar të kërkojnë mbrojtje dhe strehim në Shqipëri, që nuk janë gjithmonë të disponueshme dhe të qasshme.

Po ashtu, disa strehimore kanë rregulla që kufizojnë kontaktin e të mbijetuarave me familjen dhe miqtë, si dhe qasjen në telefon dhe internet, duke rezultuar që të mbijetuarat të ndihen të izoluar dhe të shkëputura nga bota e jashtme.

Qendrat për Punë Sociale shpeshherë nuk punojnë në interesin më të mirë të të mbijetuarave. Shumica e të mbijetuarave të intervistuar nga Amnesty International raportuan përvoja negative me punëtorët/et e rastit që u janë caktuar. Të mbijetuarat thanë se ata/ato shpesh nuk ishin empatikë ose ndihmues dhe disa thanë se ishin tepër të fokusuar në pajtimin e tyre me abuzuesit. "Edona", për shembull, tregoi se si i kishte telefonuar punëtorët/et socialë/e për ndihmë ndërsa i shoqi po e rrihte, e ata i thanë thjesht të përpiqej të dialogonte me të.

Dështimi për të ofruar mbështetje adekuate dhe të mjaftueshme sociale. Ekziston mbështetje e kufizuar, nëse jo fare, nga qeveria, duke përfshirë ndihmën financiare ose strehimin social, në dispozicion të të mbijetuarave të dhunës në familje pas largimit nga strehimorja. Nuk ka asnjë politikë të qeverisë qendrore për të ofruar mbështetje qoftë edhe të përkohshme, të njëhershme, për të ndihmuar të mbijetuarat drejt kalimit në jetë të pavarur.

Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme shtetërore dhe e strehimit social është një nga arsyt kryesore pse të mbijetuarat vendosin të mos raportojnë dhunën ose pse detyrohen të qëndrojnë me abuzuesit e tyre ose të kthehen tek ata. Në mungesë të asistencës së specializuar, disa gra të mbijetuara kthehen në familjet e tyre të lindjes, por kur familjet e tyre nuk i pranojnë ato, nuk kanë alternativë veçse të kthehen te dhunuesit e tyre. Njerëzit që përjetojnë dhunë në familje për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor në familjet ku janë lindur po ashtu mund të detyrohen të tolerojnë ose të kthehen në familje abuzive.

Për më shumë, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore për zgjidhjen e martesës, alimentacion dhe ndarje të pasurisë, e cila mund të zgjasë për shumë vite, dhe dështimi i mekanizmave shtetërorë për të zbatuar vendimet e alimentacionit kur kryesit refuzojnë të paguajnë, kontribuojnë ndjeshëm në situatën e pasigurt të të mbijetuarave që largohen nga marrëdhëniet abuzive.

Dështimi i shtetit për të mbështetur në mënyrë të duhur të mbijetuarat që të kenë qasje në drejtësi dhe dëmshpërblim

Mungesa e ndihmës juridike efektive. Të mbijetuarat i thanë Amnesty International se nuk kanë marrë gjithmonë nga mbrojtësit e viktimave ndihmën adekuate që u takonte ligjërisht dhe e dëshironin. Zyra për Mbrojtje të Viktimave nuk ka staf të mjaftueshëm dhe është e mbingarkuar. Mbrojtësve të viktimave u mungon hapësira adekuate për zyra, duke i penguar të flasin konfidencialisht me viktimat. Sfida të tilla shpesh rezultojnë që mbrojtësit e viktimave të mos jenë në gjendje të ndihmojnë në mënyrë efektive viktimat. Për shembull, siç tregojnë gjetjet e këtij raporti, është e zakonshme që mbrojtësit e viktimave të mungojnë në stacionet e policisë ose në proceset gjyqësore ose të jenë të papërgatitur dhe ndonjëherë të veprojnë kundër interesave të të mbijetuarve.

Dënimet joadekuate. Ky hulumtim zbuloi se, pavarësisht hapave për të përmirësuar reagimin e drejtësisë penale ndaj dhunës në familje, ku kryesisht ndiqen penalisht dhe dënohen, ata marrin dënime jo proporcionale me peshën e veprës penale. Të mbijetuarat theksuan vazhdimisht se si kjo gërryen besimin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe dekurajon raportimin. Shqyrtimi sistematik nga Amnesty International i vendimeve gjyqësore kundër 218 të pandehurve zbuloi se 74% pranuan dënim me burgim me kusht, 45% pranuan gjobë dhe 20% gjobë me kusht. Disa të pandehur morën një kombinim dënimesh, si dënim me burgim me kusht dhe gjobë. Shqyrtimi nga Amnesty International zbuloi gjithashtu se udhëzuesi për politikë ndëshkimore, që ofron udhëzime thelbësore për gjyqësorin në gjykimin dhe dënimin e kryesve të dhunës në familje në një kontekst të stereotipeve të përhapura gjinore, shpesh shpërfillje.

Të mbijetuarat e akuzuara si kryese. Analiza e Amnesty International për 197 aktgjykime të dhunës në familje identifikoi gjashtë raste të dhunës nga partneri intim, ku si burri ashtu edhe gruaja u akuzuan dhe u shpallën fajtorë për vepra penale të lidhura me dhunën në familje. Nga analiza e rrethanave faktike në këto vendime u zbulua se viktimat e parë, e cila në të gjitha rastet ishte grua, mund t'i ishte përgjigjur dhunës nga burri në vetëmbrojtje. Megjithatë, shumica e këtyre vendimeve nuk e shqyrtuan këtë mundësi dhe e akuzuan dhe e dënuan atë në mënyrë të barabartë si kryese të dhunës.

Shkeljet e privatësisë. Gjyqësori ndonjëherë ka shkelur të drejtën e privatësisë së të mbijetuarave duke publikuar gjykime jo anonime në faqet e tyre të internetit. Identiteti i viktimave ose i kryesve ishte publik në 13.2% të vendimeve të gjykatave të shqyrtuara nga Amnesty International.

Dëmshpërblimet. Të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë përballen me shumë pengesa drejt qasjes në dëmshpërblim për dëmet e pësuarat. Për shembull, shqyrtimi i 197 vendimeve gjyqësore nga Amnesty International tregoi se gjykatat nuk ua dhanë asnjë kompensim në proceset penale të mbijetuarave, megjithëse ishin të autorizuar sipas ligjit për ta bërë këtë. Vetëm një pjesë e vogël e të mbijetuarave (5.1%) madje kërkuan kompensim në rastet penale, duke reflektuar mungesën e njohurive të të mbijetuarave dhe mbështetjes ligjore për të kërkuar kompensim. Në vend që të shqyrtonin kërkesat, gjykatat i referuan këto të mbijetuarat në procese gjyqësore civile. Referimi i të mbijetuarave në gjykatat civile shton një tjetër proces gjyqësor, shpesh të gjatë, që e bën kërkimin e drejtësisë dhe kompensimit edhe më të mundimshëm dhe të kushtueshëm për viktimat.

DËSHTIMI I SHTETIT PËR TË ZBATUAR NJË QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Megjithëse qeveria ka nisur fushata ndërgjegjësimi të publikut, nuk ka masa apo politika për të adresuar faktorët strukturorë që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore.

Tekstet shkollore ende përhapin stereotipe gjinore përmes deklaratave të pasakta për burrat dhe gratë, seksualitetin dhe identitetin gjinor. Deklaratat e pabaza dhe shkencërisht të pasakta propagandojnë stereotipe të dëmshme gjinore dhe personat transgjinorë dhe përforcojnë qëndrimet diskriminuese për inferioritetin e grave dhe paragjykimet ndaj transgjinorëve, të cilat janë shkaqet kryesore të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave e individëve LGBTI.

Nivelet më të larta të marginalizimit, pabarazia strukturore, varfëria, nivelet e ulëta të arsimit dhe papunësia në komunitetet rom, ashkali dhe kosovaro-egjiptian në krahasim me popullsinë shumicë po krijojnë një situatë në të cilën të mbijetuarat e dhunës në familje në këto komunitete kanë tendencë të mos raportojnë

dhunën, duke përfshirë dhunën në familje. Martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe të detyruara dhe braktisja e shkollës janë gjithashtu më të përhapura në komunitetet rom, ashkali dhe kosovaro-egjiptian. Pavarësisht urgjencës së situatës, një tjetër angazhim që qeveria dështoi ta zbatonte në vitin 2022 ishte organizimi i “një fushate ndërgjegjësuere për prindërit për të parandaluar martesat e hershme”.

REKOMANDIME

Pavarësisht disa përpjekjeve të qeverisë për të përmirësuar reagimin e shtetit ndaj dhunës në familje, ato janë të fokusuara kryesisht në sistemin e drejtësisë penale dhe inkurajimin e të mbijetuarave për të raportuar dhunën. Mirëpo, në të njëjtën kohë, sistemi po i dështon të mbijetuarat në mënyra të shumta për shkak se institucione kyçe kanë mungesë të burimeve, mungesë të stafit dhe mungesë të kapacitetit profesional për të trajtuar raste të tilla në mënyrë të ndjeshme gjinore. Për më shumë, aspekte të tjera thelbësore të reagimit ndaj dhunës në familje anashkalohehen dhe neglizhohen. Për shembull, politikat dështojnë t’ua mundësojnë të mbijetuarave të marrin mbrojtje dhe mbështetje sociale për aq kohë sa është e nevojshme dhe të kenë qasje në të drejta sociale dhe ekonomike si strehimi dhe punësimi për t’i fuqizuar ato të jetojnë të pavarura dhe pa dhunë në afat të gjatë. Parandalimi gjithashtu anashkalohehet dhe mungon një qasje sistematike që adreson shkaqet rrënjësore të dhunës me bazë gjinore.

Megjithatë, angazhimi i deklaruar i qeverisë për të trajtuar dhunën në familje sugjeron se ndryshimi real është i mundur. Qeveria duhet të ndër marrë veprime të mëtejshme për të siguruar që përgjigjet e tyre të jenë gjithëpërfshirëse dhe të zhvilluara me pjesëmarrje domethënëse të shoqërisë civile të Kosovës dhe të mbijetuarave të dhunës në familje.

Amnesty International ofron një gamë të plotë rekomandimesh konkrete për çdo degë shtetërore ose institucion përgjegjës në vetë raportin (shih Seksionin 13. Rekomandime). Më poshtë janë rekomandimet kryesore për autoritetet e Kosovës:

- Të sigurojnë që politikat shtetërore në përgjigje të dhunës në familje të jenë mjaftueshëm të përqendruara te të mbijetuarat dhe të pasqyrojnë gamën e plotë të shqetësimeve dhe nevojave të të mbijetuarave, për sa u përket të drejtave të tyre, dinjitetit dhe agjencisë së të mbijetuarave. Për këtë qëllim, pjesëmarrja domethënëse e të mbijetuarave duhet të sigurohet gjatë gjithë procesit legjislativ dhe të zhvillimit të politikave.
- Të sigurojnë që politikat e dhunës në familje të fokusohen jo vetëm në përgjigjen e drejtësisë penale, por t’u përgjigjen në mënyrë adekuate shqetësimeve dhe nevojave të tjera të të mbijetuarave përmes ofrimit të mbështetjes afatgjatë që u mundëson atyre të kenë qasje në të drejtat sociale dhe ekonomike si strehimi dhe punësimi për t’u larguar përgjithmonë nga situatat e dhunës.
- Të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve për policinë, mbrojtësit e viktimave, prokurorët, qendrat për punë sociale dhe gjykatat për t’i trajtuar rastet e dhunës në familje në mënyrë të ndjeshme, profesionale, efikase, pa vonesa të panevojshme dhe me respekt për të drejtat, dinjitetin dhe agjencinë e të gjithë të mbijetuarve.
- Të ofrojnë trajnime të përshtatshme, sistematike dhe të detyrueshme për profesionistët që punojnë me të mbijetuarat e dhunës në familje. Trajnimi duhet të mbulojë parandalimin dhe zbulimin e dhunës në familje; barazinë gjinore; diskriminimin ndërsektorial; dhe stereotipizimet e dëmshme gjinore, me synimin për të parandaluar viktimizimin dytësor dhe për t’i çrrënjësuar praktikatat diskriminuese dhe aplikimin e stereotipeve gjinore në të gjitha fazat e procesit ligjor. Trajnimi duhet të zhvillohet në konsultim të ngushtë me të mbijetuarat dhe shoqërinë civile.
- Të sigurojnë që strehimoret të jenë të disponueshme në të gjithë vendin për të ofruar qasje të menjëhershme në mbrojtje për të mbijetuarat e dhunës në familje, duke përfshirë strehimin e përkohshëm dhe shërbime të tjera, dhe që ato të financohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të kenë burime adekuate. Të sigurojnë që rregullat dhe rregulloret e strehimoreve të respektojnë të drejtat e të mbijetuarave dhe të mos çojnë në viktimizim dytësor. Të sigurojnë ndërtimin dhe furnizimin me burime të një strehimoreje të specializuar për të mbijetuarit/at LGBTI.
- Të promovojnë ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së njerëzve të të gjitha gjinive me synimin për të zhdukur stereotipet e dëmshme gjinore dhe diskriminimin në bazë të gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë etnike, mes tjerash. Kjo duhet të arrihet, ndër të tjera, duke ofruar edukim seksual gjithëpërfshirës, të përshtatshëm për moshën, të ndjeshëm ndaj gjinisë, të bazuar në fakte dhe të paanshëm për nxënësit dhe studentët e të gjitha gjinive, duke përfshirë edukimin për pëlqimin, autonominë trupore dhe të drejtën për integritet trupor.

METODOLOGJIA

Hulumtimi që shërbeu si bazë e këtij raporti kishte një qasje inovative të metodave të përziera për të kapur përvojat e të mbijetuarave të dhunës në familje në Kosovë nga këndvështrime të shumta. Raporti vë në pah se si të mbijetuarat e përjetojnë sistemin e drejtësisë dhe shërbimet mbështetëse që synojnë t'i ndihmojnë ato të largohen nga situatat abuzive, të marrin mbrojtje dhe drejtësi dhe të kërkojnë kompensim për dhunën që kanë pësuar. Po ashtu, raporti diskuton zbrazëti të rëndësishme në kornizat ekzistuese ligjore dhe politike ku autoritetet e Kosovës nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Bazuar në gjetjet, raporti ofron rekomandime për ndryshim tek autoritetet përkatëse.

Amnesty International e kreu këtë hulumtim mes qershorit 2022 dhe korrikut 2023. Në të u përfshinë intervista me të mbijetuara që përjetuan dhunë në familje midis viteve 2017-2022, eksperte/ë dhe përfaqësues/e të institucioneve kyçe; hulumtim dokumentar, duke përfshirë shqyrtimin e literaturës ekzistuese dhe artikujve mediatikë; kërkesa formale për zyrtarët përkatës për qasje në informata publike; dhe analizë sasiore të një mostre përfaqësuese të vendimeve gjyqësore. Amnesty International kreu 10 vizita kërkimore në disa qytete të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Gjakovën, Prizrenin, Mitrovicën, Novobërdën dhe Zubin Potokun dhe intervistoi 77 persona, duke përfshirë 20 të mbijetuara të dhunës në familje, 22 përfaqësues/e të organizatave joqeveritare, 15 zyrtarë/e shtetërorë/e, nëntë persona që menaxhojnë strehimore për të mbijetuara të dhunës në familje, gjashtë akademikë/e, dy aktivistë/e lokalë, një gazetar, një ekspert të mjekësisë ligjore dhe një avokat.

Amnesty International ishte e prirur të përdorte metoda kërkimore që do ta bënin përvojën e pjesëmarrjes në hulumtim përvojë fuqizuese dhe pozitive për vetë të mbijetuarat, si dhe të ndërtonin mbi njohuritë e të mbijetuarave se si do të mund të forcohej përgjigjja e shtetit ndaj dhunës në familje. Si i tillë, ky raport eksploron dhe pasqyron perspektivat e të mbijetuarave dhe prioritetet e tyre në dokumentim, analizë dhe përfundime. Ekipi hulumtues i Amnesty International siguroi gjithashtu që rekomandimet që rezultuan nga ky hulumtim të konsultoheshin me të mbijetuarat për t'u siguruar që ato janë relevante me shqetësimet e tyre.

Amnesty International iu drejtua personelit të strehimoreve dhe stafit të organizatave lokale joqeveritare (OJQ) për të identifikuar dhe intervistuar 20 të mbijetuara duke përdorur metodën e mostrimit 'snowball'.² Gjatë këtyre intervistave të thelluara, të mbijetuarave iu kërkua të ndajnë përvojat e tyre personale të ndërveprimeve si me institucionet shtetërore ashtu edhe me strehimoret e drejtuara nga OJQ-të, në lidhje me pritshmëritë, shqetësimet dhe prioritetet e tyre. Përveç kësaj, të intervistuarat u ftuan të ofrojnë rekomandime për ndryshime për të përmirësuar sistemin aktual dhe për të mbrojtur më mirë të drejtat e njeriut të të mbijetuarave.

Gjatë kryerjes së intervistave, studiuesit krijuan hapësirë që të mbijetuarat të flisnin në një mënyrë që do të ishte më e rehatshme për to dhe që do të siguronte privatësinë e tyre. Të gjitha të mbijetuarat e intervistuarat ishin të rritura, përveç njëres. Një intervistë u krye me një vajzë 14-vjeçare e cila po qëndronte në një strehimore dhe kërkoi të merrte pjesë. Si e tillë, kjo intervistë u krye në një mënyrë që mori parasysh moshën e saj dhe kapacitetin në zhvillim për të dhënë pëlqimin, hulumtuesja siguroi kohë shtesë dhe formulimi i disa pyetjeve u modifikua. Të gjitha të intervistuarat u informuan për natyrën dhe qëllimin e hulumtimit si dhe për mënyrën se si do të përdorej informacioni i dhënë. Është marrë pëlqimi nga secila e intervistuarat përpara fillimit të intervistës dhe është konfirmuar sërish në fund të intervistës. Të intervistuarave nuk u janë ofruar mjete shtytëse në këmbim të përgjigjeve.

² Në mostrimin 'snowball' ('top bore'), çdo personi të intervistuar i kërkohet të sugjerojë të tjerë që të intervistohen. Duke pasur parasysh vështirësitë e vlerësimit të kornizës së mostrimit për mijëra njerëz që mund të preken nga dhuna në familje në Kosovë, mostrimi 'snowball' u konsiderua si metoda më e realizueshme e hulumtimit.

Përgjatë këtij raporti, emrat e vërtetë të të mbijetuarave dhe në disa raste detaje të tjera identifikuese si statusi familjar dhe emrat e vendeve u lanë jashtë për të mbrojtur privatësinë, konfidencialitetin dhe sigurinë e të mbijetuarave në përputhje me dëshirat e tyre. Në rastet e publikuara të femicidit, ky raport përdor emrat e vërtetë të viktimave dhe kryesve.

Amnesty International përdori qasje ndërthurëse për të identifikuar se si ligjet, politikat dhe zbatimi i tyre ndikojnë në qasjen që kanë të mbijetuarat e dhunës në familje në mbrojtje dhe mbështetje varësisht nga aspekte të ndryshme të identitetit të tyre, si për shembull të mbijetuarat nga pakicat etnike, gjuhësore ose fetare, dhe personat lezbike, gej, biseksualë, transgjorë dhe interseks (LGBTI) të mbijetuar të dhunës. Gjashtë nga 20 të mbijetuarat e intervistuar u përkisnin pakicave etnike, duke përfshirë dy kosovare-egjiptiane, dy kosovare-ashkali, një romë dhe një serbe të Kosovës; pjesa tjetër ishin shqiptare të Kosovës.³ Një i mbijetuar ishte burrë gej dhe dy ishin gra transgjorë. Amnesty International gjithashtu intervistoi shtatë persona që punonin me të mbijetuarat serbe të Kosovës, duke përfshirë dy punëtorë/e socialë/e, dy drejtorë/e të strehimoreve dhe dy përfaqësues/e të organizatave për të drejtat e grave. Më tej, Amnesty International foli me tre përfaqësues/e të organizatave të shoqërisë civile dhe dy aktivistë/e lokalë/e që punojnë me romët, ashkallitë dhe egjiptianët kosovarë dhe gjashtë përfaqësues/e të tri organizatave LGBTI që ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje. Hulumtuesit kërkuan informata në lidhje me përvojat e personave LGBTI dhe përgjatë gjithë raportit, kudo që janë gjetur informata përkatëse për përvojat e viktimave LGBTI, ato janë paraqitur. Amnesty International njeh kufizimet e fushëveprimit të këtij projekti kërkimor.

Fusha e mbrojtjes së të drejtave LGBTI në kontekstin e dhunës me bazë gjinore dhe më gjerësisht do të mund të përfitonte nga hulumtimet dhe analizat e mëtejme, pasi këto çështje të të drejtave të njeriut janë përgjithësisht të nënhetuara në Kosovë.

Amnesty International zhvilloi 15 intervista me zyrtarë shtetërorë duke përfshirë (tani ish) Zëvendësministren e Drejtësisë dhe Koordinatorin Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Zëvendës-Kryeprokuroren e Kosovës, Shefin e Njësisë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Policinë e Kosovës, (tani ish) Drejtorin e Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, një mbrojtës të viktimave, një gjyqtare nga Gjykata Themelore e Prishtinës, tre punonjës socialë, një përfaqësues të Divizionit të Shërbimit Social në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tre përfaqësues të Departamentit të Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës, (tani ish) Nënkyetarin e Komunës së Mitrovicës dhe Avokatin e Popullit të Kosovës.

Shumica e intervistave janë kryer në gjuhën shqipe, ndërsa rreth një e treta janë kryer në anglisht dhe një e dhjeta në serbisht. Të mbijetuarat u intervistuan në shqip ose serbisht. Nga 77 personat e intervistuar në tërësi, 60 janë intervistuar personalisht dhe 17 me video ose telefonata.

Amnesty International gjithashtu kreu një hulumtim të gjerë dokumentar për këtë raport. Rishikimi i literaturës mbuloi kornizën ligjore dhe të politikave në Kosovë, hulumtimin ekzistues për dhunën në familje, gjetjet nga organizatat partnere, përmbajtjet mediale, artikujt akademikë dhe statistikatat zyrtare. Stafi hulumtues shqyrtoi dhe analizoi dosjet e rasteve të shtatë prej të mbijetuarave që u intervistuan, duke përfshirë aktakuzat, vendimet gjyqësore, urdhrat mbrojtës, deklaratat e policisë dhe materiale të tjera. Kjo është bërë me pëlqimin e individëve të përfshirë.

Për të vërtetuar gjetjet nga intervistat dhe hulumtimet dokumentare, dhe për të fituar njohuri sistematike se si sistemi i drejtësisë penale i Kosovës i angazhon viktimat gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, Amnesty International analizoi një mostër përfaqësuese të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë mbi procedurat penale të dhunës në familje që u shpallën më ose pas 1 janarit 2018 dhe u botuan deri më 12 dhjetor 2022, për të mbuluar një periudhë pesëvjeçare. Për të identifikuar popullatën e hulumtuar, Amnesty International kërkoi në bazat e të dhënave online të gjykatave në Kosovë për të identifikuar të gjitha aktgjykimet e dhunës në familje të disponueshme në domenin publik për këtë periudhë kohore. Ky kërkim identifikoi 1,637 aktgjykime për dhunën në familje, të cilat janë trajtuar nga Departamenti i Kosovës për Çështje të Përgjithshme, Divizioni Penal. Një mostër sistematike e rastësishme është nxjerrë për të përfaqësuar popullatën e aktgjykimeve sipas komunës dhe vitit. Një hulumtues/e lexoi çdo aktgjykim në mostër dhe nxori sistematikisht informata mbi të mbijetuarit, të pandehurit dhe procedimet penale. Përpunimi manual i aktgjykimeve të mostrës rezultoi në 197 raste me aktgjykime dënuese, duke mbuluar gjithsej 218 të pandehur dhe 255 të mbijetuar/a. Analiza empirike u krye duke përdorur gjuhën e programimit R për llogaritje statistikore. Një shtojcë që shoqëron këtë raport⁴ ofron informata të detajuara për

³ Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011, 0.9% e popullsisë ishin ashkali, 0.7% ishin kosovaro-egjiptianë dhe 0.5% ishin romë, 1.5% ishin serbë dhe 93% ishin shqiptarë. Shih: Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Popullsia sipas gjinisë, etnicitetit dhe studimit – 2011", prill 2013, ask.rks-gov.net/media/1613/popullsia-sipas-gjinis%C3%AB-eticitetit-dhe-vendbanimit.pdf, (qasur më 27 qershor 2023), faqe 11.

⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023).

çdo aspekt të metodologjisë sasiore të kërkimit (Seksioni A), analizën e thellë empirike të të dhënave të aktgjykimit (Seksioni B) dhe një manual të kodit që përshkruan procedurën e kodimit manual të përdorur (Seksioni C). Shtojca përfshin gjithashtu një vegëz me të dhënat e nxjerra nga Amnesty International për aktgjykimet, të pandehurit dhe të mbijetuarit. Shtojca është publikisht e disponueshme në www.amnesty.org.

Amnesty International ndau gjetjet e këtij raporti me autoritetet përkatëse, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Akademinë e Drejtësisë dhe Komunën e Prishtinës dhe kërkoi përgjigjen e tyre me shkrim për pretendimet specifike para publikimit të këtij raporti. Përgjigja nga Ministria e Drejtësisë e datës 22 gusht 2023 është pasqyruar, aty ku është relevante, në tekstin e raportit.

MIRËNJOHJET

Amnesty International u është mirënjohëse të gjitha të mbijetuarave të dhunës në familje, të cilët me aq guxim ndanë historitë e tyre për këtë raport. Organizata është gjithashtu mirënjohëse ndaj organizatave të shoqërisë civile për ndarjen e ekspertizës dhe njohurive të tyre, duke përfshirë Iniciativën për Drejtësi dhe Barazi; Institutin e Kosovës për Drejtësi; Rrjetin e Grave të Kosovës, Qendrën Kosovare për Studime Gjinore; Rrjetin e Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës; Roma Versitas; Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Sociale; Qendrën për Barazi dhe Liri; Gratë 4 Gratë në Kosovë; Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut; SIT – Qendrën për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime; Žensko Pravo dhe strehimoret në Gjakovë, Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Peja, Novobërdë, Zubin Potok në Kosovë dhe Strehën LGBTI në Shqipëri, të cilët ndanë njohuri të paçmueshme për dhunën në familje në Kosovë.

FJALORTH I TERMAVE

FJALA	PËRSHKRIMI DESCRIPTION
DHUNË ME BAZË GJINORE	Dhuna e drejtuar ndaj një personi për shkak të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore, duke përfshirë mospërshtatjen me normat konvencionale gjinore. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave është dhunë e drejtuar ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua apo dhunë që prek gratë në mënyrë joproporcionale dhe i ka rrënjët në diskriminim dhe pabarazi gjinore, abuzim të pushtetit dhe stereotipe dhe norma të dëmshme gjinore. Gratë dhe vajzat, personat LGBTI dhe personat e ndryshëm gjinorë janë të prekur në mënyrë joproporcionale nga dhuna me bazë gjinore, më së shpeshti e ushtruar nga burrat. Burrat dhe djemtë gjithashtu mund t'i nënshtrohen një dhune të tillë kur perceptohen se shkelin normat mbizotëruese gjinore dhe idetë shoqërore të maskulinitetit.
DHUNA NË FAMILJE	Përfshin të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë familjare ose ndërmjet bashkëshortëve ose ish-partnerëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nëse kryesi/ja ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. ⁵
MARTESË E DETYRUAR	Një martesë në të cilën njëra ose të dyja palët nuk kanë shprehur personalisht pëlqimin e plotë dhe të lirë për bashkimin. ⁶
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
TË MBIJETUARAT/VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE	Ky raport përdor termat 'viktimë' dhe 'i/e mbijetuar' i/e dhunës në familje në mënyrë të ndërsjellë për t'iu referuar personave që kanë përjetuar dhunë në familje. Qeveria e Kosovës gjithashtu përdor termat i/e mbijetuar dhe viktimë në mënyrë të ndërsjellë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunën ndaj Grave (2022-2026) si dhe në projektligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore, i cili po shqyrtohet nga Kuvendi i Kosovës. ⁷ Ndërsa e njuh termin "viktimë" si term të duhur ligjor, Amnesty International njuh po ashtu faktin se 'i/e mbijetuar' shpesh preferohet nga vetë disa të mbijetuar pasi pasqyron forcën dhe qëndrueshmërinë e atyre që kanë

⁵ Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), //www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=210 (qasur më 23 korrik 2023) (tash e tutje Konventa e Stambollit), neni 3(b).

⁶ OHCHR, "Martesa e fëmijëve dhe e detyruar, duke përfshirë mjediset humanitare", ohchr.org/en/women/child-and-forced-marriage-including-humanitarian-settings (qasja e fundit më 23 korrik 2023).

⁷ Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026, Janar 2022, kryeministri.rks-gov.net/en/blog/national-strategy-on-protection-against-domestic-violence-and-violence-against-women-2022-2026-14-03-2022-2/ (qasur më 23 korrik 2023); Projektligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, neni 3(19). kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/185PLperparandalimindhembrojtjenngadhunanefamilje_Srwcnty5zr.pdf (qasur më 23 korrik 2023).

FJALA	PËRSHKRIMI DESCRIPTION
	<p>përjetuar dhunë në familje. Është gjithashtu shpeshherë termi i preferuar nga aktivistët e të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë të intervistuar për këtë raport.</p>

SHKURTESAT

SHKURTESA	PËRSHKRIMI
KNT	Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese
KEDAG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CEL	Qendra për Barazi dhe Liri
KE	Këshilli i Evropës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
QPS	Qendër për Punë Sociale
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
PNDESK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
KKMPK	Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
LGBTI	Lezbike, gej, biseksual, transgjinnor dhe interseks
OJQ	Organizatë joqeveritare
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË: DEFINIMI I PROBLEMIT

Dhuna në familje është shkelje e të drejtave të njeriut. Dhuna në familje përfshin "të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose në njësisë familjare ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëhershëm ose aktualë, pavarësisht nëse kryesil/ja ndan ose jo të njëjtën banesë me viktimën".⁸ Mund të çojë në "vuajtje të rënda fizike dhe mendore, lëndime dhe gjithashtu në vdekje".⁹ Edhe pse dhuna në familje mund të prekë këdo, gratë, vajzat dhe personat LGBTI ndikohen në mënyrë joproporcionale.¹⁰ Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) vlerëson se një në tri gra në mbarë botën kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri/ja intim/e ose dhunë seksuale nga jopartneri/ja gjatë jetës së tyre.¹¹ Të dhënat zyrtare të Policisë së Kosovës thonë se shumica dërrmuese e rasteve të dhunës në familje në vend raportohen nga gratë dhe vajzat. Në vitin 2022, nga 2,764 raste të regjistruara me 2,817 viktima, 81% (2,294) ishin të gjinisë femërore.¹² Në 197 gjykime penale të veprave të lidhura me dhunën në familje të rishikuara nga Amnesty International për këtë raport, nga 255 të mbijetuar/a, 72% ishin femra, duke shkuar në 92,7% të të mbijetuarve/ave në rastet e lidhura me dhunën ndërmjet partnerëve¹³, ndërsa nga të gjithë 230 kryesit/et, mbi 90% ishin meshkuj.¹⁴

Qeveria aktuale e Kosovës, e cila mori detyrën në vitin 2021, e ka njohur dhunën në familje si një nga problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria kosovare. Kjo qeveri e bëri prioritet adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në planin e vet katërvjeçar dhe më pas miratoi një Strategji Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026).¹⁵ Që nga viti 2019, dhuna në familje është vepër e veçantë penale në Kosovë dhe dënohet me gjobë që varion nga shuma 100 euro deri në maksimumin prej 25,000 eurosh¹⁶ dhe deri në tri vjet burgim.¹⁷

⁸ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 3(b).

⁹ KE, "Dhuna në familje ose dhuna në marrëdhëniet intime", coe.int/en/web/gender-matters/domestic-violence-or-violence-in-intimate-relations (qasur më 17 korrik 2023).

¹⁰ Grupi i Bankës Botërore, "Jeta në margjina: Rezultatet e anketës së përvojave të personave LGBTI në Evropën Juglindore", 2018, openknowledge.worldbank.org/server/api/core/bitstreams/df4755b4-021c-5ef6-b0de-28697/përmbajtja (qasur më 23 korrik 2023).

¹¹ OBSh, "Dhuna ndaj grave, fakte kyçe", 9 mars 2021, who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women (qasur më 23 korrik 2023).

¹² Amnesty International, përgjigjja nga Policia e Kosovës ndaj një Kërkese të Amnesty International për informata mbi statistikën e dhunës në familje në Kosovë, 31 janar 2023.

¹³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1 Viktimat, Figura 2: Shpërndarja krahasuese e gjinisë së viktimave, sipas llojit të marrëdhënies.

¹⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.2 Të pandehurit, Figura 4: Shpërndarja krahasuese e gjinisë së të pandehurit, sipas llojit të marrëdhënies.

¹⁵ Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (cituar më parë), faqe 5-6.

¹⁶ Kodi Penal i Kosovës 06/L-074 i Republikës së Kosovës, 2019, i qasshëm në [//gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413), (qasur më 25 gusht 2023), Neni 43.

¹⁷ Kodi Penal i Kosovës, Neni 248.

Ka pasur rritje të vazhdueshme të viktimave që raportojnë dhunën në familje tek autoritetet që nga viti 2018.¹⁸ Në vitin 2019, Policia e Kosovës ka regjistruar 1,915 raste, nga 1,533 në vitin 2018. Viti 2022 shënoi shkallën më të lartë deri më tani, me 2,764 raste të raportuara.¹⁹

Sado alarmante që janë, shifrat ka të ngjarë të jenë më të ulëta se numri i rasteve aktuale të dhunës në familje për shkak të shumë të mbijetuarave që vendosin të mos raportojnë abuzimin tek autoritetet. Një studim i vitit 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) zbuloi se 54% e 1,990 grave të moshës 18-74 të anketuara në Kosovë raportuan se kishin përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri i tyre intim pas moshës 15 vjeçare.²⁰ Gati dy të tretat, ose 64%, thanë se mendonin se dhuna nga partnerët, të njohurit ose të panjohurit ishte shumë ose mjaft e zakonshme. Për më shumë, 48% e grave të anketuara besonin se dhuna në familje është çështje private që duhet të zgjidhet brenda familjes. Sipas anketës së OSBE-së, besime të tilla “kontribuojnë në pabarazinë gjinore dhe një mjedis ku dhuna ndaj grave tolerohet”.²¹ Gjetjet sugjerojnë se shumica e viktimave nuk e raportojnë dhunën tek institucionet përkatëse (policia, sektori shëndetësor, sektori social apo gjyqësori) apo t'i përdorin shërbimet e specializuara të ofruara nga OJQ-të. Njëmend, 19 nga 20 të mbijetuarat e intervistuar nga Amnesty International raportuan se kishin përjetuar dhunë psikologjike dhe fizike për shumë vite përpara se të shkonin përfundimisht në polici; shumica kërkojnë ndihmë vetëm pasi kanë frikë se dhunuesi i tyre mund t'i vrasë.²² Përfaqësuesit e strehimoreve dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë me të mbijetuarat e dhunës në familje, si dhe Zëvendës-Kryeprokuroria e Shtetit, konfirmuan për Amnesty International se të mbijetuarat kanë tendencë të kërkojnë ndihmë pas dhunës së zgjatur dhe se incidentet mbeten dukshëm të nënraportuara.²³

Procedurat Standarde Operative të Policisë së Kosovës për Parandalimin dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje: Policia e Kosovës ka zhvilluar procedura standarde të veçanta operative për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të miratuara në prill 2022. Procedurat e reja standarde të veprimit ofrojnë udhëzime të detajuara për punonjësit e policisë dhe ndjekin tri synime: 1) parandalimin e dhunës në familje; 2) ofrimin e mbështetjes dhe sigurisë për viktimat dhe të tjerët; 3) zhvillimin e një hetimi profesional për të gjitha raportet e abuzimit në familje.¹¹⁷ Ajo përfshin disa zhvillime pozitive, duke përfshirë kërkesën që stacionet e policisë të kenë të paktën një zyrtar/e policor/e të specializuar për dhunën në familje. Megjithatë, në procedurat standarde të operimit ka një mbitheksim të rëndësishëm dhe mbrojtjes së familjes si “bazë e çdo shoqërie”, në vend të të drejtës njerëzore të çdo individi për të jetuar i lirë nga dhuna.¹¹⁸ Aty thuhet se zyrtarët e policisë duhet të marrin në konsideratë një “perspektivë gjinore” në rastet e dhunës në familje,¹¹⁹ pa shpjeguar se çfarë do të thotë kjo në praktikë. Dokumenti njuh dhunën në familje si shkelje të të drejtave të njeriut; megjithatë, nuk përmend se prek gratë dhe vajzat në mënyrë joproporcionale sepse janë gra dhe vajza.

¹¹² Ligji për Barazi Gjinore (i cituar më parë), Neni 7.

¹¹³ Ligji për Barazi Gjinore (i cituar më parë), Neni 7.

¹¹⁴ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (e cituar më parë).

¹¹⁵ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (e cituar më parë), faqe 21.

¹¹⁶ Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore (i cituar më parë).

¹¹⁷ Policia e Kosovës, Procedurat Standarde Operative për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje, 8 Prill 2022, të ofruara për Amnesty International nga Policia e Kosovës, faqe 3.

¹¹⁸ Policia e Kosovës, Procedurat Standarde Operative për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje (e cituar më parë), faqe 3.

¹¹⁹ Policia e Kosovës, Procedurat Standarde Operative për Parandalimin dhe Trajtimin e Dhunës në Familje (e cituar më parë), faqe 7.

SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLEN TË MBIJETUARAT QË PËRPIQEN TË LARGOHEN NGA MARRËDHËNIET ABUZIVE

Ky seksion i raportit ndjek shtegun e të mbijetuarave që përpiqen të largohen nga situatat e dhunës në familje. Përshkruan sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat kur përpiqen t'u qasen informatave, mbrojtjes, shërbimeve mbështetëse dhe drejtësisë, dhe diskuton se si këto sfida ndikojnë në aftësinë e të mbijetuarave për të ndjekur pavarësinë dhe për të jetuar të lira nga dhuna psikologjike dhe fizike. Siç tregon ky hulumtim, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të Kosovës në vitet e fundit për të forcuar legjisllacionin dhe për të përmirësuar politikën në adresimin e nevojave të të mbijetuarave, grave dhe vajzave që përpiqen të largohen nga situatat abuzive përballen me barriera të shumta. Këto përfshijnë mungesën e informatave për ndihmën e disponueshme, trajtimin pa respekt nga zyrtarët policorë, punonjësit socialë të mbingarkuar dhe shërbimet e pamjaftueshme mbështetëse. Gjithashtu përballen me pengesa për marrjen e mbrojtjes dhe qasjen në drejtësi dhe mjete juridike, duke përfshirë mbështetjen afatgjatë dhe mundësitë ekonomike për një jetë të pavarur pa dhunë.

3.1 DËSHTIMI PËR T'U OFRUAR TË MBIJETUARAVE QASJE ADEKUATE NË INFORMATA

Largimi nga një situatë dhune në familje është sfidues dhe shpesh kërkon planifikim. Për të marrë vendime të informuara në lidhje me opsionet e tyre, të mbijetuarat duhet të dinë se cilat shërbime mbështetëse dhe mbrojtëse shtetërore janë në dispozicion. Megjithatë, shumica e të mbijetuarave raportojnë se nuk kanë informata për të drejtat e tyre ose shërbimet e disponueshme para se t'i raportojnë rastet e tyre tek

autoritetet.¹²⁰ Hulumtimi i Amnesty International gjeti zbrazëti të shumta në ofrimin e informatave për viktimat e dhunës në familje, dhe autoritetet përgjegjëse shpesh dështojnë të sigurojnë që informatat përkatëse të jenë të disponueshme dhe lehtësisht të qasshme për ata/ato që kanë nevojë.

3.1.1 MUNGESA E NJË LINJE TË SPECIALIZUAR TË NDIHMËS

Kosova aktualisht nuk ka asnjë linjë telefonike ndihmëse të posaçme për personat e prekur nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Konventën e Stambollit.¹²¹ Megjithatë, në momentin e shkrimit, të mbijetuarat e dhunës në familje mund t'i qaseshin linjës 24-orëshe të ndihmës së Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave për të gjitha viktimat e krimit dhe linjës së përgjithshme 24-orëshe të urgjencës të operuar nga policia në rast rreziku të menjëhershëm. Përveç kësaj, disa OJQ që drejtonin strehimoret lokale operonin linja të specializuara telefonike rajonale.

Linja e ndihmës e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave ka për detyrë t'u ofrojë të mbijetuarave të dhunës në familje informata praktike në lidhje me shërbimet e referimit, si dhe të bëjë referime në institucionet përkatëse - si strehimoret dhe shërbimet sociale.¹²²

Një raport i Zyrës së Prokurorit të Shtetit i vitit 2022 tregon se mes janarit dhe shtatorit 2022, linja e ndihmës e Zyrës së Mbrojtjesve të Viktimave ka pranuar gjithsej 336 thirrje për të gjitha krimet.¹²³ Sipas ish-drejtorit të Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave, numri i thirrjeve në këtë linjë ndihmëse ka qenë në rënie të vazhdueshme që nga viti 2020.¹²⁴ Kjo është mjaft befasuese duke marrë parasysh se, gjatë të njëjtës periudhë, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës është rritur ndjeshëm, nga 2,101 raportime në vitin 2020 në 2,793 raportime në vitin 2022, dhe, siç u diskutua më lart, ka të ngjarë të pasqyrojë vetëm një pjesë të rasteve.¹²⁵ Hulumtimi i Amnesty International zbuloi se të mbijetuarat e intervistuarat nuk ishin në dijeni të linjës ndihmëse.

Megjithëse autoritetet pretendojnë se linja e ndihmës reklamohet gjerësisht çdo vit, kryesisht gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore (25 nëntor deri më 10 dhjetor) dhe javës kombëtare të të drejtave të viktimave të krimit në tetor,¹²⁶ shqyrtimi nga Amnesty International i materialeve të fushatës zbuloi se e vetmja linjë ndihmëse e promovuar gjatë 16 ditëve të aktivizimit ishte numri i përgjithshëm i urgjencës i operuar nga policia.¹²⁷ Një fushatë qeveritare e zhvilluar gjatë 16 ditëve të aktivizimit në 2022 përfshinte reklama të sponsorizuara në televizionin kombëtar dhe media sociale,¹²⁸ si dhe mesazhe të përgjithshme SMS, duke i bërë thirrje publikut të raportonte rastet e dhunës në familje në Polici, por në përgjithësi nuk përfshinte asnjë numër tjetër kontakti.

Ndërhyrje të tilla si fushatat informuese duhet të ndodhin gjatë gjithë vitit për të siguruar qasje me kohë dhe efektive në informata gjithëpërfshirëse për ata/ato që kanë nevojë. Fushatat e informimit publik dhe ndërgjegjësimi duhet të trajtojnë gjithashtu çështje të tjera, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje,¹²⁹ duke përfshirë martesat e detyruara dhe të hershme, dhe të sfidojnë perceptimin publik të dhunës në familje si çështje private. Informatat duhet të jenë të disponueshme në shumë gjuhë dhe në formate të qasshme. Aktualisht,

¹²⁰ Amnesty International, Intervista me të mbijetuarat e dhunës në familje "Ana", "Edona", "Kaltrina", "Diella", "Diana", "Filloreta", "Eliza", "Gresa A", "Gresa B", "Dina", "Mejrem", "Vjollca", "Larta" dhe "Pati", (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-dhjetor 2022.

¹²¹ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 24.

¹²² Prokuroria e Shtetit, "Zyra e Linjës Ndhimëse", prokuroria-rks.org/psh/zmnv/70/linijat-ndihmese (qasur më 24 korrik 2023).

¹²³ Zyra e Prokurorit të Shtetit, Raporti nëntëmujor i punës së prokurorit të Shtetit, nëntor 2022, prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Raporti%20i%20punes%20se%20Prokurorit%20e%20Shtetit%20janar-shtator%202022.pdf, (qasur më 25 gusht 2023), faqe 80.

¹²⁴ Amnesty International, Intervistë e zhvilluar personalisht me Basri Kastratin, (tani ish) Drejtor i Zyrës së Mbrojtjesve të Viktimave, qershor 2022.

¹²⁵ Amnesty International, përgjigja e Policisë së Kosovës ndaj një kërkesë të Amnesty International për informata mbi statistikat e dhunës në familje në Kosovë, janar 2023.

¹²⁶ Amnesty International, Intervistë me Basri Kastratin, drejtor i atëhershëm i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave, gusht 2022. Zyra e Prokurorit të Shtetit, Fjalimi i Kryeprokurorit të Shtetit, "Aleksandër Lumezi me rastin e mbajtjes së 'Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit'", 19 tetor 2020, prokuroria-rks.org/psh/aktivitetet-prokurorit-single/6059 (qasur më 25 gusht 2023).

¹²⁷ Ministria e Drejtësisë, "Kalendari zyrtar i fushatës globale 16 ditë të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore", 24 nëntor 2022, md.rks-gov.net/desk/inc/media/238A167D-C5F8-48CA-8154-881579D835ED.png. (qasur më 25 gusht 2023).

¹²⁸ Zyra e Kryeministrit, "Mesazhi i Kryeministrit Albin Kurti", 25 nëntor 2022, facebook.com/MinistriaeDrejtisesive/videos/545046044141082, (qasur më 25 gusht 2023).

¹²⁹ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 13.

operatorët e linjës së ndihmës të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave ofrojnë mbështetje dhe informata në gjuhën shqipe dhe serbe dhe mund të lidhin të mbijetuarat me mbrojtësit e viktimave që flasin turqisht, por linja e ndihmës nuk është e qasshme në gjuhën rome.¹³⁰

Fushatat informuese të kufizuara në kohë dhe mungesa e informatave gjithëpërfshirëse dobësojnë efektivitetin e përpjekjeve të qeverisë për të informuar publikun, ndërsa fokusi te policia si pika kryesore e kontaktit kontribuon që policia në praktikë të shëndrrohet në "rojë të portës" që kontrollon se kush ka qasje në shërbimet për të mbijetuarat e dhunës në familje.

OJQ-të kanë ndërhyrë për të mbushur boshllëkun. Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, e cila si të gjitha strehimoret e tjera në Kosovë menaxhohet nga një OJQ, operon një linjë ndihmëse 24-orëshe pa pagesë që ofron informata për të mbijetuarat se si të kërkojnë mbrojtje.¹³¹ Për më shumë, stafi u jep informata të mbijetuarave përmes mesazheve me tekst ose emailve. Sipas drejtores, komunikimi me celular dhe me email ishte veçanërisht i rëndësishëm gjatë ngujimit Covid-19 në 2020, kur shumë të mbijetuarat ishin në shtëpi me abuzuesit e tyre dhe nuk mund të bënin telefonata të sigurta.¹³² Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave aktualisht nuk ofron ndonjë shërbim të ngjashëm, por drejtori i atëhershëm i zyrës konfirmoi se ata po konsideronin zgjerimin e shërbimeve për të ofruar informata përmes mesazheve të çastit në internet, mesazheve SMS apo email.¹³³

Strehimore të tjera të drejtuara nga OJQ-të në Kosovë kanë filluar nisma të ngjashme rajonale. Në Prishtinë,¹³⁴ Prizren,¹³⁵ Mitrovicë,¹³⁶ Pejë,¹³⁷ Novobërdë¹³⁸ dhe Gjiilan,¹³⁹ të mbijetuarat mund të kontaktojnë strehimoret duke telefonuar në numrat e tyre zyrtarë të telefonit me tarifata normale të aplikueshme, ose online.

Sidoqoftë, strehimoret, të cilat drejtohen nga OJQ, nuk kanë staf që flet gjuhën rome. Për shkak të përjashtimit social, diskriminimit dhe vështirësive ekonomike, gratë rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me shumë pengesa në qasjen në informata të përshtatura, mbështetje dhe mbrojtje nga OJQ-të. Mungesa e qasjes në informata, e kombinuar me mosbesimin në institucionet publike, frikën nga stigma, hakmarrjen e abuzuesit dhe mungesën e pavarësisë financiare, lë shumë pjesëtarë të këtyre komuniteteve tashmë të marginalizuara pa qasje në ndihmën urgjente që u nevojitet.¹⁴⁰

Në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore (2022-2026), Qeveria e Kosovës u zotua të krijojë një linjë efektive 24-orëshe ndihmëse e cila do të ishte e specializuar për të trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe të ofrojë informata dhe këshilla në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.¹⁴¹ Pavarësisht këtij angazhimi, sipas një raporti të Ministrisë së Drejtësisë të marsit 2023, planifikimi buxhetor për krijimin dhe funksionalizimin e linjës së ndihmës nuk është bërë ende.¹⁴² Në përgjigje të kërkesës zyrtare të Amnesty International për informata, Ministria e Drejtësisë tha se institucioni drejtues për krijimin e linjës së ndihmës është Ministria e Shëndetësisë dhe nuk dha informata shtesë për hapat e ndërmarrë për të adresuar këtë çështje.¹⁴³ Sipas Strategjisë Kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje, sidoqoftë, institucionet që ndajnë përgjegjësinë për krijimin e linjës ndihmëse janë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia për Barazi Gjinore.¹⁴⁴

¹³⁰ KE, *Vlerësimi i përafërimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit*, 2022, rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-eng/1680a9203e (qasur më 25 gusht 2023), faqe 50.

¹³¹ Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, Rreth nesh, <https://shtepiaesigurt.com/rreth-nesh/> (qasur më 23 korrik 2023).

¹³² Amnesty International, Intervistë me Erëblina Dinarama, drejtore e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, gusht 2022.

¹³³ Amnesty International, Intervistë me Basri Kastratin, gusht 2022.

¹³⁴ Amnesty International, Intervistë me Zana Hamitin, drejtore e strehimores në Prishtinë, maj dhe gusht 2022.

¹³⁵ Amnesty International, Intervistë me Jubilea Kabashin, drejtore e strehimores në Prizren, korrik 2022.

¹³⁶ Amnesty International, Intervistë me Fidane Hysenin, drejtore e strehimores në Mitrovicë, gusht 2022.

¹³⁷ Qendra për Mbrojtjen e Gruas Pejë, qmg-ks.org/kontakt/ (qasur më 24 korrik 2023).

¹³⁸ Amnesty International, Intervistë me Vesna Stajić, drejtore e strehimores në Novobërdë, shtator 2022.

¹³⁹ Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria" Gjiilan, facebook.com/QMRGF (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁴⁰ KE, *Vlerësimi i përafërimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 18.

¹⁴¹ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 101.

¹⁴² Raporti Vjetor mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (i cituar më parë), faqe 13.

¹⁴³ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Përgjigje Zyrtare ndaj gjetjeve të hulumtimit të Amnesty International mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës në familje, 22 gusht 2023. Në dosje të Amnesty International.

¹⁴⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 100-101.

Në vitin 2022, Këshilli i Evropës (KE) dhe GREVIO – organi i pavarur i ekspertëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit nga shtetet – mirëpritën përkushtimin e Kosovës për të krijuar një linjë ndihmëse 24-orëshe në përputhje me Konventën e Stambollit dhe i bënë thirrje qeverisë të sigurojë që linja e ndihmës të jetë falas, anonime, gjatë gjithë kohës, konfidenciale, e disponueshme në të gjithë territorin dhe në të gjitha gjuhët përkatëse, e aftë për të ofruar këshillim për viktimat dhe e operuar nga një staf i kualifikuar dhe i trajnuar.¹⁴⁵

Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë informata gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjitha shërbimet dhe burimet në dispozicion për të mbijetuarat e dhunës në familje përmes kanaleve të ndryshme dhe të bëjë përpjekje të veçanta për të arritur te të mbijetuarat që përballen me forma të shumta dhe ndërthurëse të diskriminimit, duke përfshirë të mbijetuarat nga komunitetet serbe, turke, rome, ashkali dhe egjiptiane, të mbijetuarat LGBTI, ato që jetojnë në zona të largëta ose rurale, dhe të mbijetuarat me aftësi të kufizuara, ndër të tjera.

3.1.2 MUNGESA E INFORMATAVE PËR SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Pavarësisht nga detyrimi i qartë ligjor i autoriteteve për të informuar plotësisht viktimat e dhunës në familje për të drejtat e tyre, si dhe për të ofruar informata në lidhje me shërbimet ligjore, psikologjike dhe shërbime të tjera, duke përfshirë strehimoret, 15 nga 20 të mbijetuarat e intervistuarat nga Amnesty International raportuan se nuk i kishin këto informata kyçe kur përjetuan dhunë.¹⁴⁶ Për më shumë, hulumtimi i Amnesty International gjeti zbrazëti të konsiderueshme në informatat që institucionet e ndryshme ua kanë ofruar viktimave të dhunës në familje që iu drejtuan atyre për ndihmë.

Informatat rreth strehimoreve që funksiononin në të gjithë vendin nuk ishin në dispozicion për të mbijetuarat. Zana Hamiti, drejtore e Strehimoreve në Prishtinë, ka rrëfyer një rast nga qershori i vitit 2022 kur një e mbijetuar me lëndime të marra nga abuzimi udhëtoi një orë me autobus nga Mitrovica për në strehimore me katër fëmijët e saj. Gruaja nuk ishte në dijeni se kishte një strehimore në Mitrovicë dhe kishte udhëtuar për në Prishtinë pasi e kishte parë Zana Hamitin në televizion duke folur për strehimoren e Prishtinës.¹⁴⁷

Të mbijetuarat shpeshherë raportuan se kishin marrë vesh për masat e mbrojtjes ligjore, shërbimet mbështetëse dhe institucionet përkatëse vetëm pasi kishin raportuar rastet e tyre në polici. Ndërsa ky ishte rasti me 19 nga 20 të mbijetuarat me të cilat foli Amnesty International, në të paktën katër raste të dokumentuara gjatë hulumtimit, policia nuk kishte arritur t'i informonte gratë se shkuarja në një strehimore ishte opsion.¹⁴⁸

"Diana" nga Prishtina ka denoncuar bashkëshortin e saj në polici pasi kishte përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike për tri vite. Ajo i tha Amnesty International se policia nuk i kishte thënë kurrë se mund të shkonte në strehimore. Pasi raportoi burrin e saj, ajo fjeti në makinën e saj për një javë pasi kishte shumë frikë të shkonte në shtëpi. "Askush nuk më ofroi strehim, ushqim, asgjë," tregoi ajo.¹⁴⁹ Hulumtimi i Amnesty International konfirmoi se, në disa raste, policia dështoi të jepte informata në lidhje me shërbimet mbështetëse për të mbijetuarat, pavarësisht se është e detyruar ligjërisht ta bëjë këtë.¹⁵⁰ Po kështu, në një anketë të qeverisë të vitit 2019 me 100 policë nga 18 komuna të Kosovës, 79 nuk i përmendën strehimoret si shërbim kyç për viktimat e dhunës në familje.¹⁵¹

Mungesa e informatave duket të jetë problem sistematik. Një anketë e OSBE-së e vitit 2019 me pothuajse 2,000 gra që jetonin në Kosovë tregoi se shumica e tyre nuk ishin të informuara për shërbimet e specializuara mbështetëse, apo çfarë mund të bëjnë nëse përjetojnë dhunë.¹⁵² Mungesa e informacionit për

¹⁴⁵ KE, *Vlerësimi i përafritimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 152.

¹⁴⁶ Intervista me të mbijetuarat e dhunës në familje "Ana", "Edona", "Kaltrina", "Diella", "Diana", "Filloreta", "Eliza", "Gresa A", "Gresa B", "Dina", "Mejrem". "Vjollca", "Learta", "Maja" dhe "Pati" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-dhjetor 2022.

¹⁴⁷ Amnesty International, Intervistë me Zana Hamitin, maj 2022.

¹⁴⁸ Intervista me "Diellën", "Dianën", "Nitën" dhe "Filloretën" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁴⁹ Intervistë me "Dianën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁵⁰ Amnesty International, Intervista me të mbijetuarat e dhunës në familje "Filloreta", "Nita", "Edona", "Diana", "Gresa A" dhe "Gresa B", (emrat janë ndryshuar për anonimitet) qershor-shtator 2022. Ligji për mbrojtjen kundër dhunës në familje (i cituar më parë), Neni 24(3.3).

¹⁵¹ Agjencia për Barazi Gjinore, "Vlerësimi i nivelit të zbatimit të procedurave standarde të veprimtimit për mbrojtjen nga dhuna në familje", shtator 2019, [abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20ABGJ%20-%20Versimi%20i%20nivelit\(1\).pdf](http://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20ABGJ%20-%20Versimi%20i%20nivelit(1).pdf) (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁵² OSBE, "Anketa mbi dhunën ndaj grave – Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë", (e cituar më parë), faqe 83.

shërbimet mbështetëse minon drejtpërdrejt fuqinë vendimmarrëse të të mbijetuarave dhe potencialisht i lë ato në rrezik për abuzim.

Ligji dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që Kosova të marrë masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të siguruar që të mbijetuarat e dhunës në familje të marrin informata adekuate dhe në kohë mbi shërbimet mbështetëse dhe masat ligjore në gjuhë dhe formate të qasshme.¹⁵³ Në vitin 2022, raporti i KE/GREVIO u kërkoi autoriteteve të Kosovës t'i përmbushin detyrimet e tyre ndërkombëtare në këtë drejtim.¹⁵⁴ Konventa e Stambollit i obligon shtetet të krijojnë një linjë telefonike falas 24-orëshe në të gjithë shtetin për të ofruar këshilla konfidenciale për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Konventa gjithashtu nxit shtetet që t'i kontaktojnë në mënyrë proaktive për viktimat, dhe të përgjigjen menjëherë dhe në mënyrë adekuate duke ofruar mbrojtje të përshtatshme dhe të menjëhershme për të gjitha viktimat.¹⁵⁵

¹⁵³ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), paragrafët 30(b)(ii) & 31(d). Shih gjithashtu Konventën e Stambollit (e cituar më parë), Neni 56 (1).

¹⁵⁴ KE, Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit (e cituar më parë), para. 123.

¹⁵⁵ Istanbul Convention (e cituar më parë), Articles 24 & 50. Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Nenet 24 dhe 50.

DËSHTIMI I POLICISË NDAJ VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

“Sot me m’ndodhë diçka, s’e thrras kurrë policinë.”

“Nita”, e mbijetuar e dhunës nga Prishtina¹⁵⁶

Policia luan rol të rëndësishëm në parandalimin dhe mbrojtjen e njerëzve nga dhuna në familje. Për shumicën e të mbijetuarave në Kosovë, policia është pika e parë e kontaktit kur vendosin të largohen nga një situatë abuzive.¹⁵⁷ Rishikimi rishtazi i procedurave standarde të veprimit të policisë rithekson detyrën e tyre për të trajtuar rastet e dhunës në familje në mënyrë të përqendruar te viktima dhe është bërë progres në emërimin e zyrtarëve të specializuar të policisë për të trajtuar rastet e dhunës në familje në secilin stacion policor.¹⁵⁸ Megjithatë, gjetjet e Amnesty International theksojnë dështimet e vazhdueshme të policisë për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate raporteve të dhunës në familje. Shumica e të mbijetuarave të intervistuarra për këtë raport u përballën me sfida në raportimin e rasteve të tyre në polici, duke përfshirë mosbesimin dhe qëndrimet përçmuese. Ato raportuan se zyrtarët e policisë i kthyen mbrapa, i bënë të ndiheshin fajtorë ose u përpoqën t’i dekurajonin nga denoncimi, i nënçmuan ose i fajësuan për dhunën që kishin përjetuar.

4.1 VIKTIMAT PËRBALLEN ME MOSBESIM DHE PARAGJYKIME NGA POLICIA

Dhjetë nga 19 të mbijetuarra, duke përfshirë tetë gra cis dhe dy gra trans, i përshkruan zyrtarët policorë si mosrespektues, paragjykes ose që nuk i morën rastet e tyre seriozisht. Sjellja e zyrtarëve të policisë shpesh përcillte qëndrime të forta patriarkale dhe një besim se dhuna në familje ishte çështje familjare apo edhe normale në një marrëdhënie. “Diella”, një e mbijetuar nga Prishtina, e cila kishte denoncuar disa herë bashkëshortin e saj për dhunë fizike dhe psikologjike, shkoi në polici për ta denoncuar atë për hakimin e vazhdueshëm të llogarive të saj online, duke përfshirë emaillet dhe llogaritë në rrjetet sociale. “Diella” u

¹⁵⁶ Intervistë me “Nitën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁵⁷ Amnesty International intervistoi 20 të mbijetuarra për këtë raport; 18 prej tyre kishin i raportuar rastet e tyre fillimisht përmes policisë. Policia e Kosovës dhe qeveria e njohin faktin se policia është pika e parë e kontaktit për viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave. Shih: Policia e Kosovës, Procedurat Standarde Operative për Parandalimin dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje, 8 prill 2022, faqe 8, para. c. Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 24.

¹⁵⁸ Amnesty International, Intervistë me Kapitenin e Policisë Arsim Shala, Shef i Njësisë për Parandalimin e Dhunës në Familje në Drejtorinë e Përgjithshme të Komunitetit dhe Parandalimit Policor, qershor 2022. Policia e Kosovës, Procedurat Standarde Operative për Parandalimin dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje (e cituar më parë).

referua në departamentin e krimit kibernetik, ku, tregoi ajo, një polic nuk e trajtoi seriozisht rastin e saj dhe i tha se “gratë lypin rrehë”.¹⁵⁹

“Nita” nga Prishtina, e cila kishte denoncuar bashkëshortin pas tri vitesh të dhunës së vazhdueshme psikologjike, ekonomike, fizike dhe seksuale, tregoi se si një zyrtare policore u përpoq ta bënte të ndihej keq për raportimin e rastit. Ajo tha se zyrtarja që ishte duke ia marrë deklaratën i tha se nëse ajo do ta denonconte burrin e saj, ai do ta humbiste punën. “Kjo m’shtini me e fajësu veten”, tha ajo.¹⁶⁰

“Nita” tregoi gjithashtu se si kishte qëndruar katër orë në stacion policor dhe ishte ndier e tallur nga zyrtarët policorë. Ajo e përshkroi për Amnesty International se si zyrtarët policorë hynin dhe dilnin nga dhoma e intervistimit, duke e ndërprerë atë ndërsa po jepte deklaratën dhe duke e detyruar të përsërisë përvojat e saj traumatike disa herë. Në një moment, një zyrtare policore u përpoq të zvogëlonte dhe normalizonte krimet të cilave u ishte nënshtruar “Nita” nga i shoqi, duke thënë: “Hajt mos e bo kaq të madhe. Edhe burri jem qishte ma bon. Krejt burrat jon qishte.” E njëjta zyrtare i tha më vonë: “Mos gabo me u pajtu me to e me u kthi tani te na për ndihmë, qysh po ja boni do prej juve.” Pas kësaj përvoje, “Nita” i tha Amnesty International se nuk do ta thirrte më policinë nëse do t’i ndodhte diçka.¹⁶¹

Pesë gra të intervistuar që kishin denoncuar më parë dhunën thanë se policia tregon shumë padurim dhe shpesh i fajëson ato për dhunën që kanë pësuar.¹⁶² “Ata [policia] zakonisht janë shumë të paduruar – veçanërisht nëse thirren disa herë”, tha “Maja” nga Mitrovica e Veriut për Amnesty International. “Maja” u detyrua të telefononte vazhdimisht policinë për të zbatuar vendimin e gjykatës për kujdestarinë e fëmijë, sepse ish-bashkëshorti i saj shpeshherë nuk e kthente fëmijën pasi kalonte kohë me të. “Kur i telefonoj për të denoncuar burrin tim, ata bezdisen me mua. Më trajtojnë sikur ky të ishte faji im, jo i tij.”¹⁶³

Gratë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me paragjykimet dhe qëndrime diskriminuese shtesë bazuar në përkatësinë e tyre etnike. Qendresa Ademi, asambleiste në Kuvendin Komunal të Fushë Kosovës, tha për Amnesty International se kur gratë rome, ashkali dhe egjiptiane i raportojnë rastet në polici, ato shpesh përballen me komente paragjykuese dhe qëndrime fajësuese të bazuara në stereotipe negative që ekzistojnë që më parë, si: “Hajt se jeni msu ju qishte m’u rrehë me njani-tjetrin. Çka po haliteni?” Qendresa Ademi theksoi se komente të tilla rrisin nivelin e mosbesimit në polici dhe kontribuojnë në nënraportim.¹⁶⁴

“Gresa B.”, grua egjiptiane nga Gjakova, ka treguar se si vendosi t’i jepte edhe një shans burrit të saj pasi gjykata i dha atij një vit dënim me kusht për dhunë në familje. “Ai i premtoi gjykatës që kurrë ma nuk ka me m’prekë me gisht”, tha ajo. Megjithatë, burri i saj rifilloi dhunën ndaj saj kur i skadoi dënimi me kusht. Ajo kujtoi:

“Shkova në polici, por ata s’ëm murrën seriozisht se ja kom falë ni herë ma herët. ‘Ja ki fal’ m’thanë ‘nuk kemi çka me t’ba’.”¹⁶⁵

4.2 ZYRTARËT POLICORË ZVOGËLOJNË PËRVOJAT DHE DËSHMITË E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS

Hulumtimi i Amnesty International zbuloi se zyrtarët policorë shpesh minimizonin seriozitetin e abuzimit psikologjik dhe tjetër dhe nuk e merrnin seriozisht ose si të besueshëm dëmin që viktimat raportnin se u ishte shkaktuar atyre, përveç nëse kishin lëndime të dukshme ose shenja të tjera fizike të dhunës.¹⁶⁶ Policia jo vetëm që mohonte dëmin e shkaktuar, por shkonte më tej, duke bërë komente se si sjellje të tilla të kontrollit shtrëngues janë normale dhe jo kriminale. Për shembull, “Maja” nga Mitrovica e Veriut ka rrëfyer se si policia e tallte atë kur ajo e raportoi burrin e saj për abuzim psikologjik dhe ekonomik. “Ata më thanë se

¹⁵⁹ Intervistë me “Diellën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶⁰ Intervistë me “Nitën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶¹ Intervistë me “Nitën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶² Intervista me “Diellën”, “Edonën”, “Gresën B”, “Nitën”, “Majën”, (emrat janë ndryshuar për anonimitet), qershor-tetor 2022.

¹⁶³ Intervistë me “Majën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶⁴ Amnesty International, Intervistë me Qendresa Ademin, tetor 2022.

¹⁶⁵ Intervistë me “Gresa B.” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

¹⁶⁶ Amnesty International, Intervista me të mbijetuarat “Diella”, “Edona”, “Gresa B”, “Maja”, “Nita”, “Mimoza” dhe “Diana” (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-tetor 2022. Intervistë me Arrita Rezniciqin, Instituti i Kosovës për Drejtësi, qershor 2022.

nuk ka diçka të tillë [si abuzim ekonomik]. Ata thanë gjithashtu se burri im kishte të drejtë të më mohonte mbështetjen financiare sepse në familje ishte ai që punonte dhe bënte para”.¹⁶⁷

Të mbijetuara të tjera raportuan ngjashëm se zyrtarët e policisë i morën seriozisht vetëm pasi panë mavijosje në trupat e tyre. “Diana” nga Prishtina ka pësuar dhunë të përsëritur nga ish-bashkëshorti dhe vjehrra e saj. Në një rast në vitin 2017, kur ajo shkoi në polici nga frika se burri i saj do ta vriste, zyrtarët e policisë e vunë në pikëpyetje karakterin e saj dhe e pyetën nëse ajo kishte ndonjë aferë jashtëmartesore. “Fillova me i bërthitë policisë e i përvjela mangët për me ia kallxu mavijosjet në krahë e i pyeta: ‘A doni me pritë deri sa t’ më vret e me ardhë me ma marrë trupin tem të vdekt a?’” “Diana” tha se zyrtarët policorë ndryshuan qëndrim sapa panë lëndimet. Ata thirrën ndihmësmjekët të cilët menjëherë kryen një ekzaminim mjekësor.¹⁶⁸

“Diella” nga Prishtina ka pasur ndërveprime të shumta me policinë. Ajo përshkroi se si, kur kishte lëndime të dukshme fizike në kokë, fytyrë dhe krahë, zyrtarët policorë ishin shumë mbështetës dhe i dhanë asaj informata, duke përfshirë për rreziqet e situatës së saj. Ata thirrën gjithashtu ndihmësmjekët që mbërritën menjëherë, dhe ajo pranoi raport mjekësor që dokumentonte lëndimet e saj.¹⁶⁹

Mirëpo në raste të tjera ndërveprimet e “Diellës” me policinë ishin shumë të ndryshme. Në një rast ajo thirri policinë ndërsa ishte e mbyllur në banjën e saj për të shmangur dhunën e bashkëshortit. Ajo tregoi se si polici që mbërriti në banesë fillimisht dukej i painteresuar. “Diella” tregoi se si ai i kishte thënë: “Oj zojë, pse po na thirrni e po boni probleme kur duhet me i zgjidhë këto probleme vet? Nuk duhet për gjithçka me thirrë policinë.” Megjithatë, sipas “Diellës”, kur ai ia vërejti shenjat në fytyrë dhe ajo i tha se kishte mavijosje në të gjithë trupin, polici e çoi bashkëshortin e saj në stacion.¹⁷⁰

Fitim Gashi, avokat i cili përfaqëson të mbijetuarat në rastet e dhunës në familje që gati një dekadë, tha se shumë policë besojnë se vetëm dhuna fizike mund të klasifikohet si dhunë. “Shpesh pyetja e parë që ua bëjnë viktimave është ‘A të rrehë? A ki shenja të lëndimeve?’... Ka raste, kur viktimat nuk ka lëndime, që i thonë ‘Hajt se sen nuk t’paska ba. Pse p’e raporton? Burrë e kij!’”¹⁷¹

“Nita”, e cila gjithashtu kishte një përvojë shumë negative me policinë kur e denoncoi burrin e saj pa shfaqur lëndime fizike, tha: “Policët që janë për dhunë në familje [duhet] me kon taman e trajnum për krejt format e dhunës në familje, sidomos për dhunë psikologjike, [...] Mënyra e qasjes të policëve me kon ma e butë, jo në mënyrë kërcënuese, jo në mënyrë të vrazhdë. Ata nuk duhet me të bo ty mu ni të kërcënume ose me të bo ty mu ni e pavlerë; kur ti mundohesh me i kallxu diçka që të ka ndodhë e ajo ta jep mendimin e vet paragjykes, kjo s’duhet me ndodhë.”¹⁷²

Komentet nënçmuese dhe të pandjeshme së bashku me trysinë ndaj grave për të mos raportuar dhunësit e tyre minimizojnë rrëfimet e viktimave për dhunën, minojnë njohjen e seriozitetit dhe specifikës së dhunës dhe parandalojnë zbatimin e plotë të dispozitave dhe masave që synojnë të mbrojnë viktimat dhe t’u ofrojnë atyre veprime korigjuese. Roli i policisë është vendimtar sepse mënyra në të cilën zyrtarët policorë u përgjigjen viktimave shpesh përcakton nëse një viktimë vendos të raportojë dhunën në familje dhe a ndihet e sigurt për të ndjekur veprime të mëtejshme ligjore nëse dëshiron. Viktimat që trajtohen në mënyrë të pandjeshme në përgjithësi kanë më shumë gjasa të vendosin të mos vazhdojnë me procesin dhe të kthehen në situata abuzive.¹⁷³

Policia e Kosovës ka krijuar Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje të përbërë nga policë meshkuj dhe femra, të cilët janë të trajnuar për t’u marrë me rastet e dhunës në familje.¹⁷⁴ Megjithatë, në praktikë, mbeten shumë zbrazëti. Raporti i KE/GREVIO 2022 për Kosovën konfirmoi se shumë stacione policore ende nuk kanë hapësira miqësore ndaj viktimave për të siguruar privatësinë gjatë intervistave dhe se, në shumë raste, policia përpqet të minimizojë seriozitetin e dhunës së raportuar.¹⁷⁵

“Edona” nga Drenasi, e cila ka raportuar tek autoritetet incidente të shumta të dhunës në familje, tha se policia dhe prokuroria duhet të komunikojnë më mirë mes vete dhe se prokurorët duhet të flasin drejtpërdrejt me viktimat: “Prokurorët mos me u bazu veç në fjalët e policëve, se mun ndodhë që marrin

¹⁶⁷ Intervistë me “Majën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶⁸ Intervistë me “Dianën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁶⁹ Intervistë me “Diellën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁷⁰ Intervistë me “Diellën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

¹⁷¹ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, avokat që përfaqëson të mbijetuarat e dhunës në familje përmes bashkëpunimit të tij me Rrjetin e Grave të Kosovës, 28 shtator 2022.

¹⁷² Intervistë me “Nitën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

¹⁷³ GREVIO, *Raporti i Vlerësimit Bazë për Slloveni*, rm.coe.int/first-baseline-report-on-slovenia/1680a4208b (qasur më 25 gusht 2023), para. 309.

¹⁷⁴ Amnesty International, Intervistë me Kapitenin e Policisë Arsim Shala, qershor 2022.

¹⁷⁵ KE, *Vlerësimi i përafritit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), faqe 71.

ryshfet, ose kanë arsye tjera për me ja majt anën atij... Unë i thashë prokurores: Dheze kerrin hajde se nuk të kushton kurgja me ardhë me kqyrë e me m'vet mu, pse s'po m'thirrë mu në telefon me m'vet për rastin, por po i thirrë policit?"¹⁷⁶ Ombudspersoni i Kosovës gjithashtu theksoi se prokurorët duhet të luajnë rol më proaktiv në fazën hetimore të procesit dhe të mos mbështeten tërësisht te policia. "Ekziston një domosdoshmëri që prokuroria dhe policia të kenë komunikim më të mirë dhe prokurorët duhet të jenë të pranishëm më shpesh kur viktimat merren në pyetje".¹⁷⁷

Sebahate Morina denoncoi bashkëshortin e saj për dhunë të vazhdueshme fizike dhe psikologjike në nëntor të vitit 2019 në Gjilan.¹⁷⁸ Me kërkesë të saj, Gjykata Themelore e Gjilanit lëshoi urdhër mbrojtës për 12 muaj ndaj bashkëshortit të saj.¹⁷⁹ Në janar 2020, ai u deklarua fajtor për dhunë në familje dhe sulm dhe u gjobit me 1,300 euro.¹⁸⁰ Katër muaj pas skadimit të urdhrimit mbrojtës, vajza e Sebahate Morinës thirrë policinë për të raportuar se babai i saj e kishte sulmuar Sebahaten përpara saj.¹⁸¹ Të nesërmen, policia intervistoi dhe më pas liroi (tani ish) bashkëshortin e Sebahates, Lulzim Sopin, në koordinim me Prokurorin e Shtetit. Policia kontaktoi edhe Sebahate Morinën dhe e ftoi të jepte një deklaratë tjetër; megjithatë, sipas policisë, ajo refuzoi dhe tha se nuk ishte e interesuar të ndiqte rastin.¹⁸² Dhjetë ditë më vonë, më 14 mars 2021, Sebahate Morina u qëllua dhe u vra nga ish-bashkëshorti i saj, Lulzim Sopi, i cili më pas u vetëvra.¹⁸³ Në mars të vitit 2023, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se prokuroria dhe policia kanë shkelur të drejtën për jetë të Sebahate Morinës për shkak se nuk kanë përmbushur obligimet e tyre pozitive të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe detyrimet që dalin nga Konventa e Stambollit.¹⁸⁴ Sipas Gjykatës Kushtetuese, Policia dhe Prokurori i Shtetit (i) nuk kanë reaguar menjëherë, (ii) nuk kanë bërë një vlerësim të mirëfilltë dhe të menjëhershëm të rrezikut, (iii) kanë qenë në dijeni ose duhet të kishin qenë në dijeni për rrezikun e menjëhershëm real ndaj jetës së Sebahates, duke qenë se ish-bashkëshorti i saj ishte dënua më parë për dhunë në familje dhe megjithatë (iv) nuk kishin marrë masa parandaluese për mbrojtjen dhe parandalimin e privimit nga jeta të Sebahates.¹⁸⁵ Organizatat për të drejtat e grave kërkuan dorëheqjen ose shkarkimin e prokurorit dhe zyrtarëve policorë përgjegjës për rastin.¹⁸⁶ Në një njoftim zyrtar për media, Prokuroria tha se është duke zhvilluar procedurë disiplinore ndaj prokurorit përgjegjës.¹⁸⁷

Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Kosova ka obligim të sigurojë një qasje konfidenciale dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në raste të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje për të shmangur stigmatizimin e viktimave dhe viktimizimin dytësor gjatë të gjitha procedurave ligjore, përfshirë gjatë marrjes në pyetje, mbledhjes së provave dhe procedurave të tjera që lidhen me hetimin.¹⁸⁸ Obligimet ndërkombëtare të Kosovës përfshijnë gjithashtu parandalimin e çdo diskriminimi nga aktorët shtetërorë, duke përfshirë zyrtarët policorë, dhe eliminimin e paragjyqimeve dhe diskriminimit gjinor bazuar në stereotipe të dëmshme gjinore.¹⁸⁹ Për më shumë, Konventa e Stambollit i detyron autoritetet, përfshirë policinë, të përmbahen nga justifikimi i çfarëdo akti të dhunës, përfshirë dhunën në familje, me kulturë, zakon, traditë fetare ose të ashtuquajturin "nder", me fokus të veçantë në pretendimet se "viktima ka shkelur normat apo zakonet kulturore, fetare, sociale apo tradicionale të sjelljes së duhur".¹⁹⁰

¹⁷⁶ Intervistë me "Edonën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

¹⁷⁷ Amnesty International, Intervistë me Avokatin e Popullit Naim Qelaj, qershor 2022.

¹⁷⁸ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21*, 22 mars 2023, gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/kl_129_21_agj_ang.pdf, (qasur më 25 gusht 2023), para. 18-19.

¹⁷⁹ *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 32.

¹⁸⁰ Gjykata Themelore e Gjilanit, *Aktgjykim P.nr.1042/19*, 27 janar 2021, https://gjilan.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJ_P_1042_2019_SQ.pdf, (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁸¹ *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 37-39.

¹⁸² *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 42.

¹⁸³ *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 43.

¹⁸⁴ *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 236-239.

¹⁸⁵ *Aktgjykim në rastin nr. Kl 129/21* (i cituar më parë), para. 237.

¹⁸⁶ OJQ QIKA, Rrjeti i Grave të Kosovës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Nisma për Drejtësi dhe Barazi, Instituti për Politikë Sociale 'Musine Kokalari', Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Truaktiv, Artpolis, Kërkesë për dorëheqje të menjëhershme të prokurorit përgjegjës, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prishtinës Kujtim Munishi dhe zyrtarët policorë përgjegjës për shkeljen e së drejtës së jetës së Sebahate Morinës, 5 prill 2023, <https://qika.org/activities/shteti-fajtor-per-vrasjen-e-sebahate-morines/> (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁸⁷ Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, Njoftim për media nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 5 prill 2023, <https://prokuroria-rks.org/al/psh/lajm/9693>, (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁸⁸ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.33 për Qasjen e Grave në Drejtësi, OKB Doc. CEDAW/C/GC/33, 2015, para. 51 (g).

¹⁸⁹ CEDAW, Neni 5; ICCPR, Nenet 3 dhe 26.

¹⁹⁰ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 46.

Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të siguruar përgjigje të duhur nga policia dhe prokuroria në lidhje me dhunën në familje. Kjo do të kërkonte një sërë masash, duke përfshirë trajnimin e shënjestruar të zyrtarëve policorë dhe promovimin e qasjeve të përqendruara të mbijetuarat dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për intervistimin e viktimave dhe mbledhjen e dëshmive. Të gjithë punonjësit e policisë që merren me rastet e dhunës nga partneri intim dhe të dhunës në familje, përveç trajnimit të detyrueshëm, duhet të marrin trajnime të rregullta për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve, të dizajnuara në bashkëpunim me organizatat që punojnë me të mbijetuarat. Ndër të tjera, trajnimi duhet të mbulojë dispozitat ligjore të vendit dhe rolin e institucioneve përkatëse në përgjigjen e shtetit ndaj dhunës në familje, si dhe adresimin e shkaqeve rrënjësore të dhunës, duke përfshirë zhvlerësimin e stereotipeve dhe paragjykimeve të dëmshme gjinore që çojnë në dhunë me bazë gjinore ndaj grave dhe të përgjigjeve joadekuate, duke përfshirë ato të identifikuar në këtë raport. Trajnimi duhet gjithashtu të fokusohet në efektet e traumës, të kuptuarit e dinamikës së pushtetit brenda dhunës nga partneri intim dhe eliminimin e faktorëve që shkaktojnë riviktimizim.¹⁹¹ Efektiviteti i protokolleve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe programet e trajnimit për zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të monitorohen, rishikohen dhe ndryshohen në përputhje me rrethanat përmes bashkëpunimit efektiv midis të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse që punojnë me të mbijetuarat e dhunës në familje.¹⁹²

4.3 NEGLIZHIMI INSTITUCIONAL I TË MBIJETUARVE LGBTI

Sipas organizatave LGBTI, shumë persona LGBTI në Kosovë janë të ekspozuar ndaj dhunës në familje nga familjet e tyre të lindjes për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit dhe shprehjes gjinore, dhe kjo çështje është veçanërisht e përhapur në zonat rurale. Dhuna në familje e ushtruar ndaj personave LGBTI shpesh fillon në moshë të re, zakonisht pas daljes haptas ose kur orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor bëhet më i dukshëm.¹⁹³ Përveç përjetimit të dhunës psikologjike dhe fizike nga anëtarët e familjes, organizatat raportuan se individët e rritur LGBTI në Kosovë u nënshtrohen edhe martesave të detyruara.¹⁹⁴

Disa aktivistë dhe ekspertë të tjerë i thanë Amnesty International se gjatë pandemisë Covid-19 u rritën rastet e dhunës në familje kundër personave LGBTI, duke përfshirë martesat e detyruara, veçanërisht në zonat rurale dhe qytetet më të vogla në Kosovë.¹⁹⁵ Shumë persona LGBTI që kishin jetuar të pavarur, por kishin humbur punën gjatë pandemisë, u detyruan t'u drejtoheshin familjeve të tyre për mbështetje financiare ose të ktheheshin përsëri me ta. "Prej pandemisë personat LGBTI jon bo ma të varun ekonomikisht prej familjeve të tyre, dhe në njëfarë mënyre fillun me u ndi në borxh ndaj familjes, gjë që u hapi rrugë familjeve të tyre për me i ba presion me u martu me dikon që ata nuk dojnë", tha Lendi Mustafa, aktivist i shquar LGBTI nga Kosova.¹⁹⁶

"Kur dëgjon historitë e personave LGBTI nga Kosova, është e vështirë t'i besosh sepse tingëllojnë si histori nga shekuj më parë. Kemi dëgjuar për raste të jashtëzakonshme torturash, për shembull, varja e një personi dhe rrahja me kamxhik në një kasolle. Kur dëgjon për një rast si ky në vitin 2021, është tronditëse", tha Esmeralda Kumaniku nga strehimorja LGBTI Streha në Tiranë, Shqipëri, e cila ofron shërbime për të mbijetuarit LGBTI shqiptarë nga Kosova që nga viti 2016.¹⁹⁷

¹⁹¹ Komiteti CEDAW Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35, (i cituar më parë), para. (ii).

¹⁹² GREVIO, Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2021, rm.coe.int/ic-and-explanatory-report/16808d24c6, para. 99 (qasur më 25 gusht 2023); Konventa e Stambollit, Neni 7. Shih gjithashtu: Instituti Evropian për Barazi Gjinore, Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rrezikut nga Policia, Parimi 1: Adoptimi i një qasjeje specifike për gjininë, eige.europa.eu/gender-based-violence/risk-assessment-risk-management/principle-1-adopting-gender-specific-approach, (qasur më 25 gusht 2023).

¹⁹³ Amnesty International, Intervistë me të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje "Adi", "Learta" dhe "Pati" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022; Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, strehimorja Streha në Shqipëri dhe aktivisti LGBTI Lendi Mustafën, shtator-dhjetor 2022.

¹⁹⁴ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, Streha dhe Lendi Mustafën, shtator-dhjetor 2022.

¹⁹⁵ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, Streha dhe Lendi Mustafën, shtator-dhjetor 2022.

¹⁹⁶ Amnesty International, Intervistë me Lendi Mustafën, dhjetor 2022.

¹⁹⁷ Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Esmeralda Kumanikun, tetor 2022. Që nga viti 2016, Streha ka ofruar shërbime rezidenciale për 11 të mbijetuar LGBTI të dhunës në familje nga Kosova. Çdo vit, ata ofrojnë shërbime mbështetëse në distancë për 30 persona LGBTI nga Kosova që jetojnë në Shqipëri. Shërbimet përfshijnë

Megjithatë, personat LGBTI rrallë raportojnë raste të dhunës për shkak të mosbesimit në institucione, frikës nga diskriminimi dhe frikës se do të zbulohen pa dëshirën e tyre.¹⁹⁸ Sipas të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës, në vitin 2020 nuk është raportuar asnjë rast i dhunës në familje ndaj personave LGBTI,¹⁹⁹ përkundër rritjes së rasteve të regjistruara nga OJQ-të lokale që punojnë me personat LGBTI.²⁰⁰ Policia e Kosovës ka regjistruar vetëm tri raste të dhunës në familje ndaj personave LGBTI në vitin 2021 dhe dy raste në vitin 2022.²⁰¹

Masat kushtetuese dhe ligjore në Kosovë ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi për personat LGBTI në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor në të gjitha fushat e jetës.²⁰² Për më shumë, krimet e kryera mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor të një personi parashohin dënime më të rënda.²⁰³

Progres i rëndësishëm është bërë edhe nga Policia e Kosovës në themelimin e njësisë për krimet kundër personave LGBTI në Prishtinë. Organizatat që punojnë për të drejtat e personave LGBTI raportojnë zhvillime pozitive në nivelin e bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, veçanërisht në sigurimin e mbrojtjes gjatë Javës së Krenarisë së Prishtinës,²⁰⁴ e cila mbahet çdo vit që nga viti 2017.²⁰⁵ Megjithatë, hulumtimi i Amnesty International gjeti dështime të vazhdueshme të policisë për të mbrojtur personat LGBTI nga dhuna në familje, duke përfshirë dështimin për t'i trajtuar seriozisht raportet e tyre, herë pas here duke u përpjekur të justifikojnë dhunën e përjetuar nga ta dhe duke treguar mungesë të të kuptuarit themelor të të drejtave LGBTI.²⁰⁶

Lendi Mustafa i tha Amnesty International: “Personat LGBTI kanë shumë mosbesim ndaj policisë dhe prokurorisë. Ata që dojnë me i raportu rastet kërkojnë me pasë asistencë prej neve ose me pasë një avokat prezent për shkak që nuk njihen të sigurt me i raportu rastet vet. Personat LGBTI e mbajnë hala në mend video-inçizimin që është publiku e është shpërnda ku zyrtarët policorë e keqtrajtojnë një person LGBTI në stacion”.²⁰⁷ Lendi Mustafa po i referohej një videoje të publikuar në media në vitin 2018, ku shiheshin policët duke tallur dy burra brenda një stacioni policor, duke i pyetur vazhdimisht nëse kishin marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin dhe duke pyetur njërin prej tyre nëse ishte gej. Pesë policë u pezulluan për sjellje të pahijshme policore për shkak të incidentit, por pamjet minuan më tej besimin tashmë të ulët të personave LGBTI në institucionet e zbatimit të ligjit.²⁰⁸

Për më shumë, ky nuk dukej të ishte incident i izoluar. Amnesty International foli me një të mbijetuar të dhunës në familje që kishte një përvojë të ngjashme. “Pati”, një grua trans shqiptare nga një qytet më i vogël në Kosovë, u soll në një stacion policor në vitin 2021 pasi babai i saj e sulmoi fizikisht dhe e thirri vetë policinë duke u thënë se kishte në plan të “qitë djalin prej shpije se është gej”. Sipas “Patit”, policia e mori në pyetje për katër orë për orientimin e saj seksual dhe i thanë se nëse nuk pranonte se ishte gej, do të sillnin mjekë ligjorë për të “verifikuar orientimin e saj seksual”. Edhe pse ishte sulmuar, ajo raportoi se ishte marrë në pyetje si e dyshuar. “Pati” ishte aq e traumatizuar nga përvoja sa e ndjeu si të rrezikshme dhe të kotë ta raportonte incidentin tek i njëjti autoritet që e kishte marrë në pyetje në mënyrë të paligjshme për katër orë me urdhër të babait të saj dhunues. Ajo gjithashtu dyshonte se policët e njihnin babanë e saj.²⁰⁹

këshillim psikologjik, ndihmë juridike, pako ushqimore, subvencionim për pagesën e qirasë, ndërmjetësim me punëdhënësit, ndër të tjera.

¹⁹⁸ Amnesty International, Intervista me përfaqësuesit e organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, Streha dhe Lendi Mustafa, shtator-dhjetor 2022; Intervistë me “Andin” (emri është ndryshuar për anonimitet), burrë gej dhe i mbijetuar i dhunës në familje, tetor 2022.

¹⁹⁹ Amnesty International, Përgjigje e Policisë së Kosovës ndaj një kërkesë zyrtare për informata, 21 mars 2023.

²⁰⁰ Amnesty International, Intervistë me Blert Morinën, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Barazi dhe Liri, dhjetor 2022. Amnesty International, Intervistë me Lendi Mustafën, dhjetor 2022.

²⁰¹ Amnesty International, Përgjigje e Policisë së Kosovës ndaj një kërkesë zyrtare për informata, 21 mars 2023.

²⁰² Kushtetuta e Kosovës, Neni 24; Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Nenet 1-3.

²⁰³ Kodi Penal Nr.06/L-074, neni 70(2.12).

²⁰⁴ Shih Prishtina Pride, në dispozicion në: prishtinapride.org/en/about-us, (qasur më 25 gusht 2023).

²⁰⁵ Amnesty International, Intervistë me Blert Morinën, dhjetor 2022; Intervistë me Lendi Mustafën, dhjetor 2022; Intervistë me Arbër Nuhiun dhe Rajmonda Sylbijen, dhjetor 2022; Prishtina Insight, “Kosova bën histori me paradën e parë të krenarisë”, tetor 2017, prishtinainsight.com/first-pride-parade-mag/ (qasur më 25 gusht 2023).

²⁰⁶ Amnesty International, Intervistë me “Patin” (emri është ndryshuar për anonimitet), grua trans e mbijetuar e dhunës në familje, tetor 2022; Intervistë me “Leartën” (emri është ndryshuar për anonimitet), grua trans e mbijetuar e dhunës në familje, nëntor 2022; Intervistë me Lendi Mustafën, nëntor 2022; Intervistë përmes një video-telefonate me Gresa Rrahmanin, Konsulente Ligjore në CEL, maj 2022.

²⁰⁷ Amnesty International, Intervistë me Lendi Mustafën, nëntor 2022.

²⁰⁸ Prishtina Insight, “Policët e Kosovës të suspenduar pas keqtrajtimit homofobik”, 19 nëntor 2018, prishtinainsight.com/kosovo-police-offices-suspended-after-homophobic-mistreatment/ (qasur më 25 gusht 2023).

²⁰⁹ Intervistë me “Patin” (emri është ndryshuar për anonimitet), tetor 2022.

Krahas rrezikut të diskriminimit dhe riviktimizimit, personat LGBTI kanë frikë se kur raportojnë dhunën në familje mund të zbulohen pa dëshirën e tyre ose të trajtohen anshëm. Në qytetet e vogla dhe zonat rurale në veçanti është e zakonshme që njerëzit të njohin familjet e njëri-tjetrit. Shumë persona LGBTI kanë frikë se policia nuk do t'i mbajë konfidenciale informatat për orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor.²¹⁰ Një aktivist i shquar LGBTI i tha Amnesty International se disa madje kanë frikë se policia mund të ndajë raportin e tyre të dhunës në familje dhe informatat personal me media tabloide.²¹¹

Ligji obligon viktimat e veprave penale të raportojnë rastet në stacionin policor më të afërt me vendin ku ka ndodhur dhuna ose ku jetojnë,²¹² duke dekurajuar më tej personat LGBTI nga raportimi i rasteve të tyre nga frika se mos njihen.²¹³

Sipas Arbër Nuhiut, drejtor i Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Sociale, një organizatë udhëheqëse LGBTI në Kosovë: "Njerëzit LGBTI preferojnë të durojnë dhunën sesa të raportojnë abuzimin. Ata shpesh thonë: 'Askush nuk mund të më garantojë se askush nuk do të më zbulojë'".²¹⁴

"Andi", një person gej i intervistuar nga Amnesty International, tha se ai kurrë nuk e kishte raportuar dhunën e përsëritur fizike dhe psikologjike që kishte përjetuar nga babai i tij, sepse kishte frikë se policia do të ishte e njëanshme kundër tij pasi babai i tij njihnte shumë zyrtarë policie në qytet: "Ndihesha shumë i pafuqishëm për ta raportuar atë, jo vetëm sepse isha i ri, por edhe sepse të gjithë e njihnin njëri-tjetrin, dhe e dija se të gjithë e respektonin babanë tim, kështu që mendova me vete, sa do të vlente raportimi im?... Shkova në stacionin e policisë, [dhe ndërsa prisja të bëja raportin] pashë tre ose katër nga miqtë më të ngushtë të babait tim [në mesin e zyrtarëve], kështu që thjesht u largova".²¹⁵

Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Kosova ka obligim të sigurojë që të gjithë, pavarësisht nga orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja gjinore apo karakteristikat gjinore, mund të ushtrorin të drejtën e tyre për mbrojtje shtetërore nga dhuna, diskriminimi dhe dëme të tjera, pavarësisht nëse dëmi bëhet nga zyrtarë shtetërorë ose nga ndonjë individ apo grup.²¹⁶ Neni 4.3 i Konventës së Stambollit përfshin një dispozitë të qartë të mosdiskriminimit për këtë qëllim. Autoritetet e Kosovës duhet të përfshijnë një perspektivë të mosdiskriminimit dhe informata për të drejtat e personave LGBTI në trajnimin fillestar dhe ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të policisë, për të siguruar që rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të trajtohen me ndjeshmëri. Policia duhet të sigurojë që dispozitat kundër diskriminimit të bëhen pjesë integrale e procedurave standarde të veprimit dhe të vihen në dispozicion mekanizma të përshtatshëm dhe të qasshëm për të raportuar trajtimin e gabuar të rasteve nga policia.

"Learta", një grua trans nga pakica etnike ashkali, i tha Amnesty International se nëna e saj filloi ta abuzonte psikologjikisht dhe fizikisht kur "Learta" ishte 14 vjeçe dhe filloi ta pranonte veten si transgjinore. Ajo denoncoi nënën e saj për herë të parë kur ishte 17 vjeçe, pas tri vitesh abuzim. "Policia më tha: 'Shko në shtëpi, nuk mund të bëjmë asgjë për ty! Nuk duhet të vish për gjëra kaq të vogla në polici. Çështje të tilla duhet të zgjidhen në shtëpi'... Nuk më morën seriozisht dhe kisha frikë për jetën time. Më thoshin të shkoja në shtëpi, por nëna ime nuk donte që të isha në shtëpi. Nuk kisha zgjidhje tjetër. Nuk kisha ku të shkoja, kështu që u ktheva në shtëpi".²¹⁷

Sipas njoftimit të policisë, "Learta" i tha policisë se nëna e saj ishte e dhunshme fizikisht dhe e kishte nxjerrë nga shtëpia pasi "sillej në mënyrë femërore". Amnesty International kishte qasje në deklaratën e policisë dhe gjeti zbrazëti të shumta në mënyrën se si policia e trajtoi rastin.²¹⁸ Deklaratat e marra nga "Learta" dhe nëna e saj tregojnë se policia është fokusuar në sjelljen e "Leartës" dhe jo në dhunën që ajo ka përjetuar nga e ëma. Nëna e "Leartës" nuk është marrë në pyetje si e dyshuar por si dëshmitare.

Ndonëse "Learta" në atë kohë ishte 17 vjeçe dhe ligjërisht e mitur, Qendra për Punë Sociale nuk ishte e pranishme kur ajo e denoncoi rastin në polici. Mbrojtësi i viktimave ishte i pranishëm, por sipas "Leartës"

²¹⁰ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale dhe Lendi Mustafën, shtator-dhjetor 2022; Intervistë me "Andin" (emri është ndryshuar për anonimitet), tetor 2022.

²¹¹ Intervistë me Lendi Mustafën, dhjetor 2022.

²¹² Ligji Nr.04/L-076 për Policinë, gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?A, Neni 32(2), (qasur më 25 gusht 2023). Sipas këtij neni, juridiksioni territorial i çdo stacioni policor kufizohet brenda kufijve të komunës ku ndodhet, (qasur më 25 gusht 2023).

²¹³ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale dhe Lendi Mustafën, shtator-dhjetor 2022.

²¹⁴ Amnesty International, Intervistë me Arbër Nuhiun, dhjetor 2022.

²¹⁵ Intervistë me "Andin" (emri është ndryshuar për anonimitet), tetor 2022.

²¹⁶ Shih Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (ICJ), The Yogyakarta Principles Plus 10, 10 nëntor 2017, parimi 30, yogyakartaprinciples.org/wp-content/uploads/2017/11/A5_yogyakartaWEB-2.pdf (qasur më 23 gusht), faqe 8.

²¹⁷ Intervistë me "Leartën" (emri është ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022.

²¹⁸ Policia e Kosovës, Drejtoria Rajonale e Policisë, Raporti i Policisë 2018-OP-0124, 5 shkurt 2018.

ai nuk e informoi për mundësinë e marrjes së një urdhri mbrojtës, shkuarjes në strehimore apo ndonjë shërbimi tjetër në dispozicion të të mbijetuarve të abuzimit në familje.

“Learta” denoncoi nënën e saj për herë të dytë në polici disa muaj më vonë pasi ajo e gjuajti me sëpatë dhe nuk e rroku dy herë.²¹⁹ Në atë kohë, “Learta” përfaqësohej dhe shoqërohej nga një avokate e punësuar nga Qendra për Barazi dhe Liri (CEL). Ajo beson se policia dhe institucionet e tjera e kanë trajtuar seriozisht rastin e saj në atë fazë sepse kishte përfaqësim ligjor. Në fund, gjykata e shpalli fajtorë nënën e saj për sulm dhe i dha një dënim me kusht me një vit burgim.²²⁰

Siç ilustron rasti i “Leartës”, dështimi i zyrtarëve policorë për ta marrë seriozisht dhunën në familje kundër personave trans mund t’i vendosë të mbijetuarit në rrezik të shtuar të abuzimit të mëtejshëm.

²¹⁹ Gjykata Themelore, *Aktgjykim P.nr.504/19*, 10 tetor 2019, i vënë në dispozicion të Amnesty International.

²²⁰ Gjykata Themelore, *Aktgjykim P.nr.504/19* (i cituar më parë).

MUNGESA E MONITORIMIT DHE ZBATIMIT TË URDRHAVE MBROJTËS

Të tetë gratë e intervistuar që kishin kërkuar urdhra mbrojtës i morën ata brenda kornizës kohore të mandatuar ligjërisht dhe iu dukën të dobishëm në përgjithësi si dhe raportuan se ndiheshin të befasuara pozitivisht për shpejtësinë e lëshimit të tyre.²²¹ Kjo ishte edhe përvoja e të intervistuarave, të cilat thuajse të gjitha komentuan se aspekti fillestar i lëshimit të urdhrit në përgjithësi funksionon në mënyrë efektive dhe sipas ligjit. Megjithatë, problemet mbeten sa u përket llojeve të masave të vendosura dhe zbatimit, monitorimit dhe shtrirjes së tyre, duke i lënë të mbijetuarat në rrezik.²²²

OJQ-të që punojnë me të mbijetuarat pretenduan se lëshimi i urdhrave mbrojtës brenda kornizës kohore ligjore, një zhvillim pozitiv, ishte rezultat i fushatës së pandërprerë nga organizatat për të drejtat e grave dhe i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2013 pas vrasjes së Diana Kastratit nga partneri i saj abuziv në Prishtinë në vitin 2010. Kastrati kishte kërkuar urdhër mbrojtës ndaj partnerit të saj dhunues por nuk e kishte marrë në kohë dhe u vra prej tij pak kohë më pas.²²³

Pavarësisht progresit të kufizuar, praktikuesit e intervistuar për këtë raport theksuan disa probleme me llojet e urdhrave mbrojtës të lëshuara dhe zbatimin e tyre. Konkretisht, ata vunë në dukje se gjykatat rrallëherë urdhërojnë kryesin të largohet nga banesa e përbashkët, duke e detyruar të mbijetuarën të largohet nga shtëpia, shpeshherë e shoqëruar nga fëmijët e saj.²²⁴ Në disa raste, gjykatat urdhërojnë kryesin dhe viktimën të ndajnë të njëjtën vendbanim, duke caktuar një distancë prej 5 metrash ndërmjet tyre, e cila është shumë e vështirë për t'u zbatuar dhe mund të çojë në dhunë të mëtejshme.²²⁵ Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës, e cili monitoron rastet gjyqësore të urdhrave mbrojtës, vuri në dukje se gjykatat zakonisht lëshojnë një urdhër mbrojtës që ndalon kryesin t'i afrohet viktimës, por rrallëherë nxjerrin masa të tjera, duke përfshirë urdhërimin e kryesit që të paguajë qiranë për të mbijetuarën, të paguajë alimentacion ose masa të

²²¹ Intervista me “Edonën”, “Gresën A”, “Mimozën”, “Kaltrinën”, “Anën”, “Dianën”, “Diellën”, “Nitën” (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-tetor 2022.

²²² Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022; Intervistë me Adelina Berishën, menaxhere e programit në Rrjetin e Grave të Kosovës, 1 qershor 2022; Intervistë me Burhan Maxhunin, mbrojtës i viktimave në Mitrovicë, shtator 2022; Intervista me të mbijetuarat, qershor-dhjetor 2022.

²²³ Amnesty International, Intervistë me Adelina Berishën, 1 qershor 2022; Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Aktgjykimi K141/12*. Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 26 shkurt 2013, gjk-ks.org/en/decision/gzim-dhe-makfire-kastrati-kundër-gjykatës-komunale-n-prishtinë-dhe-këshillit-gjyqësor-t-kosovës/ (qasur më 25 gusht 2023).

²²⁴ Amnesty International, Intervistë me Adelina Berishën, qershor 2022; Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022.

²²⁵ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022. Shih gjithashtu: KE, *Vlerësimi i përafritimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 275.

tjera të mundshme mbrojtëse.²²⁶ Për më shumë, rastet e rralla të urdhrave mbrojtës që kërkojnë kryesit të largohen nga vendbanimi janë të vështira për t'u zbatuar në kontekstin e Kosovës ku struktura familjare shpesh përbëhet nga disa gjenerata dhe nuk zbatohen në mënyrë aktive nga autoritetet.²²⁷ Shumë gra në Kosovë jetojnë me familjen e gjerë të burrit të tyre dhe vendbanimi i përbashkët zakonisht regjistrohet në emrin e burrit ose të familjes së tij. Në situata të tilla, urdhrat mbrojtës ndalojnë kryesit nga pjesë të vendbanimit, në vend që t'i largojnë plotësisht nga aty.²²⁸ Në raportin e vet për Kosovën, KE/GREVIO ka shprehur shqetësim për këtë praktikë.²²⁹

Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në rastet e rrezikut të menjëhershëm, të drejtat pronësore ose të strehimit të partnerëve abuzues nuk duhet të merren parasysh gjatë hartimit të urdhrave mbrojtës emergjent dhe nuk mund të mbizotërojnë mbi të drejtat e viktimës për jetën dhe për integritetin fizik dhe mendor.²³⁰

Të intervistuarat raportuan gjithashtu probleme me zgjatjen e urdhrave të mbrojtjes, duke vënë në dukje se gjyqtarët zakonisht kërkojnë dëshmi të reja të dhunës për të vazhduar urdhrat mbrojtës.²³¹

Gjykatat mund të lëshojnë urdhra mbrojtës dhe urdhra mbrojtëse emergjente për një periudhë deri në 12 muaj dhe t'i zgjasin ata deri në maksimum 24 muaj.²³² “Kaltrina” denoncoi bashkëshortin e saj në polici në vitin 2019 pas vuajtjes së dhunës psikologjike, fizike dhe ekonomike prej vitesh. Mbrojtësi i viktimave paraqiti kërkesë në emër të saj për urdhër mbrojtës, të cilën gjykata e miratoi për një periudhë gjashtëmuajore. Ajo shkoi në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe u kërkoi atyre që të bënin kërkesë për vazhdim pas skadimit të urdhrit mbrojtës fillestar prej gjashtë muajsh. “Mbrojtësi i viktimave më pyeti, “A ke marrë ndonjë kërcënim gjatë kësaj kohe, duhet ta kesh një kërcënim apo diçka tjetër që të kesh bazë ligjore për zgjatje”... Unë isha në një situatë aq të tmerrshme, nuk kisha nevojë të flisja, ata thjesht mund ta kishin parë deklaratën që kisha dhënë dhe do të duhej t'u mjaftonte që të tmerroheshin nga ajo që kisha përjetuar”.²³³ Mbrojtësi i viktimave nuk e kërkoi vazhdimin e urdhrit mbrojtës, duke e vënë “Kaltrinën” në rrezik dhe duke ia shtuar ndjesinë e frikës dhe pasigurisë.

Një çështje e kahershme në lidhje me monitorimin e urdhrave mbrojtës është moszbatimi i Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, i miratuar në vitin 2015, i cili vendos bazën ligjore që gjykatat të monitorojnë urdhrat mbrojtës përmes monitorimit me GPS dhe byzylykët elektronikë.²³⁴ Ombudspersoni vlerësoi se moszbatimi i këtij ligji ishte i papajtuësëm me obligimet e shtetit për mbrojtjen e së drejtës për jetë të viktimave të dhunës në familje.²³⁵ Qeveria ndërmori veprime për të zbatuar ligjin e hyrë në fuqi prej kohësh pas vrasjes së Hamide Magashit dhe foshnjës së saj të palindur në nëntor 2022.²³⁶ Një urdhër mbrojtës ishte në fuqi kur ajo u qëllua për vdekje nga ish-

²²⁶ Amnesty International, Intervistë me Adelina Berishën, 1 qershor 2022. Shih gjithashtu: KE, *Vlerësimi i përafritimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 275.

²²⁷ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022; Intervistë me Adelina Berishën, qershor 2022. Intervistë me Arrita Rezniqin dhe Ehat Miftarajn, qershor 2022.

²²⁸ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022; Intervistë me Burhan Maxhunin, mbrojtës i viktimave nga Mitrovica, shtator 2022.

²²⁹ KE, *Vlerësimi i përafritimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 267.

²³⁰ CEDAW, *Gökce dhe Yildirim kundër Austrisë*, 2005, OKB Doc. CEDAW/C/39/D/6/2005, tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2F39%2FD%2F6%2F2005&Lang=en, (qasur më 25 gusht 2023). Shih gjithashtu: KE, Një përmbledhje dokumentesh mbi Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, rm.coe.int/article-52-convention-istanbul-english-version/168073cae6, faqe 20, (qasur më 24 korrik 2023).

²³¹ Amnesty International, Intervistë me Burhan Maxhunin, shtator 2023; Intervistë me “Kaltrinën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²³² Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje, Neni 18(2).

²³³ Intervistë me “Kaltrinën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²³⁴ Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, 2015, gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10877 (qasur më 25 gusht 2023); Lëvizja FOL, “Etiketat elektronike: fokusi në parandalimin e rasteve të dhunës në familje”, dhjetor 2021; IKD, “Nuk gjen rregullat e ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të çështjeve, të gjithë ata që kufizohen me vendim të gjykatës”, 14 shtator 2022, betimiperdrejtesi.com/nuk-gjen-zbatim-ligji-per-mbikëqyrjen-elektronike-te-personave-te-cileve-u-kufizohet-levizja-me-vendim-te-gjykatës/ (e fundit akses më 24 korrik 2023); IKD, “Nuk gjen zbatim Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës”, 14 shtator 2022, betimiperdrejtesi.com/nuk-gjen-zbatim-ligji-per-mbikëqyrjen-elektronike-te-personave-te-cileve-u-kufizohet-levizja-me-vendim-te-gjykatës/ (qasur më 24 korrik 2023).

²³⁵ Institucioni i Ombudspersonit, *Raporti ex-officio i rastit nr. 621/2018*, 8 mars 2021, oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/03/Raport_-Ex-Officio_-621-2018.pdf, (qasur më 22 gusht 2023).

²³⁶ Kallxo, Vrasja e Hamide Magashit, kryeministri kërkon dorëheqjen e gjithë 'zinxhirit të papërgjegjës', 1 dhjetor 2022, kallxo.com/lajm/vrasja-e-hamide-magashit-kryeministri-kerkon-doreheqjen-e-gjithe-zinxhirit-te-papergjegjesisë/ (qasur më 30 korrik 2023); Koha, “Ligji përpër mbikëqyrje elektronike qe shtatë vjet s'gjeti zbatim, Policia

bashkëshorti i saj, Sokol Halili, në oborrin e Klinikës Gjinekologjike në Prishtinë ku ajo do të lindte të nesërmen.²³⁷ Vrasja e saj shkaktoi kritika ndaj qeverisë nga OJQ-të për moszbatimin e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave.²³⁸ OJQ-të vlerësuan se shuma e ndarë në prill të vitit 2023 për të financuar zbatimin e plotë dhe efektiv të ligjit – 600,000 euro – ishte e pamjaftueshme.²³⁹

Autoritetet në Kosovë, duke përfshirë policinë, prokurorinë, mbrojtësit e viktimave dhe gjykatat, duhet të sigurojnë që të mbijetuarit të jenë të informuara siç duhet për gamën e gjerë të masave në dispozicion të tyre përmes urdhrave mbrojtës, duke përfshirë masat e përkohshme të pagesës së qirasë dhe alimentacionit. Gjykatat duhet të marrin në konsideratë dhënien e masave më të llojllojshme mbrojtëse për të garantuar mbrojtje dhe siguri të menjëhershme, të tilla si urdhërimi i kryesit që të paguajë qiranë për të mbijetuarën, të paguajë alimentacion, të urdhërojë kryesin që ta lejojë të mbijetuarën të përdorë vendbanimin e përbashkët, ose masa të tjera të mundshme mbrojtëse, si dhe si marrjen e masave për të siguruar mirëqenien e të mbijetuarave të dhunës në familje.

Për më shumë, urdhrat mbrojtës nuk duhet të urdhërojnë kryesin të ndajë banesën me viktimën dhe në vend të kësaj duhet të sigurojnë që kryesit të mos qëndrojnë në afërsi të viktimës.

Autoritetet duhet të monitorojnë zellshëm urdhrat mbrojtës dhe të sigurojnë që ata të zbatohen, duke përfshirë zbatimin dhe financimin adekuat të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës.

hesht”, 1 dhjetor 2022, koha.net/arberi/355164/ligji-per-mbikëqyrje-elektronike-qe-shtate-vjet-sgjeti-zbatim-policia-hesht/ (qasur më 30 korrik 2023).

²³⁷ Balkan Insight, “Vrasësi i dyshuar i gruas shtatzënë në Kosovë bën vetëvrasje”, 2 dhjetor 2022, balkaninsight.com/2022/12/02/vrasësi-i-dyshuar-i-shtatzënë-në-kosovë-kryen-vetëvrasje/ (qasur në 24 korrik 2023); Gjykata Themelore e Ferizajt, Komunikatë për shtyp, 1 dhjetor 2022, ferizaj.gjyqesori-rks.org/2022/12/01/njoftim-per-media-2/ (qasur më 24 korrik 2023).

²³⁸ Koha, “Ligji përpër mbikëqyrje elektronike qe shtatë vjet s’gjeti zbatim, Policia hesht”, 1 dhjetor 2022, koha.net/arberi/355164/ligji-per-mbikëqyrje-elektronike-qe-shtate-vjet-sgjeti-zbatim-policia-hesht/ (qasur më 30 korrik 2023).

²³⁹ Koha, “Ligji përpër mbikëqyrje elektronike qe shtatë vjet s’gjeti zbatim, Policia hesht” (e cituar më parë).

STREHIMORET ME BURIME TË PAMJAFTUESHME TË PAAFTA PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT E TË MBIJETUARAVE

Strehimoret janë qenësore për të ndihmuar të mbijetuarat të largohen nga situatat abuzive. Strehimoret zakonisht u ofrojnë të mbijetuarave një vend të sigurt për të qëndruar, si dhe ushqim, veshmbathje, mbështetje psikosociale, duke përfshirë seanca të këshillimit individual, transport për në gjykatë dhe trajnim profesional në disa raste. Aktualisht ekzistojnë tetë strehimore të specializuara të drejtuara nga OJQ-të në Kosovë, secila me kapacitet mesatar për të ofruar strehim dhe mbështetje 24-orëshe për 15-20 gra të mbijetuara të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre; dhe dy strehimore për fëmijë, përfshirë për të mbijetuarit e dhunës në familje.²⁴⁰

Përveç strehimoreve të licencuara të përmendura më lart, ekziston një strehimore në Zubin Potok, në veri të Kosovës, e cila u shërben katër komunave me shumicë serbe: Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut dhe financohet nga buxheti komunal dhe donacionet e huaja.²⁴¹ Strehimorja nuk është e licencuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve pjesërisht për shkak të dështimit të autoriteteve të Kosovës për të njohur diplomat dhe kualifikimet e anëtarëve të stafit të marra në Serbi pas vitit 1999.²⁴² Një përfaqësues i strehimores në Novobërdë, komunë tjetër me shumicë serbe që operon një strehimore të licencuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, gjithashtu theksoi vështirësitë në punësimin dhe mbajtjen e stafit për shkak të mungesës së marrëveshjes për njohjen e diplomave të marra në Serbi.²⁴³

²⁴⁰ KE, Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit (cituar më parë), faqe 48. Intervista me Zana Hamitin, Erëblina Dinaramën, Ardita Balajn, Jubilea Kabashin, Fidane Hysenin, maj-tetor 2022.

²⁴¹ Amnesty International, Intervistë me Adriana Hodžić, shtator 2022. KE, Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit (cituar më parë), para. 141-142.

²⁴² Rrjeti i Grave të Kosovës, "Nga ligjet në veprim: monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë", 2021, womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ENG-Final-2.pdf (qasur më 25 gusht 2023).

²⁴³ Amnesty International, Intervistë me Vesna Stajić, shtator 2022.

Nga ana tjetër, nuk ka strehimore të specializuara për të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje. Strehimoret ekzistuese për gratë shpesh kanë mungesë kapacitetesh dhe ekspertize për të ofruar shërbime për gratë lezbike, biseksuale, transjinore dhe interseksdhe ato nuk pranojnë burra gej ose trans.

6.1 SFIDAT E QASJES NË STREHIMORE

Gratë e mbijetuara të dhunës në familje dhe dhunës seksuale zakonisht mund të qëndrojnë në një strehimore deri në gjashtë muaj. Në disa raste përjashtimisht mund t'u lejohet të qëndrojnë më gjatë. Përfaqësuesit e strehimores në Gjakovë shënuan disa raste ku të mbijetuarat qëndruan për dy vjet.²⁴⁴

Sidoqoftë, qasja në strehimore ka tendencë të jetë e disponueshme vetëm për të mbijetuarat e dhunës në familje që i raportojnë rastet në polici.²⁴⁵ Ky kusht paraqet një pengesë të madhe për të mbijetuarat të cilat mund të mos jenë të gatshme ose të mos dëshirojnë të raportojnë në polici për një sërë arsyesh dhe gjithashtu mund të shtojë një vonesë të rrezikshme për viktimat që kërkojnë siguri. Sipas drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunë të Prishtinës, zakonisht janë gratë e moshuara që kanë përjetuar dhunë për periudha të gjata kohore ato që hezitojnë të raportojnë në polici, kryesisht për shkak se ndihen të turpëruara që nuk e kanë raportuar abuzimin.²⁴⁶

Strehimorja në Novobërdë raportoi se i lejon të mbijetuarat të qëndrojnë në strehimore për një periudhë të shkurtër kohore nga 24-48 orë pa insistuar që ato t'i raportojnë rastet në polici. "Të mbijetuarat që vijnë direkt te ne mund të qëndrojnë në strehimore gjatë 'periudhës së përshtatjes' prej 24-48 orësh, edhe nëse për çfarëdo arsye hezitohen ta raportojnë rastin tek institucionet përgjegjëse", tha për Amnesty International drejtorja e strehimores në Novobërdë Vesna Stajić.²⁴⁷ Sipas përvojës së saj, gratë me nivel të arsimit më të lartë dhe gratë profesionale priren të jenë më ngurruese për t'i raportuar rastet e tyre në polici, sepse ndihen të turpëruara që u gjetën në një situatë abuzive.

Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shtetet duhet të ofrojnë qasje në shërbime gjithëpërfshirëse dhe të integruara pa e vënë kusht që të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore të raportojnë rastin e tyre në polici.²⁴⁸ Shërbimet e specializuara duhet t'i ndihmojnë të mbijetuarat të marrin vendimin më të mirë për rrethanat e tyre.²⁴⁹ Vendosja e një kushti paraprak për raportimin e rastit në polici për të pasur qasje në këto shërbime ua heq agjencinë dhe fuqinë vendimmarrëse të mbijetuarave dhe mund të përjashtojë disa të mbijetuara nga qasja në strehimore. Është ndoshta veçanërisht shqetësuese në një kontekst ku, siç u vërtetua në seksionet e mëparshme të këtij raporti, raportohet se policia ngurron të pranojë ankesën, duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e ankesës së viktimës, duke nënvlerësuar abuzimin që ajo po përjeton ose duke dyshuar tek ajo për shkak të mungesës së dëmtimeve fizike të dukshme.

6.2 TË SHKËPUTURA NGA BOTA: RREGULLAT E STREHIMOREVE SHKAKTOJNË NDJESI TË FORTË IZOLIMI

Disa të mbijetuara të dhunës në familje që po qëndronin në strehimore i thanë Amnesty International se kishin një ndjesi të fortë izolimi për shkak të rregullave të strehimores. Një formë e dhunës në familje që mund ta kenë përjetuar të mbijetuarat para qëndrimit të tyre në strehimore është përdorimi i kontrollit shtrëngues, me anë të së cilit dhunuesi i izolon, duke ua kufizuar lirinë e lëvizjes dhe kontaktin me botën e jashtme. Kufizimet shtesë të vendosura ndaj të mbijetuarave nga strehimoret mund ta përkeqësojnë këtë ndjenjë izolimi.

²⁴⁴ Amnesty International, Intervistë me Erëblina Dinaramën, drejtore e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, qershor 2022.

²⁴⁵ Amnesty International, Intervista me Erëblina Dinaramën, drejtore e Shtëpisë së Sigurt në Gjakovë, Zana Hamitin, drejtore e strehës në Prishtinë, Fidane Hyseni, drejtore e strehimores në Mitrovicë (të jugut), Ardita Balaj, drejtore e strehimores në Pejë, dhe Jubilea Kabashi, drejtore e strehimores në Prizren, qershor-tetor 2022.

²⁴⁶ Amnesty International, Intervistë me Vehbi Mujkun, drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Prishtinës, gusht 2022.

²⁴⁷ Amnesty International, Intervistë me Vesna Stajić, shtator 2022.

²⁴⁸ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 18 (4). UN Women, Manual për legjislacionin mbi dhunën ndaj grave, 2012, faqe 30, unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2012/12/UNW_Legislation-Handbook%20pdf.pdf (qasur më 25 gusht 2023).

²⁴⁹ KE, "Lufta kundër dhunës ndaj grave: standardet minimale për shërbimet mbështetëse", 2008, [coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/EG-VAW-CONF\(2007\)Study%20rev.en.pdf](https://coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/EG-VAW-CONF(2007)Study%20rev.en.pdf), (qasur më 25 gusht 2023), faqe 10.

Në përgjithësi, strehimoret në Kosovë nuk i lejojnë të mbijetuarat të dalin nga strehimorja gjatë qëndrimit të tyre, duke përmendur çështjet e sigurisë.²⁵⁰ Të mbijetuarat mund të dalin të shoqëruara nga stafi i strehimores dhe policia për të ndjekur procedurat gjyqësore ose për të hyrë në objektet e kujdesit shëndetësor, dhe në disa strehimore, si në Gjakovë, Prizren, Pejë dhe Zubin Potok, ato mund të shkojnë në punë në raste me rrezik të ulët.²⁵¹ Megjithatë, edhe në këto strehimore, të mbijetuarat që nuk janë të punësuar nuk mund të largohen dhe praktikisht janë të mbyllura në strehimore. Në përgjithësi, të mbijetuarat në strehimoret në Prishtinë dhe Mitrovicë nuk lejohen të largohen për punë ose për ndonjë arsye tjetër, përveç nevojave mjekësore ose procedurave gjyqësore, në mënyrë që të mbrojnë vendndodhjen e fshehtë të strehimores dhe të të mbijetuarave që jetojnë aty.²⁵²

Të mbijetuarat janë përgjithësisht të obliguara t'i dorëzojnë telefonët e tyre celularë në fillim të qëndrimit. Në këto raste, ato zakonisht lejohen të flasin me familjet e tyre një ose dy herë në javë dhe vetëm në prani të një anëtareje të stafit.²⁵³

Zyrtarët e strehimores e justifikojnë këtë protokoll si masë sigurie për të ruajtur konfidencialitetin e vendndodhjes së strehës dhe për të mbrojtur sigurinë e të mbijetuarave që qëndrojnë aty.²⁵⁴ Ndërsa ky mund të jetë shqetësim legjitim, pamundësia për të komunikuar shpesh me familjen dhe shoqërinë gjatë një periudhe të vështirë dhe ndjenja e fortë e izolimit detyron disa të mbijetuarat të largohen nga strehimoret para se të jenë gati dhe shpeshherë të kthehen në situata abuzive.²⁵⁵

“Edona” nga Drenasi qëndroi në strehimoren në Prishtinë me tre fëmijët e saj, por vendosi të largohet pas vetëm 10 ditësh sepse për të dhe për fëmijët izolimi ishte i padurueshëm. “Nuk e di pse strehimorja është mbyll si në burg. Unë i thojsha njerzve në strehimore ma mirë të kisha mytë burrin tem se këtu koka si n'burg. As nuk isha e lirë me fol me prind, as me pasë privatësinë teme, edhe fëmija ishim shumë të shqetësuar”.²⁵⁶

“Syzana”, e cila po qëndronte në strehimoren në Prishtinë, gjithashtu e kishte të vështirë izolimin. “As gjatë ngujimit në pandemi nuk durojsha me nejt veç mrena dhe kaniher shkjsa e vizitojsa nanën”. “Syzana”, së bashku me gra të tjera, deklaroi se do të kishte dashur që herë pas here të dilte jashtë: “Bile një herë në javë ndoshta dikush me ardhë me na marrë me dalë me pi naj kafe jashtë”.²⁵⁷

Kjo praktikë mund të jetë në kundërshtim me procedurën standarde të operimit të Agjencisë për Barazi Gjinore, sipas së cilës viktimat që qëndrojnë në strehimore duhet të lejohen të komunikojnë me anëtarët e familjes dhe shoqërinë e tyre dhe se kontakti me anëtarët e familjes duhet të monitorohet nga stafi i strehimores vetëm në rastet me rrezikshmëri të lartë.²⁵⁸ Kjo do të thotë se strehimoret janë të detyruara të zbatojnë protokollin e sigurisë rast pas rasti në vend se të imponojnë një rregull të përgjithshëm për të monitoruar të gjitha thirrjet e të mbijetuarave me botën e jashtme. Për më shumë, procedurat standarde të veprimit nuk kufizojnë numrin e rasteve kur viktimave u lejohet të kontaktojnë familjet ose shoqërinë e tyre.

KE ka deklaruar se “duhet vlerësuar situata e sigurisë e secilës viktimë dhe duhet të hartohet një plan individual sigurie mbi bazën e këtij vlerësimi”.²⁵⁹ Amnesty International u bën thirrje strehimoreve të kryejnë vlerësime individuale të rrezikut, të cilat rezultojnë në plane sigurie të individualizuara që ua lejojnë atyre që nuk kanë raste me rrezikshmëri të lartë të kontaktojnë më shpesh familjet dhe shoqërinë e tyre dhe pa mbikëqyrje nga stafi i strehimores.

²⁵⁰ Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin, drejtore e strehimores në Prishtinë, Fidane Hyseni, drejtore e strehimores në Mitrovicë, Ardita Balaj, drejtore e strehimores në Pejë dhe Jubilea Kabashi, drejtore e strehimores në Prizren, qershor-tetor 2022.

²⁵¹ Amnesty International, Intervista me Erëblina Dinaramën, Ardita Balajn, Jubilea Kabashin, Fidane Hysenin, qershor-tetor 2022; Intervistë me Adriana Hodžić, (atëherë) Nënkrjetare e Komunës së Mitrovicës së Veriut, shtator 2022; Intervistë me “Majën” (emri është ndryshuar për anonimitet), e mbijetuar e dhunës në familje nga Mitrovica e Veriut, shtator 2022.

²⁵² Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin, maj 2022, dhe Fidane Hysenin, gusht 2022.

²⁵³ Strehimoret në Pejë dhe Zubin Potok i lejojnë të mbijetuarat të flasin me familjet e tyre sa herë të duan. Në strehimoret në Prishtinë, Gjakovë dhe Prizren, të gjitha thirrjet në botën e jashtme monitorohen nga stafi i strehimores.

²⁵⁴ Amnesty International, Intervistë me Zana Hamitin, maj 2022.

²⁵⁵ Amnesty International, Intervistë me “Edonën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022; Intervistë me Zana Hamitin, maj 2022.

²⁵⁶ Intervistë me “Edonën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²⁵⁷ Intervistë me “Syzanën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²⁵⁸ Agjencia për Barazi Gjinore, Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë (ecituar më parë), faqe 47.

²⁵⁹ Raport shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, para. 134.

6.3 ZBRAZËTI NGULMUESE NË FINANCIMIN E STREHIMOREVE

Strehimoret në Kosovë operohen pothuajse ekskluzivisht nga OJQ-të, duke i bërë të varura nga financimi shpesh i pasigurt nga autoritetet dhe donatorët e jashtëm. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve hap thirrje në baza vjetore për të gjitha organizatat për të aplikuar për financim. Fonde të kufizuara janë gjithashtu në dispozicion nga komunat.²⁶⁰

Strehimoret janë përballur me mungesë të vazhdueshme të financimit adekuat dhe vonesa sistematike në alokimin e fondeve, duke e bërë funksionimin e tyre jashtëzakonisht të pasigurt. Për më shumë, financimi i qeverisë priret të vonohet, zakonisht duke i lënë strehimoret pa burime thelbësore për tre muajt e parë të vitit dhe duke minuar aftësinë e tyre për të ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe të vazhdueshme për të mbijetuarat.

Në vitin 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit raportoi se strehimoret morën vetëm gjysmën e buxhetit të nevojshëm për të funksionuar.²⁶¹ Për shkak të financimit të pamjaftueshëm dhe vonesave në marrjen e fondeve nga qeveria gjatë viteve 2017 dhe 2018, strehimoret duhej të mbylleshin ose t'i kthenin mbrapsht përkohësisht personat që kishin nevojë për mbrojtje.²⁶² Kjo e shtyu qeverinë e atëhershme të ndajë fonde emergjente për strehimoret;²⁶³ megjithatë, ende nuk është gjetur një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme.

Në vitin 2022, strehimoret nuk morën financim deri në prill dhe, në të njëjtën kohë, qeveria uli buxhetin vjetor për strehimoret pa dhënë asnjë arsytim, megjithëse strehimoret në Gjakovë dhe Prishtinë pranuan një numër në rritje të të mbijetuarave që kërkonin ndihmë.²⁶⁴ Qeveria dha mbështetje financiare urgjente për janar dhe shkurt 2023.²⁶⁵ Megjithatë, stafi i strehës është i shqetësuar se kjo nuk është zgjidhje e qëndrueshme dhe problemet me financimin mund të përsëriten në të ardhmen.²⁶⁶ Ata raportojnë se qeveria kur përcakton buxhetin vjetor nuk duket se merr parasysh faktorë të tillë si numri i njerëzve që pranojnë shërbimet e tyre çdo vit dhe norma e inflacionit.²⁶⁷

Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve shpjegoi se për caktimin e buxhetit nevojitet miratim e kuvendit, proces i cili mund të jetë jashtëzakonisht i ngadalshëm.²⁶⁸ Në kohën e shkrimit, Departamenti ishte në proces të miratimit të një rregulloreje të re për shërbimet kontraktuese, e krijuar për të adresuar vonesat. Thuhet se donatorët ndërkombëtarë ofrojnë më pak fonde pasi presin që këto shërbime të mbulohen nga shteti; një qëndrim që nuk mbështetet nga qeveria.²⁶⁹

Për të adresuar sfidat, sipas projektligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën me bazë gjinore, i cili priret të miratohet nga kuvendi në vitin 2023, qeveria do të ndajë fonde të mjaftueshme për financimin e qëndrueshëm të strehimoreve të licencuara për një periudhë trivjeçare.²⁷⁰ Gjithashtu, projektligji parashikon që strehimoret të organizohen në përputhje me standardet e KE-së, duke kërkuar që të paktën një strehë të jetë në dispozicion për çdo 10,000 njerëz.²⁷¹

Në përgjigje ndaj kërkesës zyrtare të Amnesty International për informata, Ministria e Drejtësisë konfirmoi se mbështetja për strehimoret është dyfishuar në vitin 2023, nga 400,000 euro në 892,000 euro. Ministria vuri në dukje se një projektligj i ri për shërbimet sociale dhe familjare, i cili do të miratohet në vitin 2023, do të

²⁶⁰ Amnesty International, Intervista me Erëblina Dinaramën, Zana Hamitin, Fidane Hysenin, Ardita Balajn dhe Jubilea Kabashin, qershor-tetor 2022.

²⁶¹ Institucioni i Ombudspersonit, *Raporti Vjetor 2018, 2019*, oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/04/Raporti-Vjetor-i-IAP-s%C3%AB-2018-shqip.pdf, (qasur më 25 gusht 2023), faqe 113.

²⁶² Prishtina Insight, "Mbyllen strehimoret e Kosovës për viktimat e abuzimit në familje", 12 janar 2018, prishtinainsight.com/kosovo-shelters-domestic-abuse-victims-close/, (qasur më 25 gusht 2023).

²⁶³ Prishtina Insight, "Kosova alokon fonde emergjente për strehimoret e dhunës në familje", 13 janar 2018, //prishtinainsight.com/kosovo-allocates-emergency-funds-domestic-violence-shelters/ (qasur më 25 gusht 2023).

²⁶⁴ Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin, maj 2022 dhe Erëblina Dinaramën, qershor 2022.

²⁶⁵ Ministria e Drejtësisë, "Haxhiu: Si asnjëherë më parë strehimoret kanë vëmendjen e shtetit", 20 mars 2023, md.rks.gov.net/page.aspx?id=1,15,2964 (qasur më 25 gusht 2023).

²⁶⁶ Amnesty International, vazhdim i intervistës me Zana Hamitin, mars 2023.

²⁶⁷ Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin dhe Erëblina Dinaramën, maj-tetor 2022.

²⁶⁸ Amnesty International, Intervistë me Adile Shqirin, Ministria e Financave, Departamenti i Punës dhe Transfereve për Politikën Sociale dhe Familjare, shtator 2022.

²⁶⁹ Amnesty International, Interview with Adile Shqiri, September 2022.

²⁷⁰ Projektligj për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj gruas dhe dhuna me bazë gjinore, Neni 24 (7-8).

²⁷¹ Projektligj për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj gruas dhe dhuna me bazë gjinore, Neni 24 (9).

trajtore "çështjen e kontraktimit të shërbimeve për periudha më të gjata kohore, në mënyrë që të sigurojë financim të qëndrueshëm për strehimoret".²⁷² Megjithatë, drejtorja e strehimores në Prishtinë, me kërkesë të Amnesty International për ta komentuar këtë zhvillim të ri, theksoi se, megjithëse i mirëpritur, buxheti i premtuar është ende shumë i ulët duke marrë parasysh shkallën në rritje të inflacionit dhe rritjen e kërkesës për hapësira strehuese.²⁷³

Ligjet dhe standardet ndërkombëtare kërkojnë që shtetet të ofrojnë dhe financojnë në mënyrë adekuate shërbime të qasshme, të përbalueshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur gratë nga dhuna me bazë gjinore, për të parandaluar rishfaqjen e dhunës dhe për të ofruar apo siguruar fonde për dëmshpërblim të të gjitha viktimave/të mbijetuarave.²⁷⁴ Neni 8 i Konventës së Stambollit kërkon gjithashtu që shtetet të ndajnë burime të duhura financiare dhe njerëzore për zbatimin adekuat të të gjitha politikave, programeve dhe shërbimeve, duke përfshirë strehimoret, për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje.

Financimi për strehimoret duhet të sigurohet edhe për aktivitete joqenësore siç janë ndërgjegjësimi i publikut, avokimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit dhe ngritja e kapaciteteve të të mbijetuarave që qëndrojnë në strehimore. Për më shumë, autoritetet e Kosovës duhet të konsiderojnë krijimin dhe mbështetjen e një rrjeti kombëtar të strehimoreve dhe shërbimeve të tjera mbështetëse për të integruar dhe përmirësuar standardet e shërbimeve, duke funksionalizuar një sistem kombëtar të mbledhjes së të dhënave dhe krijimin e mundësive për ngritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira.

6.4 MUNGESA E STREHIMOREVE PËR PERSONAT LGBTI TË MBIJETUAR TË DHUNËS NË FAMILJE

Nuk ka strehimore të specializuar për të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje në Kosovë dhe strehimoret ekzistuese nuk u përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave specifike të të mbijetuarve LGBTI. Si rrjedhojë, njerëzit që përjetojnë dhunë në familje për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të qëndrojnë në mjedise abuzive.²⁷⁵ Mungesa e mbështetjes së strehimoreve, mosbesimi në institucione dhe varësia ekonomike e personave LGBTI nga familjet e tyre janë ndër arsyet kryesore të nënraportimit të rasteve të dhunës në familje nga personat LGBTI.²⁷⁶ "Kur e di se këtu nuk ka strehë për ty, nuk shkon për ta raportuar rastin", tha për Amnesty International Arbër Nuhiu, përfaqësues i një organizate LGBTI në Kosovë.²⁷⁷ Strehimoret ekzistuese për gra dhe fëmijë nuk i pranojnë të gjithë të mbijetuarit LGBTI dhe ata pak që i pranojnë nuk mund t'u përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të tyre.²⁷⁸

Burrat mbi 18 vjeç nuk kanë të drejtë të hyjnë në asnjë prej strehimoreve ekzistuese, duke i lënë burrat gej dhe trans pa mbrojtje nga dhuna në familje. Përfaqësuesit nga CEL i thanë Amnesty International se personat LGBTI që kanë qëndruar në strehimore në Kosovë kanë raportuar se janë ngacmuar nga stafi ose të mbijetuar të tjerë.²⁷⁹ Një vajzë trans, e cila ishte dërguar në strehën e fëmijëve nga policia, i tha organizatës LGBTI CEL se ajo u kthye në familjen e saj abuzive pasi u ngacmua nga stafi dhe fëmijët e tjerë të strehës.²⁸⁰ Në mënyrë të ngjashme, "Learta", një grua trans e mbijetuar e dhunës në familje, i tha Amnesty International se vendosi të largohej nga streha ku po qëndronte në vitin 2019 për shkak të ngacmimeve nga gratë e tjera banore.²⁸¹

²⁷² Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Përgjigje Zyrtare ndaj gjetjeve të hulumtimit të Amnesty International mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës në familje, 22 gusht 2023. Në dosje të Amnesty International.

²⁷³ Amnesty International, telefonatë me Zana Hamitin, gusht 2023.

²⁷⁴ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 26 (b).

²⁷⁵ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, Streha dhe Lendi Mustafa, Shtator-Dhjetor 2022; Intervistë me "Leartën" (emri është ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022.

²⁷⁶ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, Streha dhe Lendi Mustafa, Shtator-Dhjetor 2022; Intervistë me "Leartën" (emri është ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022.

²⁷⁷ Amnesty International, Intervistë me Arbër Nuhiun, drejtor ekzekutiv në OJQ Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale, dhjetor 2022.

²⁷⁸ Intervistë me Jubilea Kabashin, drejtore e strehës në Prizren, korrik 2022. Intervistë online me Gresa Rrahmanin, konsulente juridike në Qendrën për Barazi dhe Liri, maj 2022; Intervistë me Blert Morinën, dhjetor 2022.

²⁷⁹ Amnesty International, Intervistë online me Gresa Rrahmanin, maj 2022; Intervistë me Blert Morinën, dhjetor 2022.

²⁸⁰ Amnesty International, Intervistë me Blert Morinën, dhjetor 2022.

²⁸¹ Amnesty International, Intervistë me "Leartën" (emri është ndryshuar për anonimitet), nëntor 2022.

Për shkak të mungesës së strehimoreve të specializuara në Kosovë, disa të mbijetuar LGBTI të dhunës në familje drejtohen për të kërkuar ndihmë në strehimoren LGBTI Streha në Shqipërinë fqinje. Megjithatë, kjo do të thotë se ata duhet të largohen nga Kosova në një mjedis krejtësisht tjetër ku nuk kanë familje apo shoqëri; dhe ku mund t'u duket sfidues dialekti vendas i shqipes.²⁸² Sipas Esmeralda Kumanikut nga Streha, procesi i rehabilitimit dhe fuqizimit të të mbijetuarve LGBTI të dhunës në familje nga Kosova është shumë më i vështirë në krahasim me të mbijetuarit LGBTI nga Shqipëria. "Për ta, ardhja në strehimore është një pikë kthese dhe një hap shumë i madh që kërkon shumë përpjekje psikologjike, sepse marrin vendimin për të raportuar dhunën dhe për t'u larguar nga vendi".²⁸³

Për më shumë, jo të gjithë të mbijetuarit LGBTI nga Kosova mund të hyjnë te Streha. Strehimorja pranon vetëm persona të moshës 18-29 vjeç²⁸⁴ dhe procesi i pranimit është i gjatë dhe i vështirë. "Learta" i tha Amnesty International se kishte dy muaj që priste përgjigje nga strehimorja pasi kishte aplikuar.²⁸⁵

Në mungesë të një strehimoreje të specializuar në Kosovë, CEL ndërhyri për të paguar qiranë për një apartament në Prishtinë që strehonte deri në pesë persona. Megjithatë, financimi për apartamentin nuk ishte i qëndrueshëm dhe përfundoi në dhjetor 2022.²⁸⁶

Planet për të krijuar një strehimore për të personat LGBTI të mbijetuar të dhunës në Kosovë kanë filluar të paktën që nga tetori i vitit 2020, kur Komuna e Prishtinës njoftoi se kishte ndarë një pronë komunale për këtë qëllim.²⁸⁷ Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës u zotua të ofrojë shërbime mbështetëse, duke përfshirë qasjen në strehimore për grupe të veçanta, djem dhe burra që janë viktime të dhunës, si dhe persona LGBTI, duke dedikuar 120,000 euro në vit për vitet 2022, 2023 dhe 2024.²⁸⁸ Pavarësisht këtyre planeve, në kohën e këtij shkrimi nuk është bërë ndonjë progres konkret.²⁸⁹ Përveç kësaj, Komuna e Prishtinës raportohet se ka njoftuar CEL-in se prona e ndarë komunale nuk është e garantuar dhe me gjasë do të ndryshojë.²⁹⁰

Qeveria e Kosovës dhe komunat duhet të intensifikojnë përpjekjet për të krijuar një strehimore të re të specializuar për personat LGBTI. Ndërkohë duhet të sigurojnë që të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje të kenë qasje në forma tjera të sigurta të strehimit.

²⁸² Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Adela Alikajn dhe Esmeralda Kumanakun, tetor 2022.

²⁸³ Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Adela Alikajn dhe Esmeralda Kumanakun, tetor 2022.

²⁸⁴ Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Adela Alikajn dhe Esmeralda Kumanakun, tetor 2022.

²⁸⁵ Amnesty International, Intervistë me "Leartën" (emri është ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022.

²⁸⁶ Amnesty International, Intervistë me Blert Morinën, nëntor 2022.

²⁸⁷ Amnesty International, Intervistë me përfaqësues të Komunës së Prishtinës, qershor 2022.

²⁸⁸ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 116.

²⁸⁹ Amnesty International, Intervistë me Blert Morinën, maj 2023.

²⁹⁰ Amnesty International, Informata nga Blert Morina, qershor 2023.

MUNGESA E MBËSHTETJES NGA QENDRAT PËR PUNË SOCIALE

Dhjetë nga 13 të mbijetuarat e intervistuar nga Amnesty International që kishin ndërveprim me Qendrat për Punë Sociale (QPS) i përshkruan përvojat e tyre si negative.²⁹¹ Ato raportuan se punëtorët socialë nuk ishin empatikë apo ndihmues. Tri të mbijetuarat thanë se punëtorët socialë i vunë nën presion të drejtpërdrejtë për t'u kthyer te abuzuesit e tyre dhe madje përpiqeshin ta justifikonin abuzimin ose i fajësonin ato për dhunën që kishin përjetuar.²⁹²

Të mbijetuarat i përshkruan shërbimet e marra nga QPS-të si joprofesionale dhe sipërfaqësore. "Diella" përshkroi për Amnesty International se si një punëtor social i kishte thënë: "S'po muj me besu çka paska hekë burri yt me ty po m'dhimet qysh po të durojka edhe të paska duru."²⁹³ "Edona" tregoi se si i kishte telefonuar punëtorët socialë për ndihmë ndërsa i shoqi po e rrihte, e ata i thanë thjesht të përpiqej të dialogonte me të. Punëtorëve socialë iu deshën dy ditë që të shkonin në shtëpi për ta parë gjendjen e saj.²⁹⁴ "Ana", e cila shkoi në QPS me qepje në kokë nga lëndimet e shkaktuara nga i shoqi, raportoi se një punëtor social i tha se familja është "e shenjtë" dhe duhej të mbrohej dhe i bëri thirrje të pajtohej me burrin e saj.²⁹⁵ "Arjeta" i tha Amnesty International, "E thirra menaxheren e rastit tem e i thashë që kunatat po më rrehin prapë, ajo veç m'tha, 'ky është problemi yt' dhe e msheli telefonin".²⁹⁶

Probleme të ngjashme me QPS janë raportuar nga të mbijetuarat e etnisë serbe të intervistuarat. "Maja" nga Mitrovica e Veriut i tha Amnesty International se stafi i QPS-së me të cilët ishte takuar dukeshin të mbingarkuar dhe të paimterësuar për ta mbështetur atë; ata treguan pak ndjeshmëri apo mirëkuptim. Kur "Maja" iu qas QPS-së për herë të parë, punëtorët socialë e pyetën nëse donte të pajtohej me burrin e saj. Ata u përpoqën të ndërmjetësonin mes tyre, në vend që të përcaktonin se sa serioz ishte abuzimi, të kuptonin nevojat dhe prioritetet e saj dhe ta referonin "Majën" te shërbimet përkatëse mbështetëse.²⁹⁷

²⁹¹ Amnesty International, Intervista me "Anën", "Diellën", "Edonën", "Gresën A", "Kaltrinën", "Filloretën", "Arjetën", "Leartën", "Majën" dhe "Dianën" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-tetor 2022.

²⁹² Intervista me "Diellën", "Anën", "Edonën" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-shtator 2022.

²⁹³ Amnesty International, Intervistë me "Diellën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

²⁹⁴ Amnesty International, Intervistë me "Edonën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²⁹⁵ Amnesty International, Intervistë me "Anën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

²⁹⁶ Amnesty International, Intervistë me "Arjetën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

²⁹⁷ Amnesty International, Intervistë me "Majën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

Në përgjigje ndaj kërkesës zyrtare të Amnesty International për informata, Ministria e Drejtësisë konfirmoi se një projektligj i ri për shërbimet sociale dhe familjare, i cili pritet të miratohet në vitin 2023, parashikon rritje të buxhetit për QPS-të dhe më shumë staf.²⁹⁸

Autoritetet duhet t'u ofrojnë QPS-ve trajnime të detyrueshme për parandalimin dhe zbulimin e dhunës në familje, dhe aplikimin e një qasjeje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përqendruar te të mbijetuarat në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për të mbijetuarat, duke përfshirë edhe respektimin e të drejtave të viktimave; zhvlerësimin e stereotipeve të dëmshme gjinore; për natyrën gjinore të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe ndikimin e dëmshëm të fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës. Autoritetet duhet gjithashtu të shtojnë burimet për programet sociale të përcaktuara për rikuperimin e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe të ofrojnë burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur të mbijetuarat.

²⁹⁸ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Përgjigje Zyrtare ndaj gjetjeve të hulumtimit të Amnesty International mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës në familje, 22 gusht 2023. Në dosje të Amnesty International.

RRETH VICIOZ: MUNGESA E MBËSHTETJES AFATGJATË PENGON TË MBIJETUARAT TË NDËRTOJNË JETË TË RE

“Një grua e vetme në Kosovë nuk jeton. Ajo mbijeton... Nëse nuk ke mbështetje të fortë familjare dhe struktura të tjera mbështetëse rreth vetes, je shënjestër e lehtë në këtë shoqëri. Çfarë kemi këtu është dështim institucional për të mbrojtur gratë.”

“Diana”, e mbijetuar e dhunës në familje nga Kosova²⁹⁹

Varësia ekonomike është ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në aftësinë e të mbijetuarave për t'i shpëtuar dhunës në familje dhe për të filluar një jetë të re. Në kontekstin e papunësisë së konsiderueshme në mesin e grave dhe pabarazive strukturore gjinore në Kosovë, shumë gra në marrëdhënie abuzive janë gjithashtu viktime të dhunës ekonomike.³⁰⁰ Sjellja shtrënguese e abuzuesve të tyre, në kombinim me mungesën e qasjes në të ardhura të pavarura ose kontrollit mbi financa ose pronë, rezulton që shumë të mbijetuara të mos kenë alternativë tjetër veçse të qëndrojnë në marrëdhënie abuzive.

Ekziston mbështetje e kufizuar, nëse jo fare, e qeverisë, duke përfshirë ndihmën financiare ose strehimin social, në dispozicion të të mbijetuarave të dhunës në familje, duke përfshirë ato që kalojnë nëpër strehimore.³⁰¹ Ndërsa strehimoret janë zgjidhje emergjente dhe e përkohshme, të mbijetuarat kërkojnë

²⁹⁹ Amnesty International, Intervistë me "Dianën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³⁰⁰ Amnesty International, Intervistë me Luljeta Demollin, drejtore e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, qershor 2022; Intervistë përmes një video-telefonate me Dr. Linda Gusia, Ligjëruese në Departamentin e Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës, maj 2022; Intervistë me Luljeta Aliun, qershor 2022; Intervistë me Arrita Rezniciqin, maj 2022.

³⁰¹ Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin, maj dhe gusht 2022; Intervistë me Ardita Balajn, tetor 2022; Intervistë me Jubilea Kabashin, korrik 2022; Intervistë me Fidane Hysenin, gusht 2022. Nga 10 të mbijetuarat e intervistuar nga Amnesty International që kishin lënë strehimoren, vetëm një raportoi se kishte marrë mbështetje në

ndihmë afatgjatë për t'u rikuperuar plotësisht dhe për të filluar ndërtimin e një jete të pavarur. Në kohën e shkrimit, qeveria nuk kishte asnjë politikë për të ofruar mbështetje qoftë edhe të përkohshme, të njëhershme për të ndihmuar kalimin e të mbijetuarave në jetë të pavarur. Shumica e të mbijetuarave që janë të papuna ose që nuk fitojnë mjaftueshëm për të paguar qiranë ose për të mbuluar shpenzimet e tyre të jetesës mbeten me shumë pak ose aspak mbështetje pasi largohen nga strehimoret.³⁰² Ndërsa disa gra të mbijetuara kthehen në familjet e tyre të lindjes, ato të cilat familjet nuk i pranojnë ose nuk mund t'i mbështesin³⁰³ janë të detyruara të kthehen te abuzuesit e tyre.³⁰⁴ Situata është veçanërisht e rëndë për njerëzit që përjetojnë dhunë në familje për shkak të orientimit të tyre seksual ose identitetit gjinor, sepse abuzuesit e tyre janë zakonisht familjet e tyre të lindjes. Kështu, janë të detyruar të qëndrojnë ose të kthehen në familje abuzive pa asistencë apo mbështetje qeveritare.³⁰⁵

Amnesty International kreu një shqyrtim sistematik të aktgjyqimeve penale në rastet e dhunës në familje,³⁰⁶ i cili zbuloi se 35.3% e të mbijetuarave tërhiqën mbështetjen e tyre nga ndjekja penale e rasteve.³⁰⁷ Dhjetë përqind e këtyre të mbijetuarave deklaruan se u tërhiqën sepse vareshin në mbështetjen financiare të kryesit për veten ose për fëmijët e tyre, dhe 44.4% e të mbijetuarave që u tërhiqën nga ndjekja penale e bënë këtë sepse raportuan se ishin sërish në marrëdhënie me të pandehurin.³⁰⁸ Amnesty International është e shqetësuar se mungesa e mbështetjes shtetërore për të mbijetuarat mund të kontribuojë në tërheqjen e tyre nga rastet e ndjekjes penale.

Siç tha një gjyqtare e rasteve penale: "Në gjykatat tona, viktimat shpesh i falin kryesit sepse nuk kishin mjete për t'u ndarë dhe për të jetuar të pavarur."³⁰⁹ Ky numër ka të ngjarë të jetë më i lartë, duke pasur parasysh se jo të gjitha viktimat mund të ndihen rehat të shprehin arsyet e tyre për t'u tërhequr.

Në disa raste, komunat mbështesin të mbijetuarat me banim social pas daljes nga strehimorja, por kjo mbështetje nuk është e institucionalizuar apo e rregullt.³¹⁰ Në një rast të dokumentuar nga Amnesty International, një e mbijetuar mori mbështetje për strehim social vetëm pas një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë nga një zyrtar vendas dashamirës.³¹¹ Megjithatë, shumica dërrmuese e të mbijetuarave të intervistuarat thanë se nuk morën asnjë mbështetje financiare ose tjetër nga autoritetet pasi u larguan nga strehimoret.

"Diana" nga Prishtina i tha Amnesty International se, edhe pse më në fund arriti të jetojë e pavarur, ajo ishte e vetëdijshme se shumë gra që largohen nga marrëdhëniet abuzive përfundimisht kthehen te abuzuesit e tyre: "Shumë prej tyre nuk mund të mbijetojnë vetë; ato janë financiarisht dhe emocionalisht të varura nga burrat e tyre".³¹²

Në strehimoren në Prishtinë, Amnesty International intervistoi "Gresa A", e mbijetuar e dhunës në familje nga pakica etnike ashkali në Kosovë. Ishte hera e tretë e "Gresës A" në strehimore pas dhunës fizike dhe psikologjike nga bashkëshortii dhe vjehrra. Ajo tha se familja e saj e lindjes i kishte thënë se mund të kthehej të jetonte me ta, por vetëm nëse do të vinte pa fëmijën e saj, gjë që ishte e papranueshme për "Gresën A".

formën e pagesës për qiranë e saj nga Komuna e Mitrovicës. Ajo tha se kjo pagesë, si dhe ndihma për gjetjen e një pune, ishte vendimtare për të filluar jetën e pavarur.

³⁰² Amnesty International, Intervistë me Sevdije Morinën, Zëvendës-Kryeprokurore e Shtetit të Kosovës, shtator 2022; Intervistë me Zana Hamitin, qershor 2022; Intervistë me Burhan Maxhunin, shtator 2022; Intervistë me Fidane Hysenin, gusht 2022.

³⁰³ Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Dr. Eli Krasniqin, antropologe dhe pedagoge në Departamentin e Historisë, Universiteti Karl-Franzes i Gracit, maj 2022.

³⁰⁴ Amnesty International, Intervistë me Sevdije Morinën, Zëvendës-Kryeprokurore e Shtetit të Kosovës, shtator 2022; Intervistë me Zana Hamitin, qershor 2022; Intervistë me Burhan Maxhunin, shtator 2022; Intervistë me Fidane Hysenin, gusht 2022; Intervistë me "Gresa A" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

³⁰⁵ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të organizatave LGBTI Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale dhe Lendi Mustafa, Shtator-Dhjetor 2022; Intervistë me "Learta" (emri është ndryshuar për anonimitet), dhjetor 2022.

³⁰⁶ Ky raport u referohet të gjitha vendimeve gjyqësore nga mostra e rastësishme sistematike si gjykime në raste të dhunës në familje, sepse ato janë raste të dhunës brenda familjes ose njësisë familjare ose midis bashkëshortëve apo partnerëve aktualë ose të mëhershëm. Këtu përfshihen disa vepra penale, duke përfshirë dhunën në familje, shkeljen e urdhrave mbrojtës, kanosjen, sulmin, ngacmimin, lëndimin e lehtë trupor, lëndimin e rëndë trupor, heqjen e paligjshme të lirisë, shkatërrimin e pronës, përbuzjen e gjykatës, armëmbajtjen pa leje dhe detyrimin, ndër të tjera.

³⁰⁷ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B1.1 Viktimat që tërhiqen nga ndjekja penale, Tabela 5.

³⁰⁸ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B1.1 Viktimat që tërhiqen nga ndjekja penale.

³⁰⁹ Rrjeti i Grave të Kosovës, "Nga ligjet në vepra – Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë" (i cituar më parë), faqe 96.

³¹⁰ Amnesty International, Intervista me Zana Hamitin, qershor, gusht dhe tetor 2022; Intervistë me Erëblina Dinaramën, qershor 2022; Intervistë me Fidane Hysenin, gusht 2022.

³¹¹ Amnesty International, Intervistë me "Majën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³¹² Amnesty International, Intervistë me "Dianën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

“Kisha pasë qef çerdhen djalit me ja ba pa pare, bile nja ni muj a dy me ma pagu dikush banesën deri sa e kisha marrë veten, deri sa e kisha gjetë ni punë për veti, qaq”, tha Gresa për Amnesty International.³¹³ “Gresa A” përfundimisht u kthye te burri i saj.³¹⁴

Sipas drejtores së Shoqatës së Prindërve të Ndarë, e cila mbështet mbi 360 nëna të vetme nga e gjithë Kosova, shumica e të cilave janë të mbijetuara të dhunës në familje, mungesa e mbështetjes së mjaftueshme shtetërore dhe strehimit social është një nga arsyt kryesore pse gratë vendosën të mos e raportojnë dhunën. Ato nuk shohin rrugëdalje nga marrëdhënie të tilla në planin afatgjatë.³¹⁵ Organizatat që punojnë me të mbijetuarat shprehën shqetësime të ngjashme.³¹⁶

Qeveria e Kosovës e ka njohur papunësinë, varësinë ekonomike të grave nga burrat dhe mungesën e mundësive për të udhëhequr një jetë të pavarur ekonomike dhe sociale si faktorë kyç që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore.³¹⁷ Strategjia Kombëtare e skaduar tashmë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2016-2020) përfshinte futjen e shërbimeve të specializuara të rehabilitimit dhe riintegritimit për viktimat e dhunës në familje.³¹⁸ Fatkeqësisht, këto masa nuk u zbatuan. Në Strategjinë e re Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2022-2026), qeveria u zotua për një plan të detajuar me aktivitete konkrete, me institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre dhe akordime specifike buxhetore për realizimin e tyre.³¹⁹

Megjithatë, që nga miratimi i Strategjisë Kombëtare në shkurt 2022, nuk ka pasur zhvillime të dukshme në lidhje me asnjë nga këto programe apo aktivitete. Në kohën e shkrimit, të mbijetuarat e dhunës në familje nuk kishin qasje në asnjë program të ri të specializuar qeveritar që synonte rimëkëmbjen e tyre, pavarësi më të madhe, riintegrim të qëndrueshëm dhe fuqizim. Edhe pse qeveria kishte përcaktuar linja buxhetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024 në Strategjinë Kombëtare, këto shuma nuk u pasqyruan në buxhetet e miratuara për vitin 2022 apo 2023.³²⁰ Në përgjigje të kërkesës zyrtare të Amnesty International për informata, Ministria e Drejtësisë konfirmoi se janë duke zhvilluar “një masë mbështetëse” për gratë dhe vajzat që janë viktimat të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, e cila synon “të ofrojë mundësi punësimi dhe subvencione shtetërore për viktimat për një periudhë të caktuar”.³²¹

Në disa komuna, qeveritë lokale kanë zbatuar masa për të mbështetur të mbijetuarat e dhunës në familje drejt pavarësisimit. Komunitat e Gjakovës dhe Mitrovicës ofrojnë ndihmë për disa të mbijetuara në formë të subvencionimit të qirasë; megjithatë, kjo nuk bëhet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.³²² Komuna e Prishtinës bëri përpunim të rëndësishëm në këtë drejtim në nëntor 2022, kur Kuvendi Komunal prezantoi ndihmë të veçantë financiare për të mbijetuarat e dhunës në familje, duke përfshirë mbështetjen financiare deri në 250 euro në muaj për qiranë dhe 150 euro ndihmë direkte financiare, nëse e mbijetuara nuk është përfutuese e ndonjë skeme tjetër sociale.³²³ Të mbijetuarat me fëmijë marrin 100 euro shtesë për fëmijë.³²⁴ Kjo mbështetje e specializuar ofrohet për një periudhë nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe kushtëzohet nga denoncimi i dhunës në familje nga e mbijetuara në polici dhe aplikimi për urdhër mbrojtës në gjykatë. QPS-ja obligohet të ndihmojë të mbijetuarat që qëndrojnë në strehimore dhe dëshirojnë të aplikojnë për këtë ndihmë, por ata mund të ndihmojnë edhe të mbijetuarat jashtë strehimoreve. Kjo ndihmë është në

³¹³ Amnesty International, Intervistë me “Gresën A” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

³¹⁴ Amnesty International, Intervistë me Zana Hamitin, tetor 2022.

³¹⁵ Amnesty International, Intervistë me Arjeta Gashin, shtator 2022.

³¹⁶ OSBE, “Anketa mbi dhunën ndaj grave – Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë” (e cituar më parë), faqe 83.

³¹⁷ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 1.

³¹⁸ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit, 2016-2020, maj 2016.

³¹⁹ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 49.

³²⁰ Ligji Nr.08/L-066 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51763 (qasur më 25 gusht 2023); Ligji Nr.08/L-193 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, (qasur më 25 gusht 2023).

³²¹ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Përgjigje Zyrtare ndaj gjetjeve të hulumtimit të Amnesty International mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës në familje, 22 gusht 2023. Në dosje të Amnesty International.

³²² Amnesty International, Intervistë me Erëblina Dinaramën, qershor 2022; Intervistë me (atëherë) nënkryetaren e Komunitetit të Mitrovicës së Veriut, Adriana Hodžić, shtator 2022.

³²³ Kuvendi i Komunitetit të Prishtinës, Vendim për përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje, 24 nëntor 2022, i vënë në dispozicion të Amnesty International.

³²⁴ Paga mesatare bruto në Kosovë në vitin 2021 ishte 484 euro. Shih: Agjencia e Statistikave të Kosovës, “Niveli i Pagave në Kosovë”, 2021, 27 maj 2022, ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/niveli-i-pagave -ne-kosove-2021 (qasur më 27 korrik 2023).

dispozicion vetëm për banorët e komunës së Prishtinës. Deri në mars 2023, 22 persona kishin aplikuar për ndihmë; pesë e kishin marrë, shtatë ishin refuzuar dhe aplikacionet e tjera ishin ende në procesim.³²⁵

Komuna e Prishtinës ka reklamuar ndihmën speciale për të mbijetuarat e dhunës në familje përmes platformës së saj online, Strehimores në Prishtinë, QPS-së, diskutimeve me qytetarët, mediave sociale dhe paraqitjeve televizive.³²⁶ Duke pasur parasysh që kjo është politikë e re, nevojiten më shumë përpjekje për ta reklamuar atë dhe për të siguruar që informatat të arrijnë te të mbijetuarat që mund të mos kenë qasje në kanalet e lartpërmendura.

Konventa e Stambollit kërkon që shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që viktimat të kenë qasje në shërbimet që lehtësojnë rimëkëmbjen e tyre nga dhuna. Masa të tilla duhet të përfshijnë, ndër të tjera, ndihmë financiare, strehim, arsim, trajnim dhe ndihmë për gjetjen e punësimit.³²⁷ Komiteti CEDAW u ka kërkuar gjithashtu shteteve të sigurojnë “qasje në asistencë financiare [...] arsimim, strehim të përbalueshëm, tokë, kujdes për fëmijët, trajnim dhe mundësi punësimi për gratë që janë viktimat/të mbijetuara dhe anëtarët e familjeve të tyre”.³²⁸ Përveç kësaj, Raportuesi Special i OKB-së për të drejtën për strehim adekuat ka theksuar se legjislacioni për dhunën në familje duhet të njohë lidhjen me të drejtën për strehim adekuat dhe të përfshijë mbrojtje ligjore për të mbijetuarat dhe vartësit e tyre për të realizuar këtë të drejtë, duke përfshirë sigurimin e strehimit alternativ të përshtatshëm për të mbijetuarat dhe vartësit e tyre.³²⁹

Qeveria e Kosovës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të ketë një rrugëdalje të qartë nga marrëdhëniet abuzive për të mbijetuarat e dhunës në familje. Kjo duhet të përfshijë masa të posaçme të mbrojtjes sociale që ua mundësojnë të mbijetuarave të ushtrajnë të drejtat e tyre sociale dhe ekonomike, duke përfshirë të drejtat për standard të përshtatshëm jetese dhe pune. Masa të tilla duhet të jenë të arritshme dhe kriteret e pranueshmërisë duhet të reflektojnë realitetin e jetuar të të mbijetuarave, për shembull kur lënda mund të jetë në pritje në gjykatë, ose kur ato nuk e kanë raportuar rastin në polici. Të mbijetuarave dhe vartësve të tyre duhet t'u sigurohet qasje në strehim urgjent dhe strehim social afatgjatë, aty ku është e mundur, dhe duhet të jenë ndër personat e priorizuar për ndarjen e banesave sociale.

³²⁵ Amnesty International, korrespondencë me email me përfaqësues të Komunës së Prishtinës, 23 mars 2023.

³²⁶ Amnesty International, korrespondencë me email me përfaqësues të Komunës së Prishtinës, 23 mars 2023.

³²⁷ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 20.

³²⁸ CEDAW Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 (i cituar më parë), para. 31 (iii).

³²⁹ Gratë dhe strehimi adekuat: Studim nga Raportuesi Special për Strehimin adekuat si komponent i së drejtës për një standard adekuat të jetesës, Miloon Kothari, OKB DOC. E/CN.4/2005/43, 2005, para. 46.

VENDIMET E GJYKATAVE PËR ALIMENTACION TË VONUARA

Procedurat gjyqësore për shkurorëzim, alimentacion dhe ndarje të pasurisë mund të zgjasin për shumë vite, duke i lënë të mbijetuarat në një pozitë shumë të pasigurt, veçanërisht kur duhet të kujdesen për fëmijët e tyre pa mbështetje financiare. Hulumtimi zbuloi se shumë pak kryes të dhunës në familje paguajnë alimentacion, edhe kur kjo kërkohet nga gjykatat, dhe shtetit i mungojnë mekanizmat efektivë për të siguruar zbatimin.³³⁰

Të mbijetuarat e intervistuar nga Amnesty International vunë në dukje se gjykatat prireshin të përcaktonin një shumë fikse – zakonisht mes 50 dhe 150 euro në muaj – për alimentacion dhe rrallë merrnin parasysh të ardhurat e kryesit.³³¹ "Ana", një e mbijetuar e cila mori një urdhër mbrojtës që kërkonte që burri i saj të paguante alimentacion prej 150 eurosh në muaj për një periudhë gjashtëmuajore, kujton se si mbrojtësi i viktimës ishte befasuar këndshëm: "Mbrojtësi i viktimës tha 'wow', sikur me kanë arritje e jashtëzakonshme [...] tha se shumë janë zakonisht shumë ma të ulëta. Unë u konsiderova me fat".³³²

"Diella", një tjetër e mbijetuar, i tha Amnesty International se burri i saj, i cili normalisht fiton rreth 3,500 euro në muaj, ishte urdhëruar të paguante vetëm 150 euro për fëmijën e tyre: "Ai nuk më ka dhanë pare ni vjet hiç për fminë. Kur lypa ndihmë te mbrojtësit e viktimave m'thanë 'Po ti koke n'punë, ti duhet me i mbulu shpenzimet për fëmijën ton'. Une e kom 500 euro rrogën [në muaj]".³³³

Gjykatat njëmend përballeshin me vështirësi në vlerësimin e të ardhurave të kryesve që punojnë në ekonominë joformale, pasi nuk ekziston asnjë mënyrë e besueshme për të përcaktuar të ardhurat e tyre. Edhe në rastet kur gjykatat nxjerrin vendime që urdhërojnë burrin të paguajë alimentacionin, të intervistuarat i thanë Amnesty International se shumë kryes të dhunës në familje refuzojnë të paguajnë. "Diana", nënë e vetme e dy fëmijëve, i tha Amnesty International se shteti do të duhej të paguajë alimentacionin për fëmijët paraprakisht dhe më pas të kërkojë t'i marrë paratë nga prindi tjetër.³³⁴

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026) përfshin ndërgjegjësimin dhe trajnimin gjyqësor për të drejtat e përbashkëta pronësore dhe alimentacionin e fëmijëve. Megjithatë, siç theksohet në raportin e KE/GREVIQ, nuk ka udhëzime gjyqësore apo monitorim të rregullt të praktikave administrative dhe gjyqësore për të adresuar zbrazëtitë në zbatimin e ligjeve që lidhen me qasjen e barabartë të grave në pronë, trashëgimi dhe alimentacion të fëmijëve, që është boshllëk i cili duhet të

³³⁰ Amnesty International, Intervista me të mbijetuarat "Diana", "Diella" dhe "Kaltrina" (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-tetor 2022; Intervistë me Adelina Berishën, 1 qershor 2022; Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022; Intervistë me Arjeta Gashin, drejtore në Shoqatën e Prindërve të Vetëm, Shtator 2022; Intervistë me Luljeta Aliun, Nisma për Drejtësi dhe Barazi, qershor 2022; Intervistë me Luljeta Demollin, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, maj 2022.

³³¹ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022; Intervistë me Arjeta Gashin, shtator 2022; Intervistë me Luljeta Aliun, qershor 2022.

³³² Intervistë me "Anën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³³³ Intervistë me "Diellën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³³⁴ Intervistë me "Dianën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

adresohet urgjentisht nga autoritetet e Kosovës, krahas përpjekjeve të tjera për të siguruar qasje të barabartë të të mbijetuarave në të drejtat sociale dhe ekonomike.

TË MBIJETUARAT TË DETYRUARA TA NAVIGOJNË TË VETME NJË SISTEM KOMPLEKS TË DREJTËSISË

10.1 SISTEMI I MBËSHTETJES LIGJORE DËSHTON NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NDAJ TË MBIJETUARAVE

Një aspekt kyç i përgjigjes së qeverisë ndaj dhunës në familje është sigurimi i mbështetjes ligjore, përfaqësimit dhe ndihmës për të mbijetuarat. Në Kosovë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave u ofron viktimave të krimeve, duke përfshirë dhunën në familje, mbështetje në qasjen në drejtësi përmes procedurave ligjore.³³⁵ Mbrojtësit e viktimave – profesionistë ligjorë brenda Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave – ofrojnë shërbime ligjore dhe përfaqësim falas për viktimat e krimeve që nga kontakti i tyre fillestar me autoritetet, përfshirë policinë, prokurorinë dhe gjykatat penale, si dhe në procedurat për kërkesat për urdhëra mbrojtës në gjykatat civile.³³⁶

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave ka mungesë të personelit dhe burime të pamjaftueshme dhe për këtë arsye është e paaftë për të ndihmuar dhe përfaqësuar në mënyrë efektive viktimat e dhunës në familje t'i qasen drejtësisë. Në mungesë të mbështetjes ligjore të qëndrueshme dhe adekuate, të mbijetuarat lihen ta navigojnë të vetme një sistem kompleks të drejtësisë.

10.1.1 MBROJTËSIT E VIKTIMAVE - ME STAF TË PAMJAFTUESHËM, TË MBINGARKUAR DHE JO TË PRANISHËM

“Jemi vetëm dy mbrojtës të viktimave në të gjithë rajonin e Mitrovicës, i cili mbulon shtatë komuna. Ndonjëherë duhet të

³³⁵ Kjo zyrë funksionon si organ i pavarur në kuadër të Prokurorisë së Shtetit dhe ka shtatë zyra rajonale në mbarë Kosovën.

³³⁶ Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje, Neni 2(1.8). Kodi i Procedurës Penale, Neni 63(2).

punojmë me turne 24-orëshe për të mbuluar ngarkesën e punës.”

Një mbrojtës i viktimave nga Mitrovica³³⁷

Numri vazhdimisht i ulët i stafit në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhimën të Viktimave është çështje e kahershme.³³⁸ Vetëm 24 mbrojtës të viktimave kanë punuar në gjithsej 2,847 raste, 774 më shumë se në vitin 2021.³³⁹ Shumica dërrmuese e këtyre rasteve përfshinin dhunë në familje.³⁴⁰ Ekziston një konsensus në mesin e shoqërisë civile, policisë dhe profesionistëve ligjorë në Kosovë që Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimën të Viktimave ka pasur vështirësi të kryejë rastet dhe se ekziston një nevojë urgjente për të rritur ndjeshëm numrin e stafit dhe kapacitetet e tyre.³⁴¹

Përveçse nuk kanë staf të mjaftueshëm dhe janë të mbingarkuar, mbrojtësve të viktimave shpesh u mungon hapësira adekuate për zyra, duke i lënë pa një vend ku mund të flasin në mënyrë konfidenciale me viktimat.³⁴² Një gjyqtare nga Gjykata Themelore e Prishtinës i tha Amnesty International: “I kam parë duke punuar në kushte të tmerrshme, duke u takuar me palët dhe duke shfletuar dokumente në oborr. Nuk i kanë as kushtet elementare të punës dhe duhet të vrapojnë nga një rast në tjetrin”.³⁴³

Këto sfida të vazhdueshme i lënë mbrojtësit e viktimave të paaftë për të ndihmuar në mënyrë efektive viktimat e dhunës në familje. Mungesa e tyre vihet re në të gjitha segmentet e sistemit të drejtësisë, në çdo fazë të ndërveprimit të viktimës me institucionet. Sipas shefit të Njësisë së Policisë së Kosovës për Parandalimin e Dhunës në Familje në Prishtinë, mbrojtësit e viktimave rallë vijnë në polici për t'i ndihmuar viktimat kur janë duke raportuar rastet e dhunës në familje.³⁴⁴ Mbrojtësit e viktimave gjithashtu mungojnë shpesh në proceset gjyqësore civile për kërkesat për urdhër mbrojtës, siç konfirmohet nga një gjyqtare e intervistuar për këtë studim.³⁴⁵

Shqyrtimi i vendimeve të gjykatave nga Amnesty International konfirmon se sfida e nënpërfaqësimit të të mbijetuarave është e përhapur. Dy të tretat e të mbijetuarave të dhunës në familje ishin të pranishme në gjykatë.³⁴⁶ Nga të gjitha 255 të mbijetuarat, 52 të mbijetuara (20.4%) u përfaqësuan nga një mbrojtës i viktimave. Në anën tjetër, tetë të mbijetuara (3.1%) u përfaqësuan nga një avokat privat. Shumica e viktimave (199 individë, 78%) nuk u përfaqësuan nga asnjë profesionist ligjor.³⁴⁷ Një raport i vitit 2022 nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore, i cili analizoi një mostër të

³³⁷Amnesty International, Intervistë me mbrojtësin e viktimave Burhan Maxhuni, shtator 2022.

³³⁸Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), Kompensimi për viktimat e krimit: Përgjigje ndaj rasteve të dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore, mars 2018, kipred.org/repository/docs/Final_English_Version_141863.pdf (qasur më 23 gusht 2018), faqe 22; Rrjeti i Grave të Kosovës, “Nga ligjet në veprim – Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë”, womensnetwork.org/publications/from-laws-to-action-2/, 7 maj 2021, (qasur më 25 gusht 2023), faqe 90; Agjencia për Barazi Gjinore, “Vlerësimi i Nivelit të Zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” (cituar më parë), faqe 28-29.

³³⁹Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, *Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit 2022* (i cituar më parë), faqe 73; Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit 2021, Shkurt 2022, [prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20I%20PUN%20C3%8B%20S%20C3%8B%20PROKURORIT%20T%20C3%8B%20SHTETIT%20P%20C3%8B%20VITIN%202021\(1\).pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20I%20PUN%20C3%8B%20S%20C3%8B%20PROKURORIT%20T%20C3%8B%20SHTETIT%20P%20C3%8B%20VITIN%202021(1).pdf), (qasur më 25 gusht 2023), faqe 72.

³⁴⁰Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, *Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit 2022* (i cituar më parë), faqe 73.

³⁴¹Amnesty International, Intervistë me Zëvendësministrin e atëhershëm të Drejtësisë dhe Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, qershor 2022; Intervistë me Ilire Vitijën, gjyqtare në Gjykatën Themelore të Prishtinës, qershor 2022; Intervistë me Basri Kastratin, qershor 2022; Intervistë me Burhan Maxhunin, shtator 2022.

³⁴²Agjencia për Barazi Gjinore, Vlerësimi i Nivelit të Zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje (i cituar më parë), faqe 28-29.

³⁴³Amnesty International, Intervistë me gjyqtaren Ilire Vitija, qershor 2022.

³⁴⁴Amnesty International, Intervistë me kapitenin e policisë Arsim Shala, qershor 2022.

³⁴⁵Rrjeti i Grave të Kosovës, “Nga ligjet në veprim – Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë” (i cituar më parë), faqe 91 (ky raport tregon se mungesa e mbrojtësve të viktimave në procedurat gjyqësore për urdhër mbrojtës është çështje e përsëritur); Amnesty International, Intervistë me Ilire Vitijën, qershor 2022.

³⁴⁶Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B1.2 Prania e viktimave gjatë proceseve gjyqësore, Tabela 6.

³⁴⁷Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B1.3 Përfaqësimi ligjor profesional, Tabela 8: Shpërndarja e viktimave që ishin të përfaqësuara nga një mbrojtës/e i/e viktimave dhe/ose nga një avokat/e privat/e gjatë procesit penal.

rastësishme prej 50 aktgjykimesh të dhunës në familje, në mënyrë të ngjashme zbuloi se viktimat nuk morën asnjë përfaqësim ligjor profesional në 72% të rasteve.³⁴⁸

Zbrazëtitë sistematike në punën e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave detyrojnë shumicën e të mbijetuarave të nagjovjnë të vetme në një sistem të ndërlikuar të drejtësisë penale, pa mbështetje ligjore, përfaqësim apo ndihmë. Për më shumë, siç shtjellohet më poshtë, edhe kur mbrojtësit e viktimave janë të pranishëm, shpesh ofrojnë mbështetje dhe ndihmë joadekuate.

10.1.2 ZYRA PËR MBROJTJE DHE NDIHMË TË VIKTIMAVE DËSHTON NË DETYRIMET NDAJ TË MBIJETUARAVE

“Kur e pyeta [mbrojtësin e viktimave] pse s’po thotë kurgjo në gjykatë, ai u përgjigj – ‘rasti fiton vet.’”

“Diella” nga Prishtina³⁴⁹

“Ai vazhdimisht më thojke ‘mos fol, mos fol!’ Unë i thashë, ‘qysh mos fol, ti s’po thu asni sen!... dikush duhet me më mbrojtë, nëse s’e bon ti, e mbroj une veten.’”

“Kaltrina” nga Podujeva³⁵⁰

Shumë pak të mbijetuara të intervistuar për këtë raport thanë se mbrojtësit e viktimave ishin të dobishëm. Shumë të mbijetuara ishin kritike ndaj mbrojtësve të viktimave dhe kërkuan që ata të ishin më të përgatitur dhe më proaktivë në seancat gjyqësore. Të mbijetuarat u ankuan se mbrojtësit e viktimave nuk përfaqësonin gjithmonë në mënyrë adekuate interesat e tyre në gjykatë, se ata shpesh ofronin vetëm mbështetje sipërfaqësore ose në përgjithësi nuk ishin të dobishëm.³⁵¹ Sipas një gjyqtareje nga Gjykata Themelore në Prishtinë, avokatët e viktimave shpesh duken të papërgatitur për procedurat gjyqësore të urdhrave mbrojtës dhe prirjen të bëjnë deklaratat që janë të përgjithshme dhe jo specifike për faktet e rastit apo për viktimën që ata përfaqësojnë.³⁵²

Në një intervistë me Amnesty International, ish-Koordinatorja Kombëtare për Mbrojtjen ndaj Dhunës në Familje pranoi se mbrojtësit e viktimave kanë mungesë të financimit, staf të pamjaftueshëm dhe paguhen pamjaftueshëm dhe shpjegoi se Ministria e Drejtësisë po përgatit një plan për të përmirësuar funksionimin e tyre.³⁵³ Megjithatë, asnjë përparim i rëndësishëm nuk ishte bërë në kohën e shkrimit. Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nga janari 2022 parashikon ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve për mbrojtësit e viktimave³⁵⁴ dhe "kapacitete të përshtatshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore", duke përfshirë zgjerimin e stafit nga 24 në 40.³⁵⁵ Amnesty International kontaktoi Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, por nuk ka marrë asnjë përgjigje lidhur me këtë konstatim deri në momentin e publikimit.

³⁴⁸ Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore, “Konventa e Stambollit në vendimet e gjykatave në Kosovë”, shtator 2022, kli-ks.org/konventa-e-stambollit-ne-aktgjykimet-e-gjykatave-ne-kosove/ (qasur më 25 gusht 2023).

³⁴⁹ Intervistë me “Diellën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³⁵⁰ Intervistë me “Kaltrinën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

³⁵¹ Amnesty International, Intervista me “Diellën”, “Nitën”, “Violetën” dhe “Anën” (emrat janë ndryshuar për anonimitet), korrik-dhjetor 2022.

³⁵² Amnesty International, Intervistë me Ilire Vitijën, qershor 2022. Gjykatësja tregoi një situatë ku një mbrojtës i viktimës përsëriti kërkesën e supozuar të viktimës për t’i hequr të drejtat prindërore kryesit në rastin e një viktime që nuk kishte fëmijë.

³⁵³ Amnesty International, Intervistë me Dr. Nita Shalën, qershor 2022.

³⁵⁴ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (ecitur më parë), faqe 77-78.

³⁵⁵ Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 104.

Ligji dhe standardet ndërkombëtare obligojnë shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave/të mbijetuarave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitare, në të gjitha fazat e hetimit dhe procedurave ligjore.³⁵⁶ Për këtë qëllim, shtetet duhet të sigurojnë që masat kyçe të vihen në vend, duke përfshirë qasjen efektive dhe me kohë në procedurat ligjore;³⁵⁷ qasjen në informatat e dhura dhe në kohë për shërbimet mbështetëse dhe masat ligjore në dispozicion;³⁵⁸ dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, përkthimit dhe mbështetjes gjyqësore, duke përfshirë ndërmjetës dhe avokatë të pavarur.³⁵⁹

Amnesty International gjeti se autoritetet në Kosovë dështuan të garantojnë të drejtat dhe interesat e viktimave në procedurat ligjore dhe të ofrojnë mbështetje adekuate, efektive dhe në kohë, asistencë ose shërbime të tjera ligjore në ndërveprimet e viktimave me sistemin e drejtësisë. Autoritetet e Kosovës duhet të shtojnë urgjentisht numrin e stafit në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në të gjithë vendin dhe të zhvillojnë trajnime për ngritjen e kapaciteteve me mbrojtësit e viktimave për të përmirësuar performancën e tyre dhe për t'ua mundësuar t'i plotësojnë nevojat e të mbijetuarave.

10.2 PËRGJIGJJA E DREJTËSISË PENALE DËSHTON NDAJ TË MBIJETUARAVE

Përgjigjja e shtetit të Kosovës ndaj dhunës në familje ka përqendrim të fortë në sistemin e drejtësisë penale, ku shumica e fushatave informuese të sponsorizuara nga shteti fokusohen pothuajse ekskluzivisht në inkurajimin e të mbijetuarave t'i raportojnë rastet në polici.³⁶⁰ Nëse ka prova të mjaftueshme se është kryer një vepër penale, prokuroria ngre aktakuzë në gjykatë dhe zhvillohet një proces gjyqësor penal për të përcaktuar fajësinë e të pandehurit dhe dënimin përkatës. Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset penale, por mungesa e tyre nuk e pengon gjykatën në marrjen e vendimit.³⁶¹ Viktimat gjithashtu mund të thirren si dëshmitare, t'i paraqesin gjykatës parashtesa me shkrim, siç është deklarata e dëmit të pësuar, të paraqesin prova, të marrin në pyetje dëshmitarët e tjerë dhe të paraqesin propozime të tjera.³⁶²

Pavarësisht ndryshimeve legjislative të vitit 2019, të cilat e definuan dhunën në familje si vepër penale më vete dhe çuan në emërimin e prokurorëve të specializuar për rastet e dhunës në familje, hulumtimi i Amnesty International zbuloi se sistemi i drejtësisë penale po dështon ndaj të mbijetuarave. Të dhënat e mbledhura tregojnë se kryesisht që dënohen për dhunë në familje marrin në mënyrë rutinore dënime që nuk janë në proporcion me peshën e veprës penale, veçanërisht duke pasur parasysh natyrën e dhunshme të shumë prej këtyre krimeve dhe aspektin diskriminues të dhunës në familje si formë e dhunës me bazë gjinore që ka ndikim joproporcional të gratë dhe vajzat.³⁶³ Për më shumë, në disa raste kur të dy partnerët intimitë u dënuan për dhunë në familje, gjykatat neglizhuan të marrin parasysh dinamikën e pushtetit të bazuar në gjini ndërmjet partnerëve.

Dënimet joproporcionale me peshën e veprës penale gërryejnë besimin e të mbijetuarave te sistemi i drejtësisë penale dhe i dekurajonë ato të raportojnë rastet dhe të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje që i nevojitet shumë.

³⁵⁶ Manuali i OKB-së për Legjislacionin mbi Dhunën kundër Grave, 2012, faqe 37. Shih gjithashtu Parimet dhe Udhëzimet Themelore mbi të Drejtën për një mjet juridik dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, 16 dhjetor 2005, OKB Doc. A/RES/60/147 92006, ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RemedyAndReparation.aspx (qasur më 25 gusht 2023). Shih gjithashtu Direktivën 2012/29/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 25 tetor 2012 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, (qasur më 25 gusht 2023).

³⁵⁷ Manuali i OKB-së për Legjislacionin mbi Dhunën kundër Grave, 2012, faqe 37; CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 44.

³⁵⁸ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 19.

³⁵⁹ Manuali i OKB-së për Legjislacionin mbi Dhunën kundër Grave, 2012, faqe 38; Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Nenet 56 (d-e dhe h) dhe 57.

³⁶⁰ Shih seksionin 4 të këtij raporti, Dështimi i Policisë ndaj viktimave të dhunës në familje.

³⁶¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 282(4).

³⁶² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 9(3) dhe 63.

³⁶³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B1 Viktimat dhe Figura 2: Shpërndarja krahasuese e gjinisë së viktimave, sipas llojit të marrëdhënies.

10.2.1 DËNIMET JOPROPORCIONALE ME PESHËN E VEPRËS PENALE

Dhuna në familje dënohet me burgim deri në tri vjet dhe me gjobë nga 100 deri në 25,000 euro.³⁶⁴ Në përgjithësi, për çdo vepër penale që dënohet me burgim deri në pesë vjet mund të shqiptohet si dënim me kusht.³⁶⁵ Gjykatat gjithashtu mund t'i urdhërojnë kryesit të bëjnë shërbim në komunitet, të përdorin të ardhurat ose pasurinë e tyre për të përmbushur detyrimet familjare, t'i nënshtrohen këshillimit psikologjik apo programeve rehabilituese ose trajtimit mjekësor, të përmbahen nga përdorimi i drogës ose alkoolit ose kontaktimit të personave të caktuar dhe të kompensojnë viktimat për dëmet.³⁶⁶

Pesë nga gjashtë të mbijetuara të intervistuarat për këtë raport thanë se dhunuesit e tyre, të cilët u shpallën fajtorë, morën vetëm gjoba ose dënime me kusht pa mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. Këto të mbijetuara shprehën dëshirën për dënime më të ashpra, sepse dënimet e dhunuesve të tyre i bënë ato të ndiheshin të pasigurta dhe të pambështetura. Katër nga gjashtë të mbijetuarat raportuan se abuzuesit e tyre vazhduan të ishin të dhunshëm edhe pasi u dënuan. Dënimet për dhunën në familje kryesisht konsiderohen nga të mbijetuarat dhe shoqëria civile, si dhe nga disa zyrtarë shtetërorë, si joproportionale me peshën e veprave penale, duke kontribuar kështu në një mjedis të pandëshkueshmërisë.³⁶⁷

Shqyrtimi sistematik nga Amnesty International i vendimeve gjyqësore kundër 218 të pandehurve zbuloi se vetëm 11% morën dënim me burg;³⁶⁸ 74% u dënuan me burgim me kusht, 45% morën gjobë dhe 20% morën gjobë me kusht, duke vënë në dukje se disa të pandehur morën një kombinim dënimesh, si dënim me burg me kusht dhe gjobë me kusht.³⁶⁹ Në një sërë rastesh, dënimet e shqiptuara njohën edhe kohën e kryer në paraburgim me pjesën e mbetur të dënimit me kusht. Vërejtje gjyqësore iu dhanë 2% të kryesve dhe 6% u urdhëruan t'i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.³⁷⁰ Kohëzgjatja mesatare dhe më e zakonshme e dënimeve me burgim me kusht ishte gjashtë muaj, ndërsa dënimet me burg ishin mesatarisht shtatë muaj.³⁷¹ Gjoba mesatare ishte 375 euro, ndërsa gjoba mesatare e pezulluar ishte 309 euro.³⁷² Sa u përket urdhrave shtesë të gjykatës që mund të jenë pjesë e dënimit, 83% e të pandehurve u urdhëruan të bëjnë pagesë deri në 30 euro në Fondin e Kompensimit të Viktimave.³⁷³

Gjykatat mund të shqiptojnë kombinime dënimesh dhe urdhra të tjerë. Shqyrtimi i Amnesty International zbuloi se rezultati më i zakonshëm ishte dënimi me burgim me kusht pa mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, i kombinuar me një gjobë prej disa qindra eurosh dhe një urdhër për të bërë pagesë simbolike në Fondin për Kompensimin e Viktimave (46 të pandehur, ose 21%), i ndjekur nga dënimi me burgim me kusht i kombinuar me urdhër për pagesën në Fondin e Kompensimit të Viktimave (32 të pandehur, ose 15%).³⁷⁴

Sa u përket kushteve shtesë të pandehurit mund të merrnin si pjesë e dënimit të tyre, më pak se 1% e të pandehurve u urdhëruan të kryejnë shërbim në komunitet (dy nga gjithsej 218 të pandehur), ose u urdhëruan t'i nënshtrohen këshillimit psikologjik (një i pandehur).³⁷⁵ Një çështje veçanërisht brengosëse, duke pasur parasysh barrierat drejt mbështetjes ekonomike që përjetojnë të mbijetuarat, siç përshkruhet më

³⁶⁴ Kodi Penal i Kosovës, Nenet 248 dhe 43.

³⁶⁵ Kodi Penal i Kosovës, Neni 49.

³⁶⁶ Kodi Penal i Kosovës, Neni 56.

³⁶⁷ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të OJQ-ve Rrjeti i Grave të Kosovës, Instituti Demokratik i Kosovës, Nisma për Drejtësi dhe Barazi, Zëvendës-Kryeprokuroren e Shtetit, mbrojtësin e viktimave në Mitrovicë, drejtorin e atëhershëm të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, Fitim Gashin dhe Dr. Ariana Qosaj Mustafën, maj-dhjetor 2022.

³⁶⁸ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B5 Dënimi, Tabela 16: Shpërndarja e shpeshhtësisë së dënimeve ndërmjet të pandehurve.

³⁶⁹ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B5 Dënimi, Tabela 16: Shpërndarja e shpeshhtësisë së dënimeve ndërmjet të pandehurve.

³⁷⁰ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B5 Dënimi, Tabela 16: Shpërndarja e shpeshhtësisë së dënimeve ndërmjet të pandehurve.

³⁷¹ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.1 Shpërndarja e dënimeve me burgim me kusht dhe efektiv, në muaj dhe Tabela 18: Statistikat përmbledhëse për shpërndarjen e dënimeve dhe urdhrave që mund të shprehen në euro ose muaj.

³⁷² Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.2 Shpërndarja e gjobave efektive dhe të pezulluara, në euro.

³⁷³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih Tabelën 17: Shpërndarja e shpeshhtësisë së urdhrave ndërmjet të pandehurve.

³⁷⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.4 Kombinimet e dënimeve dhe urdhrave, Figura 11: Kombinimet e vërejtura të dënimeve dhe urdhrave për 218 të pandehur, sipas statusit të ligjit aktual dhe të mëparshëm penal.

³⁷⁵ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B5 Dënimi, Tabela 16: Shpërndarja e shpeshhtësisë së dënimeve ndërmjet të pandehurve.

sipër, është gjetja se vetëm një i pandehur nga 218 u urdhërua të përdorte burimet e tij financiare për ta mbështetur familjen.³⁷⁶

Shqyrtimi i Amnesty International vuri në dukje gjithashtu se aktgjykimet në mënyrë rutinore përfshinin arsyetimin se dënimet e shqiptuara ishin adekuate dhe proporcionale me peshën e veprës penale dhe se ato do të përfshinin një efekt rehabilitues dhe parandalues. Megjithatë, rrallëherë kishte ndonjë tregues në vendimet e rastit se si kjo ishte arritur në rrethanat specifike të secilit rast.

Në intervistat e kryera nga Amnesty International, të mbijetuarat shprehën ndjenjën se nuk kishin marrë drejtësi, se shteti nuk ishte kujdesur për sigurinë dhe mirëqenien e tyre, dhe se kishin frikë për përsëritje të dhunës duke pasur parasysh mungesën e pasojave serioze ligjore për abuzuesit e tyre dhe mungesën e monitorimit apo intervenimit të shtetit për të parandaluar përsëritjen e veprës penale. "Edona" nga Drenasi tha: "Gjykatat nuk duhet me dhanë gjoba për dhunë në familje, sikur n'rastin tem; burrit tem i dhanë shumë gjoba dhe ai ka vazhdu me dhunë. Unë e di se ai ka me vazhdu hala ma keq edhe bon vaki vjen edhe deri te vrasja."³⁷⁷

Në vitin 2021, ish-bashkëshorti i "Nitës" u gjobit me 300 euro nga Gjykata Themelore në Prishtinë për keqtrajtim të vazhdueshëm fizik dhe psikologjik gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh. Ajo i tha Amnesty International: "Një gjobë prej 300 eurosh s'është kurgjo hiç, nesër nëse don edhe ma zi munet me ia ba dikujna, se e din që pshton me një gjobë prej 300 eurove.".³⁷⁸

Edhe bashkëshorti i "Diellës" mori gjobë prej 300 eurosh në vitin 2019 nga Gjykata Themelore në Prishtinë pasi e kishte abuzuar "Diellën" fizikisht dhe e kishte kërcënuar se do ta vriste. Ajo i tha Amnesty International se ai vazhdoi ta përndiqte dhe ta abuzonte psikologjikisht shumë kohë pasi gjykata e shpalli fajtor.³⁷⁹

Vetëm 11% e të pandehurve u urdhëruan që dënimi i tyre me kusht të mbikëqyret nga Shërbimi Sprovues dhe shumica e këtyre urdhrave të mbikëqyrjes (20 nga 24) u lëshuan nga e njëjta gjyqtare e Gjykatës Themelore në Gjakovë.³⁸⁰ Kjo tregon se mbikëqyrja e kohës sprovuese me urdhër të gjykatës nuk është praktikë e zakonshme. Kjo çështje u theksua në intervistat e bëra me të mbijetuarat, vetëm dy prej të cilëve raportuan se abuzuesit e tyre morën dënim me kusht të mbikëqyrrur.

Dëshmia e "Anës" nga Prishtina tregon ndikimin që mund ta ketë monitorimi shtetëror te të mbijetuarat e dhunës në familje. "Ana" tha se ishte e kënaqur kur bashkëshorti i saj u dënua me një vit burg me kusht për dhunë në familje me mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues: "U nijsha shumë mirë kur më thirrshin Shërbimi Sprovues, ma jepke ndjenjën që shteti po përkujdeset për mu".³⁸¹

Sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës "monitorimi aktiv, i rregullt... është mjeti më efektiv për të siguruar respektimin, riintegrimin dhe suksesin e përgjithshëm të dënimit me kusht". Për më shumë, Udhëzuesi paralajmëron gjykatat se dënimet me kusht pa kushte të bashkëngjitura kanë shumë më tepër gjasa të dështojnë sesa dënimet që monitorohen në mënyrë aktive.³⁸²

Sipas Konventës së Stambollit, Kosovës i kërkohet të vendosë sanksione të cilat janë "efektive, proporcionale dhe shkurajuese" për veprat që përbëjnë dhunë me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje.³⁸³ Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Kosova ka një detyrim "të zellit të duhur" të marrë të gjitha masat adekuate për të parandaluar, si dhe për të hetuar, ndjekur penalisht, ndëshkuar dhe siguruar dëmshpërbim për veprimet ose mosveprimet nga akterët joshetërorë që rezultojnë në dhunë me bazë gjinore ndaj grave".³⁸⁴

Për shkak të mungesës së monitorimit aktiv shtetëror të dënimeve, barra bie mbi të mbijetuarat që të raportojnë në polici rastet e shkeljes së dënimit me kusht. Të mbijetuarat mund të dekurajohen ta bëjnë këtë

³⁷⁶ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B5 Dënimi, Tabela 16: Shpërndarja e shpeshhtësisë së dënimeve ndërmjet të pandehurve.

³⁷⁷ Intervistë me "Edonën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

³⁷⁸ Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktgjykim, 2021, vënë në dispozicion të Amnesty International; Intervistë me "Nitën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³⁷⁹ Gjykata Themelore e Prishtinës, Aktgjykim, 2019, vënë në dispozicion të Amnesty International; Intervistë me "Diellën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

³⁸⁰ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.5 Urdhri i mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues.

³⁸¹ Intervistë me "Anën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

³⁸² Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, 2018, https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf, (qasur më 25 August 2023), faqe 174.

³⁸³ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 45.

³⁸⁴ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 45; Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.19 (i cituar më parë), para. 9. Shih gjithashtu Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 24 (b).

pasi shpesh mund të jetë proces i vështirë.³⁸⁵ Kjo praktikë e dënimit nuk ka në qendër të mbijetuarat dhe po krijon një mjedis në të cilin kryesit e dhunës në familje nuk përballen me pasoja për sjelljen e tyre.³⁸⁶

Shqyrtimi sistematik i 218 dënimeve nga Amnesty International zbuloi se 24 të pandehur (11%) ishin përsëritës që kishin kryer ose dhunë të mëparshme në familje, ose lloj tjetër veprë penale dhe 11 të pandehur (5%) kishin të paktën një dënim të mëparshëm për dhunë në familje.³⁸⁷ Shumica e kryesve përsëritës të dhunës në familje kanë pasur të paktën një shkelje të mëparshme për dhunë në familje, por një i pandehur ka pasur 17 vepra të mëparshme të dhunës në familje.³⁸⁸

Shqetësimeve për mosndëshkimin e kryesve të dhunës në familje iu bë jehonë nga OJQ-të, zyrtarët shtetërorë dhe ekspertët të cilët shqetësoheshin se gjykatat në Kosovë po përjetësonin pandëshkueshmërinë sistematike të kryesve të dhunës në familje përmes gjobave të ulëta dhe dënimeve me kusht.³⁸⁹ “Nëse një dhunues e di se dhuna në familje dënohet me gjobë ose dënim me kusht dhe ai nuk do të shkojë në burg nëse është i dhunshëm ndaj gruas së tij, e ka më të lehtë të vazhdojë të jetë i dhunshëm”, tha për Amnesty International një avokat që përfaqëson të mbijetuarat e dhunës në familje.³⁹⁰

Autoritetet e Kosovës duhet të sigurojnë që dënimet në rastet e dhunës në familje të jenë proporcionale me peshën e veprës penale dhe të mos përjetësojnë një mjedis mosndëshkimi.

Për më shumë, Akademia e Drejtësisë e Kosovës dhe gjyqtarët duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të rregullta në të drejtën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut rreth shqiptimit të sanksioneve efektive proporcionale dhe shkurajuese në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke u mbështetur në praktikat më të mira. Së fundi, gjyqësori dhe prokuroria duhet të zbatojnë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të monitorojnë zbatimin e tij në mënyrë periodike në bashkëpunim me organizatat që punojnë me të mbijetuarat e dhunës në familje.

10.2.2 VLERËSIMI JOADEKUAT I RRETHANAVE LEHTËSUESE

Shqyrtimi nga Amnesty International i 197 aktgjytimeve (që përmbajnë 218 dënime) zbuloi se gjatë procesit të ndëshkimit, gjykatat prireshin të pranonin në mënyrë rutinore rrethana të ndryshme lehtësuese në rastet e dhunës në familje.³⁹¹ Të dhënat e shqyrtuara tregojnë se në shumicën e rasteve gjykatat kanë zbutur ndëshkimet për kryesit e dhunës në familje bazuar në disa faktorë që lidhen veçanërisht me pranimin e fajit dhe pendimin e kryesit.

Dy të tretat e të mbijetuarave të dhunës në familje ishin të pranishme në gjykatë.³⁹² Gjykatat e konsideruan si rrethanë lehtësuese kur viktimat e fali kryesin, gjë që ndodhi në 75% të rasteve të përgjithshme, ose kur kryesi kërkoi falje dhe viktimat u tërhoq nga mbështetja e ndjekjes penale, që përbënte 45% të rasteve.³⁹³ Në grupin e dytë, 40 të mbijetuarat të partnerit intim thanë se u tërhoqën nga mbështetja e ndjekjes penale sepse ishin kthyer në lidhje me kryesin dhe nëntë të mbijetuarat u tërhoqën sepse kryesi i mbështeste financiarisht ato dhe/ose fëmijët e tyre.³⁹⁴

³⁸⁵ Shih seksionin 4 më sipër Dështimi i Policisë ndaj viktimave të dhunës në familje.

³⁸⁶ Amnesty International, Intervista me përfaqësues të OJQ-ve në Kosovë, përfaqësues të policisë dhe Zëvendës-Kryeprokuroren e Shtetit, maj-shtator 2022.

³⁸⁷ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.9 Shkelësit përsëritës.

³⁸⁸ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.9 Shkelësit përsëritës, Tabela 25: Numri i veprave të mëparshme të dhunës në familje për kryesit e përsëritës të dhunës në familje.

³⁸⁹ Amnesty International, Intervista me përfaqësues nga Rrjeti i Grave të Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Nisma për Drejtësi dhe Barazi, Zëvendës-Kryeprokuroren e Shtetit, mbrojtësi i viktimave në Mitrovicë, drejtori i atëhershëm i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, avokatin Fitim Gashin dhe Dr. Ariana Qosaj Mustafën, maj-dhjetor 2022. Shih gjithashtu: Instituti i Kosovës për Drejtësi, “Konventa e Stambollit në vendimet e gjykatave në Kosovë”, shtator 2022, ks.org/konventa-e-stambollit-ne-aktgjykimet-e-gjykatave-ne-kosove/ (qasur më 25 gusht 2023).

³⁹⁰ Amnesty International, Intervistë me Fitim Gashin, shtator 2022.

³⁹¹ Rrethanat lehtësuese zakonisht përfshijnë pranimin e fajit nga i pandehuri, kërkimfaljen, moshën e re, rrethanat personale dhe dëshminë se i akuzuari e ka kompensuar viktimën për dëmin e shkakuar. Rrethanat rënduese zakonisht përbëjnë përsëritjen e veprës penale, përdorimin e armës, nëse vepra përfshinte viktimat të shumta, moshën e viktimës(ave), dëmin e shkakuar, përfshirë lëndimet ose dëmet e tjera dhe nëse vepra penale kryhet brenda familjes, ndër rrethanat e tjera. Shih: Kodi Penal i Kosovës, Neni 70.

³⁹² Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.2 Prania e viktimave gjatë proceseve gjyqësore.

³⁹³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.6 Rrethanat lehtësuese, Tabela 19: Frekuenca e shqyrtimit të rrethanave lehtësuese gjatë dënimit për të pandehurit.

³⁹⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.1 Viktimat që tërhoqën nga ndjekja penale.

Të dhënat e shqyrtuara tregojnë se në shumicën e rasteve gjykatat kanë zbutur dënimet për kryesit e dhunës në familje bazuar në disa faktorë që lidhen veçanërisht me pranimin e fajit dhe pendimin. Të pandehurit e pranuar fajësinë në 92% të të gjitha rasteve të shqyrtuara, dhe kjo u mor si rrethanë lehtësuese në 99% të atyre rasteve.³⁹⁵ Për më shumë, shprehja e pendimit u konsiderua si rrethanë lehtësuese në 97% të rasteve përkatëse; premtimi i kryesit për mospërsëritje të veprës penale në 94% të rasteve; dhe kërkimfalja nga kryesi në 85% të rasteve përkatëse.³⁹⁶

Në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, Gjykata Supreme këshilloi gjykatat të kenë kujdes kur vlerësojnë rrethanat lehtësuese, veçanërisht në rastet e dhunës në familje. Gjykata Supreme njohu faktin se pranimi i fajësisë është përdorur prej kohësh si faktor lehtësues në shqiptimin e dënimit për shumë arsye. Megjithatë, paralajmëroi gjykatat se aplikimi i rastësishëm i këtij faktori mund të çojë në "rrethana të llogaritura dy herë në zbutjen dhe tej-vlerësimin e zbritjes përfundimtare. Më tej, këshilloi që gjykatat të mos i japin rëndësi joproporcionale pranimit të fajësisë në krahasim me faktorët e tjerë.³⁹⁷

Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore gjithashtu u kërkoi gjykatave ta kundrojnë të pandehurin "me skepticizëm sepse pendimi i rremë mund të jetë pjesë e ciklit të dhunës[...] [në] rastet e dhunës në familje".³⁹⁸ Gjyqtarët duhet të jenë të bindur se shprehja e pendimit ka qenë e sinqertë për ta pranuar atë si rrethanë lehtësuese në shqiptimin e dënimit.³⁹⁹ Ekzistojnë një sërë konsideratash që gjyqtari/ja duhet t'i marrë parasysh kur vendos nëse do të pranojë një shprehje pendimi si faktor lehtësues, duke përfshirë deklaratat e bëra nga i pandehuri që tregojnë pendim, nëse ai kishte kërkuar menjëherë ndihmë mjekësore nëse viktimat ishin lënduar, tentativa për kompensimin e dëmtimit të viktimës, e kështu me radhë.⁴⁰⁰ Megjithatë, deklaratat e të pandehurve në shumicën e vendimeve gjyqësore përfshinin një fjali të thjeshtë pa asnjë detaj që zakonisht lexohet si vijon: "i pandehuri pranon fajin, ai kërkon falje, shpreh pendim dhe i premtim gjykatës se nuk do ta përsërisë më".⁴⁰¹ Asnjë nga vendimet e shqyrtuara nuk përmbante asnjë tregues se ka ndodhur kompensimi i dëmit dhe shprehja e pendimit, së bashku me kërkimfajlin e kryesit dhe premtimin për mospërsëritje, u pranuan si faktorë lehtësues në pothuajse të gjitha rastet, madje edhe në rastet e përsëritjes së veprës penale.

Nga të gjithë 218 të pandehurit, 24 (11%) ishin dënuar më parë për vepra penale.⁴⁰² Prej tyre, 23 të pandehur kishin vepra të mëparshme penale përveç dhunës në familje, ndërsa 11 të pandehur kishin të paktën një dënim të mëparshëm për dhunë në familje.⁴⁰³ Një aspekt pozitiv i vendimeve është se gjykatat e konsideruan si rrethanë rënduese kur kryesi ishte përsëritës i dhunës në familje në të gjitha rastet e shqyrtuara.⁴⁰⁴ Megjithatë, kërkimfalja (77% e rasteve përkatëse), premtimi për mospërsëritje (95% e rasteve përkatëse) dhe shprehja e pendimit (95% e rasteve përkatëse) u konsiderua rrethanë lehtësuese edhe në rastet e shkelësve që kishin përsëritur e tyreveprën penale.⁴⁰⁵ Po ashtu, në shumicën e këtyre rasteve rrethanat lehtësuese u cituan së bashku në një fjali, pa asnjë argumentim të mëtejshëm. Në një rast në Pejë, një i pandehur u dënua për dhunë në familje ndaj partneres së tij intime për herë të pestë, por mori vetëm një dënim me burg prej gjashtë muajsh; një e gjashta e dënimit maksimal me burgim për dhunë në familje në Kosovë. Edhe këtu gjykata e konsideroi si rrethanë lehtësuese faktin që i pandehuri pranoi fajësinë, shprehu pendim dhe premtoi se nuk do ta bëjë më. Aktgjykimi nuk shtjellon arsyet e vendosjes së këtyre rrethanave lehtësuese.⁴⁰⁶

Shembulli më ekstrem në vendimet e studiuara është rasti i vendosur nga Gjykata Themelore e Gjilanit në të cilin një baba ishte dënuar për dhunë në familje ndaj tri vajzave të tij të mitura në 17 raste të mëparshme dhe iu shqiptua dënimi me burgim efektiv prej një viti e katër muajsh dhe 150 euro gjobë. Ky dënim bie në

³⁹⁵ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.6 Rrethanat lehtësuese, Tabela 19: Frekuenca e shqyrtimit të rrethanave lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit për të pandehurit.

³⁹⁶ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.6 Rrethanat lehtësuese, Tabela 19: Frekuenca e shqyrtimit të rrethanave lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit për të pandehurit dhe Figura 12: Marrja në konsideratë e rrethanave lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit për të gjithë të pandehurit.

³⁹⁷ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 124.

³⁹⁸ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 128.

³⁹⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 127.

⁴⁰⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 127 dhe 31-32.

⁴⁰¹ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin C.1 Struktura e vendimeve të Gjykatave Themelore të Kosovës për dhunën në familje.

⁴⁰² Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.9 Shkelësit përsëritës.

⁴⁰³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.9 Shkelësit përsëritës.

⁴⁰⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.7 Rrethanat rënduese, Tabela 20: Frekuenca e shqyrtimit të rrethanave rënduese gjatë shqiptimit të dënimit për të pandehurit.

⁴⁰⁵ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih Figurën 17: Marrja në konsideratë e rrethanave lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit të autorëve përsëritës.

⁴⁰⁶ Gjykata Themelore e Pejës, *Aktgjykimi P. nr. 559/20*, 19 korrik 2022, [peje.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PE_P_2020-105859_SQ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PE_P_2020-105859_SQ.pdf) (qasur më 25 gusht 2023).

gjysmën e ulët të diapazonit të dënimeve për këto krime në Kosovë. Gjykata e cilësoi si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri pranoi fajësinë, shprehu pendim dhe premtoi mospërsëritje. Rrethanat rënduese ishin fakti se i pandehuri ishte dënuar 17 herë më parë për dhunë në familje, frika që ua shkaktonte vajzave të tij dhe rrezikshmëria e veprës penale. Megjithatë, gjykata nuk e vlerësoi si rrethanë rënduese kryerjen e veprës penale ndaj fëmijëve.⁴⁰⁷

Shqyrtimi i aktgjykimeve vërtetoi se gjykatat jo gjithmonë e konstatuan si rrethanë rënduese dhunën ndaj ose në prani të fëmijëve, edhe pse kjo u konstatua si fakt në aktgjykime. Në gjithsej 28 raste (84.8%) gjykatat nuk e konsideruan si rrethanë rënduese faktin që i pandehuri ishte i dhunshëm në prani të apo ndaj fëmijëve.⁴⁰⁸ Prej tyre, në gjithsej 10 raste (30.3%) nuk u konsiderua si rrethanë rënduese që i pandehuri ishte i dhunshëm me fëmijët, por u konsiderua si rrethanë lehtësuese që i pandehuri kishte fëmijë.⁴⁰⁹ Kjo praktikë e dënimit bie ndesh me Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe me standardet përcaktuara në Konventën e Stambollit, të cilat, për shembull, këshillojnë gjykatat që ta konsiderojnë si faktor rëndues kur kur dhuna është kryer ndaj ose në prani të një fëmije.⁴¹⁰

Arsyetimi i pamjaftueshëm ose i munguar në aktgjykime duket të jetë çështje e kahershme, pasi një nga synimet e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të miratuar në vitin 2018 ishte të adresonte në mënyrë specifike këto zbrazëti dhe të jepte më shumë sqarime për vlerësimin e rrethanave individuale të varësisë së ndëshkimit.⁴¹¹

Kodi Penal i Kosovës lejon gjykatat të urdhërojnë kryesit t'u nënshtrohen programeve të rehabilitimit; megjithatë, programet për të punuar me kryesit e dhunës në familje ende nuk janë të disponueshme. Ministria e Drejtësisë njoftoi në maj 2023 se Programi Kombëtar për trajtimin e kryesve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore do të finalizohet në shtator 2023.⁴¹²

Kosova është e obliguar të marrë masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që veprat penale të përfshira në Konventën e Stambollit, përfshirë dhunën në familje, “të dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe shkurajuese, duke marrë parasysh seriozitetin e tyre”.⁴¹³ Sipas detyrimit për zellin e duhur, Kosova duhet të marrë të gjitha masat e duhura jo vetëm për të parandaluar dhe ndjekur penalisht, por edhe për të ndëshkuar akterët jostetërorë për veprimet ose mosveprimet e tyre që rezultojnë në dhunë me bazë gjinore ndaj grave. Dështimi ose mosshqiptimi i dënimeve që janë në përpjesëtim me peshën e këtyre veprave, “siguron leje të heshtur ose inkurajim për të kryer akte të dhunës me bazë gjinore ndaj grave” dhe përbën shkelje të të drejtave të njeriut.⁴¹⁴

10.3 DISA TË MBIJETUARA KONSIDEROHEN SI KRYESE TË DHUNËS NDAJ PARTNERIT INTIM

Mungesa e të kuptuarit të dhunës me bazë gjinore mund të bëjë që policia, prokurorët dhe gjyqtarët të keqidentifikojnë aktet e vetëmbrojtjes nga të mbijetuarat, duke çuar në arrestimin, ndjekjen penale dhe dënimin e tyre së bashku me dhunuesit e tyre. Kjo praktikë mund të ketë ndikim shkatërrues për të mbijetuarat në një kohë kur ato kanë më së shumti nevojë për mbështetje.

Amnesty International identifikoi gjashtë vendime të gjykatës për dhunë nga partneri intim në shqyrtimin e mostrës sistematike, në të cilat që të dy, kryesi dhe viktimja, u akuzuan dhe u shpallën fajtorë për vepra penale të lidhura me dhunën në familje.⁴¹⁵ Një analizë e rrethanave faktike në këto vendime sugjeron se viktimja e parë, e cila në të gjitha rastet e studiuara ishte grua, mund t'i jetë përgjigjur dhunës nga kryesi

⁴⁰⁷ Gjykata Themelore e Gjilanit, Aktgjykim, 2022. Specifikat e vendimit si numri i lëndës apo data nuk janë zbuluar këtu për të ruajtur privatësinë e viktimave, pasi që të tre emrat e viktimave janë zbuluar në aktgjykimin e publikuar në uebfaqen e gjykatës.

⁴⁰⁸ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.8 Dhuna që përfshin fëmijët, Tabela 20: Frekuenca e shqyrtimit të rrethanave rënduese gjatë shqiptimit të dënimit për të pandehurit.

⁴⁰⁹ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5.8 Dhuna që përfshin fëmijët.

⁴¹⁰ Konventa e Stambollit, Neni 56(d). Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 76.

⁴¹¹ Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për Politikën Ndëshkimore (i cituar më parë), faqe 4.

⁴¹² Ministria e Drejtësisë, “Haxhiu: Programi Kombëtar për krimet e kryesve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave do të finalizohet deri në shtator”, 10 maj 2023, md.rks-gov.net/page.aspx?id=1_15,3024, (qasur më 25 gusht 2023).

⁴¹³ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 45.

⁴¹⁴ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 24 (2 (b)).

⁴¹⁵ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.5 Viktimat që konsiderohen të pandehura.

fillestar në vetëmbrojtje. Megjithatë, vetëm një nga këto vendime e shqyrtoi dhe e hodhi poshtë këtë mundësi, ndërsa të tjerët as që e morën parasysh. Për shembull, në një rast të vendosur nga Gjykata Themelore në Prizren në vitin 2019, një person i njohur si E.K. sulmoi gruan e tij. “E ka goditur me grusht në fytyrë dhe e ka goditur me çadër në kokë” duke i shkaktuar lëndime, “ndërsa ajo ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin/të akuzuarin E.K. duke e gërvishur me thonj”. E.K. u shpall fajtor për dhunë në familje dhe lëndim të lehtë trupor dhe bashkëshortja e tij u shpall fajtoreshë për dhunë në familje dhe sulm. Të dy e pranuan fajësinë, u shpallën fajtoreshë dhe secili prej tyre mori dënim me kusht prej pesë muajsh. Gjykata nuk konstatoi rrethana rënduese me rastin e dënimit të E.K. edhe pse ishte ai që i pari e sulmoi gruan e tij dhe përdori një çadër për ta rrahur. Gjykata gjithashtu nuk dha ndonjë arsytim për shqiptimin e të njëjtit dënim për të dyja palët dhe nuk mori parasysh refuzimin e pranimit të fajësisë për shkak të vetëmbrojtjes.⁴¹⁶

Në tri nga gjashtë raste, viktimat dhe kryesit e pranuan fajësinë për akuzat. Megjithatë, kjo nuk i përjashtoi gjyqtarët nga përgjegjësia për të verifikuar se pranimi i fajësisë mbështetet nga faktet në aktakuzë dhe provat e paraqitura nga prokuroria dhe dëshmitë e dëshmitarëve apo të palëve të akuzuara.⁴¹⁷

Në dy vendime për dhunën ndaj partnerit intim të shqyrtuara nga Amnesty International, gjykata konstatoi, bazuar në faktet e paraqitura nga prokuroria në aktakuzë, se burri dhe gruaja “sulmuan njëri-tjetrin”. Në të dyja rastet kryesit i parë i listuar në vendim është burri.⁴¹⁸ Asnjë nga vendimet nuk jep asnjë justifikim se kush e filloi dhunën ose nuk merr parasysh kontekstin më të gjerë se kush ka fuqi në marrëdhënie, dhe si burrit ashtu edhe gruas u jepet i njëjti dënim. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kur edhe i dëmtuari ka kryer veprën penale ndaj të akuzuarit, duhet të mbahet një procedurë e përbashkët penale.⁴¹⁹

Organet e zbatimit të ligjit, prokuroria dhe gjykatat duhet ta kuptojnë aspektin gjinor gjinor të dhunës nga partneri intim dhe të njohin dinamikën e pushtetit dhe kontrollit të përdorur nga abuzuesit ndaj viktimave të tyre, duke përfshirë kur të mbijetuarat mund të kenë vepruar në vetëmbrojtje në kontekstin më të gjerë të dhunës së mëparshme.⁴²⁰ Një përpjekje e tillë për të ushtruar kontroll mund të jetë përdorimi i policisë dhe kallëzimet penale nga kryesit për të frikësuar partneren ose ish-partneren.⁴²¹ “Edona”, e mbijetuar nga Drenasi, i tha Amnesty International se ish-bashkëshorti dhe vjehëri i saj, kundër të cilëve ajo kishte urdhër mbrojtës gjyqësor aktiv që i pengonte ta kontaktonin drejtpërdrejt ose t'i afrosheshin, e raportuan atë për dhunë në familje në polici shumë herë. Zyrtarët policorë vinin në shtëpinë e saj dhe i kërkonin të shkonte në stacion për të dhënë deklaratë. “I thashë policit, zotnija që të ka thirrë ty ka ndalesë 10 metra ngat s’mundet me mu afru.” Me sa kishte dijeni “Edona”, ndaj saj nuk u ngrit asnjë akuzë zyrtare, por ajo tha se ndihej e ngacmuar.⁴²²

Luljeta Aliu, e mbijetuar e dhunës në familje e cila po drejtonte një OJQ që ofron ndihmë juridike falas për të mbijetuarat, tha për Amnesty International: “Kemi pasur disa raste kur të mbijetuarat e dhunës në familje janë akuzuar në mënyrë të rreme për dhunë në familje qoftë nga bashkëshortët e tyre ose nga vjehërit e tyre. Kjo është strategji e përdorur nga kryesit për të minuar pozitën e viktimave të tyre”.⁴²³

Të mbijetuarat e dhunës në familje të cilat janë akuzuar vetë për vepra të lidhura me dhunën në familje mund të përballen me paragjykime dhe mosbesim nga institucionet shtetërore dhe vështirësi të tjera drejt qasjes në drejtësi. Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave ka refuzuar të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtës në emër të një të mbijetuar kundër bashkëshortit të saj, për shkak se ndaj saj ka pasur raportim për dhunë në familje nga vjehërra. “Punësuam një avokat që kërkoi urdhër mbrojtës direkt nga gjykata dhe iu miratua [...] Akuzat për dhunë në familje të bëra nga vjehërra u hodhën poshtë nga gjykata për mungesë provash”, tha për Amnesty International Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës.⁴²⁴

Një hulumtim i mëparshëm nga Amnesty International për dhunën ndaj partnerit intim në kontekstin e një vendi tjetër tregon se të mbijetuarat e dhunës në familje të cilat thërresin policinë për ndihmë dhe arrestohen vetë për dhunë në familje ose vepra të tjera penale, mund të frenohen nga raportimi në polici në

⁴¹⁶ Gjykata Themelore e Prizrenit, *Aktgjykimi P. nr. 1137/19*, 7 nëntor 2019.

⁴¹⁷ Kodi i Procedurës Penale, Neni 242.

⁴¹⁸ Gjykata Themelore e Prishtinës, *Aktgjykimi P.nr.4585/2017*, 4 janar 2018; Gjykata Themelore e Pejës, *Aktgjykimi P.nr.848/19*, 11 qershor 2020.

⁴¹⁹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 35(2).

⁴²⁰ KE, Mjet Burimor Trajnimi për Prokurorët dhe Gjyqtarët në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (i cituar më parë), faqe 24.

⁴²¹ Shih Amnesty International, i fragmentuar dhe i pabarabartë: Një sistem drejtësie që dështon të mbijetuarit e dhunës nga partneri intim në Luiziana, SHBA (Indeksi: AMR 51/1160/2019), 24 tetor 2019, [amnesty.org/en/documents/amr51/1160/2019/en/](https://www.amnesty.org/en/documents/amr51/1160/2019/en/) (qasur më 25 gusht 2023), faqe 11.

⁴²² Intervistë me “Edonën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

⁴²³ Intervistë me Luljeta Aliun, maj 2022.

⁴²⁴ Intervistë me Adelina Berishën, 1 qershor 2022.

të ardhmen.⁴²⁵ Mjeti i trajnimit të KE-së për gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë i këshillon që të kërkojnë prova të mundshme që mund të përfshijnë fotografi të lëndimeve të të dyshuarit, si p.sh. "lëndime sulmuese ose lëndime të shkaktuara në vetëmbrojtje nga viktimat". Kjo mund të jetë një mënyrë legjitime për të vërtetuar nëse ekziston rast i vetëmbrojtjes dhe për të përcaktuar fajësinë e kryesit.⁴²⁶

Akademia e Drejtësisë e Kosovës duhet të sigurojë që forcat e rendit, prokurorët dhe gjyqtarët të trajnohen dhe të pajisen për të trajtuar rastet e dhunës nga partneri intim ose dhunës ndaj grave në familje dhe të jenë në gjendje të identifikojnë përdorimin e vetëmbrojtjes në mënyrë që të minimizohet arrestimi i dyfishtë ose i gabuar i viktimave. Zyrtarëve të zbatimit të ligjit duhet t'u kërkohet të japin shpjegim të detajuar për çdo arrestim të dyfishtë në rastet e dhunës në familje dhe të ofrojnë prova të qarta që mbështesin arrestimin e të dy partnerëve. Raporti duhet të shqyrtohet nga një epuror/e përpara se të shkojë në prokurori. Prokurorët duhet të shqyrtojnë me kujdes kallëzimet penale nga policia në raste të tilla dhe të shqyrtojnë nëse mund të ketë pasur përdorim të vetëmbrojtjes.

Gjykatat duhet të shqyrtojnë me kujdes faktet dhe provat në rastet e dhunës nga partneri intim dhe të shqyrtojnë aktakuzat edhe në rastet kur të dyja palët pranojnë fajësinë. Ata duhet të vlerësojnë me kujdes nëse aktet e dhunshme të kryera si përgjigje ndaj dhunës përbëjnë vetëmbrojtje, duke marrë parasysh siç duhet dinamikën e pushtetit të bazuar në gjini dhe ndërthurjet e tyre me pabarazitë e tjera ndërmjet partnerëve intimë. Gjykatat, prokuroria dhe policia duhet të mbledhin dhe publikojnë të dhëna për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet të arrestuarve.

10.4 AKTGJYKIMET ZBULOJNË EMRAT E VIKTIMAVE DUKE SHKELUR TË DREJTËN E TYRE PËR PRIVATËSI

Shqyrtimi i vendimeve të Amnesty International tregoi se gjykatat kanë bërë publike informatat personale identifikuese të viktimave ose kryesve në 13.2% të vendimeve që janë të disponueshme në faqet e internetit të gjykatave.⁴²⁷

Publikimi i të dhënave personale të viktimave të dhunës në familje është shkelje e të drejtës së tyre për privatësi. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe gjykatat duhet të shqyrtojnë me rigorozitet të gjitha vendimet e publikuara dhe të heqin të dhënat personale apo informata të tjera që i bëjnë viktimat të identifikueshme, siç janë emri i kryesit, numri i telefonit dhe informata të tjera identifikuese indirekte.

10.5 NDRYSHIMET E PROPOZUARA NË KODIN PENAL DHE KODIN E PROCEDURËS PENALE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Amnesty International është e shqetësuar se disa ndryshime të propozuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale⁴²⁸ në lidhje me trajtimin e kryesve të dyshuar të dhunës në familje, sulmeve seksuale dhe përdhunimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, ndryshimet do t'i detyrojnë gjykatat të urdhërojnë paraburgim për çdo kryes të dyshuar të dhunës në familje ose përdhunimit pa zbatuar asnjë kriter për dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, dhe gjykimet në rastet e përdhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje do të publikohen duke zbuluar emrat e plotë të kryesve, duke zbuluar në mënyrë indirekte edhe identitetin e viktimave.

Një raport nga OJQ-ja Instituti i Kosovës për Drejtësi i kritikoi ndryshimet e propozuara si "masa represive" në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, KEDNJ-në dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Më tej kritikoi vendimin e qeverisë për të mos kryer konsultime publike duke argumentuar se kjo shkel Konventën e

⁴²⁵ Amnesty International, I fragmentuar dhe i pabarabartë: Një sistem drejtësie që dështon të mbijetojë dhe dhunës nga partneri intim në Luiziana (i cituar më parë), faqe 70.

⁴²⁶ KE, Mjet Burimor Trajnimi për Prokurorët dhe Gjyqtarët në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (i cituar më parë), faqe 52.

⁴²⁷ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.6 Privatësia.

⁴²⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, Projektligji Nr.X/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale Nr.08/L-032, kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperndryshimineKoditprocedurespenale_AX8qBt4nqH.pdf (qasur më 25 gusht 2023).

Stambollit, e cila kërkon që Kosova të ndërmarrë masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të adresuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me politika gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara, me të gjithë akterët përkatës, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.⁴²⁹ Në përgjigje të korrespondencës rreth kërkesës zyrtare të Amnesty International për informata, Ministria e Drejtësisë tha se “amendamentet e propozuara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale janë modifikuar ndërmjet leximeve nga grupi punues në Kuvend [...] dhe se trajtimi i kryesve të dyshuar të dhunës në familje, sulmeve seksuale dhe përdhunimeve është [tani] në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”.⁴³⁰ Në kohën e shkrimit, të dy projektligjet për ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale ishin në pritje në Kuvendin e Kosovës.

Amnesty International u kërkon autoriteteve të Kosovës të përfshijnë organizatat e shoqërisë civile dhe të mbijetuarat e dhunës në familje në procesin e zhvillimit të masave të nevojshme legislative ose masave të tjera për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Çdo ndryshim në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

10.6 DËMSHPËRBLIMI PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE POTHUAJSE JOEKZISTENT

Të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë përballen me shumë pengesa në qasjen në dëmshpërblime për dëmin e pësuar. Edhe pse korniza ligjore e Kosovës u ofron të mbijetuarave rrugë për të kërkuar kompensim dëmi nga dhunuesi ose nga shteti, hulumtimi i Amnesty International tregon se, në praktikë, kompensimi për të mbijetuarat e dhunës në familje mbetet i pakapshëm për shkak të moszbatimit të ligjit dhe mungesës së informatave për të mbijetuarat.

10.6.1 ASNJË DËMSHPËRBLIM PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS NË FAMILJE NGA GJYKATAT PENALE

Personat që pësojnë dëme nga veprat penale, duke përfshirë të mbijetuarat e dhunës në familje, mund të kërkojnë kompensim dëmi nga kryesit brenda procedurës gjyqësore penale ose përmes një padie të veçantë në procedurë gjyqësore civile.⁴³¹ Gjykatat mund të urdhërojnë kryesit e shpallur fajtorë t'u paguajnë dëmshpërblim viktimave për dëmin financiar, fizik dhe emocional të shkaktuar nga vepra penale.⁴³² Pavarësisht kësaj baze ligjore dhe numrit të ulët të kërkesave për kompensim (vetëm 13 (5.1%) nga 255 të mbijetuara kërkuan kompensim),⁴³³ gjykatat nuk dhanë kompensim në asnjë nga 197 vendimet e mostrës së aktgjykimeve penale të dhunës në familje të shqyrtuara për këtë raport. Gjithsej 146 të mbijetuara (57.3%) thanë se nuk duan kompensim dhe për 96 të mbijetuara nuk ka asnjë informatë në vendimet e gjykatës.⁴³⁴

Gjykatat mund t'i referojnë viktimat në procedurë gjyqësore civile ose të paraqesin kërkesë në Programin për Kompensimin e Viktimave nëse vendimmarrja për kërkesat e tyre për kompensim do të “zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme” ose kur “të dhënat e mbledhura në procedurën penale nuk ofrojnë bazë të sigurtë për gjykim të plotë ose të pjesshërishëm”.⁴³⁵ Nga shqyrtimi i vendimeve u zbulua se gjykatat i

⁴²⁹ Instituti i Kosovës për Drejtësi, “Masa represive për mbrojtjen e gruas (analizë e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale)”, nëntor 2022, kli-ks.org/masat-represive-per-mbrojtjen-e-varrr/, (qasur më 25 gusht 2023), faqe 5.

⁴³⁰ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Përgjigje Zyrtare ndaj gjetjeve të hulumtimit të Amnesty International mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarat e dhunës në familje, 22 gusht 2023. Në dosje të Amnesty International.

⁴³¹ Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828 (qasur më 25 gusht 2023), Nenet 169-189. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>, (qasur më 25 gusht 2023). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>, (qasur më 25 gusht 2023).

⁴³² Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032 (i cituar më parë), Nenet 63(19) dhe 457-462.

⁴³³ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.4 Kërkesat për kompensim të dëmit.

⁴³⁴ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.4 Kërkesat për kompensim të dëmit, Tabela 10: Shpërndarja e informacata për viktimat që kërkojnë kompensim të dëmit.

⁴³⁵ Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032, (i cituar më parë), Nenet 457(1) dhe 462(2).

referuan të mbijetuarat në procese civile në 119 aktgjykime (54.6%).⁴³⁶ Megjithatë, pothuajse në të gjitha rastet, gjykatat nuk dhanë arsye për mosmarrjen e vendimit për kërkesën për kompensim. Gjykatat shtjelluan arsyet e referimit vetëm në 3 nga 13 raste (23.1%) ku kishte kërkesë për kompensim.⁴³⁷

Sipas Rrjetit të Grave të Kosovës, viktimat shpesh nuk janë të vetëdijshme për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim në procedurë penale pasi mbrojtësit e viktimave zakonisht nuk i informojnë për këtë mundësi, përkundër obligimit të tyre për ta bërë këtë.⁴³⁸

Të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë duhet të kalojnë nëpër procese të shumta, stresuese, të mundimshme, të kushtueshme dhe shpesh të gjata gjyqësore, duke përfshirë marrjen e urdhrave mbrojtës, kujdestarinë e fëmijëve, shkurorëzimin, ndarjen e pronës dhe procedurat gjyqësore penale. Referimi i tyre në proceset gjyqësore civile për të kërkuar kompensimin e dëmit shton një hap tjetër, i cili e bën kërkimin e drejtësisë dhe kompensimit më të rëndë dhe të shtrenjtë për viktimat. Sipas Ariana Qosaj-Mustafës, eksperte gjinore e cila ka punuar në fushën e dhunës në familje në Kosovë, të mbijetuarat rrallë vendosin të kërkojnë kompensim përmes proceseve gjyqësore civile: “Në rastet që kam monitoruar, asnjë nga të mbijetuarat nuk ka ndjekur procedurë gjyqësore civile. Ato dekurajohen ta fillojnë një proces tjetër.” Ajo e përshkroi dështimin për t’i përdorur dispozitat ligjore që lejojnë kompensimin në procedurë penale si “mundësi e humbur”.⁴³⁹ Nga 20 të mbijetuarat të intervistuar nga Amnesty International, vetëm dy thanë se po planifikonin të fillonin proces gjyqësor civil kundër abuzuesve të tyre për të kërkuar kompensimin e dëmit.⁴⁴⁰

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kërkon që Kosova të sigurojë dëmshpërblim për aktet e dhunës me bazë gjinore të kryera nga akterët joshitetërorë.⁴⁴¹ Dëmshpërblimi duhet të jetë në kohë, gjithëpërfshirës dhe në përpjesëtim me peshën e dëmit.⁴⁴² Praktikrat që vendosin përgjegjësinë mbi viktimën për të kërkuar kompensim përmes gjykatave civile mund të rezultojnë në vonesa, kosto shtesë dhe nevojën për të dëshmuar përsëri dhe për t’u përballur me të pandehurin, gjë që mund të jetë barrierë drejt ndjekjes së veprimeve ligjore.⁴⁴³ GREVIO ka theksuar se autoritetet duhet të përdorin opsionet ligjore në dispozicion për të shqiptuar kompensimin e dëmit në kuadër të procedurës penale.⁴⁴⁴

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Parandalimin e Dhunës në Familje identifikon si parim kyç që “[ligjet] duhet të lejojnë që dënimet penale të përfshijnë një urdhër kompensimi dhe kthimi nga dhunuesi te viktimat ose trashëgimtarët/ët e saj”.⁴⁴⁵ Megjithatë, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës tashmë lejon që urdhrat për kompensim të lëshohen brenda procedurës penale.⁴⁴⁶ Gjetjet e këtij raporti tregojnë se shkaku kryesor i mosdhënies së dëmshpërblimit në procedurë penale është moszbatimi i dispozitave ekzistuese ligjore. Kjo praktikë gjyqësore po i pengon të mbijetuarat të kërkojnë të drejtat e tyre dhe po pengon fuqizimin e tyre për t’u larguar nga situatat abuzive.

Autoritetet e Kosovës duhet të marrin masa të mëtejme për të garantuar qasjen në kompensim për të mbijetuarat e dhunës në familje, në veçanti duke siguruar që gjykatat të përdorin legjislacionin ekzistues për të dhënë kompensim në procedurë gjyqësore penale. Për më shumë, mbrojtësit e viktimave duhet të marrin trajnime shtesë për të informuar dhe ndihmuar më mirë viktimat e dhunës në familje në kërkimin e kompensimit brenda procedurës penale.

⁴³⁶ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.4 Kërkesat për kompensim të dëmit.

⁴³⁷ Gjykatat shqyrtuan kërkesat për kompensim të tre viktimave, që ishte 23.1% i të gjitha viktimave që kishin kërkuar kompensim dëmi.

⁴³⁸ Rrjeti i Grave të Kosovës, “Nga ligjet në veprim – Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë”, 7 maj 2021, womensnetwork.org/publications/from-laws-to-action-2/ (qasur më 25 gusht 2023), faqe 869.

⁴³⁹ Amnesty International, Intervistë përmes një video-telefonate me Dr. Ariana Qosaj Mustafa, qershor 2022.

⁴⁴⁰ Amnesty International, Intervista me të mbijetuarat e dhunës në familje, gusht-dhjetor 2022.

⁴⁴¹ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 5(2).

⁴⁴² Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Nenet 5(2) dhe 30. Parimet dhe udhëzimet themelore mbi të drejtën për një mjet juridik dhe dëmshpërblim (e cituar më parë); Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 33 (b); Raporti i Raportuesit Special për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj, 2010, OKB Doc. A/HRC/14/22, para. 12-85.

⁴⁴³ KE, *Vlerësimi i përafërimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 178.

⁴⁴⁴ KE, *Vlerësimi i përafërimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë).

⁴⁴⁵ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 36.

⁴⁴⁶ Kodi Penal i Kosovës, Neni 59(2.2); Kodi i Procedurës Penale, Neni 63(1.19).

10.6.2 VËSHIRËSI NË MARRJEN E DËMSPËRBLIMEVE NGA FONDI PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE

Të mbijetuarat e dhunës në familje që kërkojnë dëmshpërblim nga dhunuesi në procedurë penale dhe nuk e marrin atë, mund të kërkojnë dëmshpërblim nga shteti për dëmin psikologjik dhe fizik të pësuar nga vepra penale.⁴⁴⁷ Megjithatë, gjetjet e Amnesty International tregojnë se të mbijetuarat rrallë marrin kompensim shtetëror, kryesisht për shkak të mungesës së qasjes në informata dhe vështirësive në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim.⁴⁴⁸

I themeluar në vitin 2015, Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve i drejtuar nga qeveria është i mandatuar të japë kompensim për viktimat dhe vartësit e tyre për vepra penale që shkaktojnë lëndime të rënda trupore, dëmtime psikologjike ose vdekje.⁴⁴⁹ Ekzistojnë dy lloje të kompensimit në dispozicion. Viktimat që mbështeten në mbështetje sociale ose përballesh me vështirësi të tjera financiare mund të aplikojnë për kompensim të menjëhershëm deri në 3,000 euro dhe mbulim të shpenzimeve për trajtimin e dëmtimit fizik dhe psikologjik.⁴⁵⁰ Kompensimi i rregullt është i disponueshëm për viktimat pasi të kenë marrë aktgjykimin e formës së prerë në procedurë penale dhe nëse kanë kërkuar kompensim por nuk e kanë marrë atë ose mund të dëshmojnë se nuk kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesë.⁴⁵¹ Kompensimi i rregullt që mbulon dëmtimin fizik dhe psikologjik normalisht kufizohet në 5,000 euro.⁴⁵² Përfundimisht, Komisioni i Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimeve mund të japë kompensim deri në 10,000 euro.⁴⁵³

Ligji i vitit 2022 për Kompensimin e Viktimave të Krimeve zgjati afatin kohor brenda të cilit viktimat mund të aplikojnë për kompensim⁴⁵⁴ dhe lejoi qasjen në kompensim të menjëhershëm për viktimat e dhunës në familje.⁴⁵⁵

Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, donacione dhe kontribute vullnetare nga kryesit e krimeve të dhunshme të cilët shpallen fajtorë dhe urdhërohen nga gjykatat t'i paguajnë fondit një shumë simbolike.⁴⁵⁶ Shumica e të pandehurve, 181 (83%) në aktgjykimet e shqyrtuara, u urdhëruan të bëjnë një pagesë në fond, zakonisht në shumën prej 30 eurosh.⁴⁵⁷ Megjithatë, vetëm 13 të mbijetuar (5.1%) kërkuar kompensim të dëmit nga gjykata dhe asnjë nga kërkesat e tyre nuk u pranua dhe në vend të kësaj ata u referuan në procedurën civile për kompensim.⁴⁵⁸

Numri i të mbijetuarave të dhunës në familje që marrin kompensim nga fondi mbetet i ulët. Të dhënat e qeverisë tregojnë se, në pesë vitet e fundit, vetëm 50 të mbijetuara të dhunës në familje kanë aplikuar në fond dhe vetëm 26 kanë marrë dëmshpërblim prej tij. Shumat e shpërblyera varionin nga 178 euro deri në 6,290 euro.⁴⁵⁹

Një nga faktorët që ndikon në normat e ulëta të kompensimit për viktimat e dhunës në familje mund të jetë mungesa e informatave mbi të drejtat e tyre dhe procesi i kërkimit të dëmshpërblimit. Sipas një zyrtari të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimeve, viktimat nuk janë në dijeni se duke mos kërkuar dëmshpërblim në procedurën penale, humbasin të drejtën për dëmshpërblim nga fondi. Shumë aplikime refuzohen sepse nuk e plotësojnë këtë kusht. Siç u përshkrua, vetëm 5% e të mbijetuarave të identifikuar nga Amnesty International nga vendimet e gjykatave do të kualifikoheshin për të aplikuar për kompensim

⁴⁴⁷ Ligji Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, 2 nëntor 2022, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66178>, (qasur më 25 gusht 2023), Neni 9(3).

⁴⁴⁸ Amnesty International, Intervistë me Adelina Berishën, qershor 2022; Informata nga një zyrtar nga Fondi i Kompensimit të Viktimave, Shkurt 2023.

⁴⁴⁹ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit (i cituar më parë).

⁴⁵⁰ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 8 (3).

⁴⁵¹ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Nenet 8 dhe 9.

⁴⁵² Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 11 (4).

⁴⁵³ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 11 (5).

⁴⁵⁴ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 29 (1-2).

⁴⁵⁵ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 8 (1.4).

⁴⁵⁶ Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Neni 36 (1-3).

⁴⁵⁷ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.5 Dënimi, Tabela 17: Shpërndarja e shpeshtësisë së urdhrave ndërmjet të pandehurve.

⁴⁵⁸ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.4 Kërkesat për kompensim të dëmit.

⁴⁵⁹ Amnesty International, Përgjigje zyrtare nga Ministria e Drejtësisë ndaj një kërkesë për informata nga Amnesty International, 21 shkurt 2023.

nga fondi.⁴⁶⁰ Po ashtu, viktimat nuk kanë njohuri se duhet t'i ruajnë faturat për të kërkuar kompensim për shpenzimet mjekësore.⁴⁶¹

Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës argumenton se mbrojtësit e viktimave shpesh nuk i informojnë të mbijetuarat e dhunës në familje për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim: “Si rezultat, shumica e grave nuk janë në gjendje ta shfrytëzojnë këtë mundësi”.⁴⁶² Raporti i KE/GREVIIO thekson gjithashtu mungesën e informatave për të mbijetuarat dhe vështirësitë në sigurimin e dokumenteve si pengesa të mundshme për marrjen e kompensimit nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve.⁴⁶³

Sipas Konventës së Stambollit, Kosova është përgjegjëse për sigurimin e kompensimit adekuat shtetëror për “ato që kanë pësuar lëndime të rënda trupore ose dëmtime të shëndetit, në masën që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera”, brenda një afati të arsyeshem.⁴⁶⁴ Përveç kësaj, Kosova duhet të marrë masa për të siguruar që viktimat të marrin “informata adekuate dhe me kohë mbi shërbimet mbështetëse në dispozicion dhe masat ligjore në një gjuhë që ato e kuptojnë”.⁴⁶⁵ GREVIIO rekomandoi që autoritetet e Kosovës të sigurojnë që “viktimat të informohen sistematikisht për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim dhe për procedurat që duhen ndjekur”.⁴⁶⁶

Në Strategjinë e vet Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2022-2026), Qeveria e Kosovës është zotuar që të informojë publikun rreth Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Megjithatë, strategjia ndan gjithsej vetëm 7,000 euro për këtë qëllim përgjatë viteve 2022 dhe 2023.⁴⁶⁷ Programi deri më tani është promovuar vetëm gjatë fushatës së 16 ditëve të aktivizimit.⁴⁶⁸

Kodi i ri i Procedurës Penale i shkurtit 2023 përfshin një zhvillim pozitiv duke i detyruar gjykatat të informojnë viktimat se nëse nuk kërkojnë dëmshpërblim në procedurë penale, humbasin të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve.⁴⁶⁹ Sidoqoftë, duke marrë parasysh numrin e ulët të të mbijetuarave të dhunës në familje që marrin kompensim nga fondi, nevojiten përpjekje më të vazhdueshme për të siguruar që të mbijetuarat e dhunës në familje të jenë të informuara për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim dhe për procedurat që duhet të ndjekin.

Autoritetet e Kosovës duhet të zhvillojnë dhe shpërndajnë informata të qasshme mbi Fondin e Kompensimit të Viktimave për të mbijetuarat e dhunës në familje, në një gjuhë dhe format që ato e kuptojnë, dhe të sigurojnë që mbrojtësit e viktimave, prokurorët dhe gjykatat të informojnë të gjitha viktimat për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim dhe për procesin e aplikimit.

Për më shumë, një dispozitë ligjore që ishte e rëndësishme për sigurimin e dëmshpërblimit të viktimave të krimeve, duke përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje, u hoq tërësisht nga Kodi Penal i kaluar. Më parë, në rastet kur gjykata nuk mund të urdhëronte dëmshpërblimin drejtpërdrejt nga i pandehuri fajtor, gjykata mund t'i jepte urdhër për dëmshpërblim drejtpërdrejt koordinatorit të Fondit të Kompensimit të Viktimave.⁴⁷⁰ Kjo procedurë e shfuqizuar tashmë e bënte më të lehtë marrjen e dëmshpërblimit për viktimat e krimeve dhe ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rekomandimet nga GREVIIO.⁴⁷¹ Autoritetet e Kosovës duhet të ndryshojnë Kodin e ri të Procedurës Penale në mënyrë që gjykatat të mund të urdhërojnë Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimeve drejtpërdrejt të paguajë dëmshpërblimet për viktimat e krimeve në rastet kur kryesit nuk janë në gjendje të paguajnë. Zyrtarët për mbrojtjen e viktimave duhet t'i nënshtrohen trajnimit për të ndihmuar më mirë të mbijetuarat e dhunës në familje dhe viktimat e tjera të krimeve që të përdorin të gjitha rrugët ligjore në dispozicion për të ushtruar të drejtën e tyre për kompensim.

⁴⁶⁰ Shtojca e raportit të Amnesty International (EUR 73/7124/2023), shih seksionin B.1.4 Kërkesat për kompensim të dëmit.

⁴⁶¹ Amnesty International, Informata nga një zyrtar në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimeve (i cituar më parë).

⁴⁶² Amnesty International, Intervistë me Adelina Berishën, 1 qershor 2022.

⁴⁶³ KE, *Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 179.

⁴⁶⁴ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 30(2-3).

⁴⁶⁵ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 19.

⁴⁶⁶ KE, *Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë), para. 183.

⁴⁶⁷ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (e cituar më parë), faqe 98.

⁴⁶⁸ Ministria e Drejtësisë, Raport Vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, mars 2023.

⁴⁶⁹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 459(4).

⁴⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale tashmë i shfuqizuar 04/L-123 ishte i zbatueshëm deri në shkurt 2023; shih gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861, Neni 62(1.5)(qasur më 25 gusht 2023), Neni 62(1.5).

⁴⁷¹ KE, *Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit* (i cituar më parë).

PARANDALIMI

Qeveria e Kosovës nuk duket se i priorizon sa duhet masat për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.⁴⁷² Megjithëse qeveria ka nisur fushata për ndërgjegjësim të publikut, nuk ka masa apo politika për të adresuar faktorët strukturorë që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore dhe ka pasur përparim minimal në rishikimin e teksteve shkollore për të përfshirë arsimin e bazuar në të drejta.

Janë bërë disa përpjekje për të kryer fushata ndërgjegjësuere, veçanërisht përmes ligjëratave në shkolla fillore dhe të mesme nga Policia e Kosovës dhe shpërndarjes së fletushkave dhe mesazheve për ndërgjegjësimin e publikut.⁴⁷³ Megjithatë, qeveria ka dështuar të zbatojë disa nga masat kryesore parandaluese të përfshira në Strategjinë e vet Kombëtare, duke përfshirë aktivitetet që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave midis grupeve të cënueshme të grave dhe vajzave.

Tekstet shkollore ende përhapin stereotipe gjinore përmes deklaratave të pasakta për burrat dhe gratë, seksualitetin dhe identitetin gjinor.⁴⁷⁴ Një raport i vitit 2017 nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) që analizon tekstet shkollore të nivelit të mesëm në Kosovë gjeti mbi 100 raste të gjuhës diskriminuese dhe përjashtuese, kryesisht në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor.⁴⁷⁵

Një shembull i tillë është teksti standard i psikologjisë për nxënësit e shkollave të mesme 17-18 vjeç *Psikologjia 11* – i cili ishte ende në shitje nëpër librari në Prishtinë në qershor të vitit 2023. Libri përmban formulime të tilla si: “dy trutë janë të lidhur ndryshe: truri i mashkullit për të bërë dhe truri i femrës për të folur”, si dhe “truri i diferencuar i mashkullit e ka më të lehtë të përballlet me disa detyra njëkohësisht, të tilla si të folurit ndërsa ndërton diçka”.⁴⁷⁶ Një pjesë tjetër thotë: “ne e dimë se cikli menstrual mund të ndikojë në performancën matematikore dhe verbale të grave”⁴⁷⁷ dhe “është e zakonshme që [burrat] janë konkurrues, dominues dhe këmbëngulës. Për gratë, është e zakonshme që të jenë ankioze, të dëshpëruara, të kenë vetëbesim të ulët dhe të jenë verbalisht agresive në mënyrë indirekte (për shembull, ato përhapin thashetheme të paqena)”.⁴⁷⁸ Në kapitullin mbi “çrregullimet seksuale” thuhet: “Fetishizmi transvestit lidhet me gjetjen e kënaqësisë seksuale përmes veshjes si seksi i kundërt”.⁴⁷⁹

⁴⁷² Amnesty International, Intervistë online me Marigona Shabiun, drejtoreshë në Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, maj 2022; Intervistë me Kadri Gashin, drejtor në OJQ SIT, gusht 2022; Intervistë me Zana Hamitin, drejtoreshë e strehimores në Prishtinë, maj dhe gusht 2022.

⁴⁷³ Ministria e Drejtësisë, Raport Vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (i cituar më parë), faqe 16.

⁴⁷⁴ YIHR, Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore – Një analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë, nëntor 2017, faqe 9; Amnesty International, Intervistë online me Marigona Shabiun, maj 2022.

⁴⁷⁵ YIHR, Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore – Një analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë, nëntor 2017, faqe 9.

⁴⁷⁶ Pajazit Nushi, Neki Juniku dhe Dashamir Bërçulli, *Psikologjia 11*, 2017, faqe 80. Shih gjithashtu: YIHR, *Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore – Një analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë* (i cituar më parë), faqe 14; Kosovo 2.0, “Koha për rishikim të teksteve shkollore”, janar 2018, [kosovotwopointzero.com/en/time-review-textbooks/](https://www.kosovotwopointzero.com/en/time-review-textbooks/) (qasur më 25 gusht 2023). Një shitës ua konfirmoi studiuesve të Amnesty International se libri është ende duke u blerë dhe përdorur në shkolla.

⁴⁷⁷ *Psikologjia 11* (e cituar më parë), faqe 78. Shih gjithashtu: YIHR, *Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore – Një analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë* (i cituar më parë), faqe 15.

⁴⁷⁸ *Psikologjia 11* (e cituar më parë), faqe 82.

⁴⁷⁹ *Psikologjia 11* (e cituar më parë), faqe 85.

Formulime të tilla të pabaza dhe shkencërisht të pasakta propagandojnë stereotipe të dëmshme negative për rolet gjinore dhe personat transgjinorë dhe përforcojnë idetë e dëmshme për inferioritetin e grave dhe paragjykimet ndaj transgjinorëve, të cilat janë shkaqet rrënjësore të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe individëve LGBTI. Sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën e Stambollit, Kosova është e detyruar të marrë masa për të “promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me qëllim të zhdukjes së paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të gruas ose në rolet e stereotipizuara për gratë dhe burrat”.⁴⁸⁰

Komunitetet rom, ashkali dhe kosovaro-egjiptian po përballen me nivele më të larta të pabarazisë strukturore, varfërisë, nivele të ulëta të arsimit dhe papunësisë sesa popullsia shumicë. Në një kontekst ku këto komunitete përjetojnë nivele të larta të marginalizimit, të mbijetuarat e dhunës në familje në këto komunitete priren të mos raportojnë në polici dhunën, përfshirë dhunën në familje, për shkak të mungesës së përgjithshme të besimit në institucionet shtetërore të Kosovës, varësisë ekonomike nga dhunuesit e tyre dhe paragjykimet nga komuniteti ndaj grave që denoncojnë burrat e tyre. Mungojnë po ashtu përpjekjet e mjaftueshme shtetërore për t’ua shtrirë dorën këtyre të mbijetuarave dhe për t’iu ofruar informata mbi shërbimet dhe mbështetjen e disponueshme, lëre më për të dizajnuar ndonjë shërbim të përshtatur për nevojat e tyre specifike.⁴⁸¹ Në krahasim me shumicën e popullsisë, martesat e fëmijëve, të hershme dhe të detyruara janë më të përhapura në komunitetet rom, ashkali dhe kosovaro-egjiptian.⁴⁸²

Përkundër urgjencës së situatës, një zotim tjetër që qeveria dështoi ta përmbushte në vitin 2022 ishte organizimi i “një fushate ndërgjegjësuese për prindërit për të parandaluar martesat e hershme”.⁴⁸³

Neni 13 i Konventës së Stambollit i detyron shtetet të kryejnë fushata edukative për të “ritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e publikut të gjerë për manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës” dhe të japin “informata mbi masat e disponueshme për të parandaluar aktet e dhunës”. Komiteti CEDAW rekomandon që shtetet duhet të ofrojnë gjithashtu “edukim seksual gjithëpërfshirës, të përshtatshëm për moshën, të bazuar në të dhëna dhe shkencërisht të saktë për vajzat dhe djemtë”, dhe “të shënjestrojnë rolet e stereotipizuara gjinore dhe të promovojnë vlerat e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë maskulinitetet jo të dhunshme” përmes “[i]ntegrimit të përmbajtjes mbi barazinë gjinore në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit, si publik ashtu edhe privat, që nga fëmijëria e hershme e në vijim dhe në programet e edukimit me qasje të të drejtave të njeriut”.⁴⁸⁴ Përfundimisht, shtetet duhet t’i inkurajojnë “mediat për të eliminuar diskriminimin ndaj grave, duke përfshirë portretizimin e dëmshëm dhe stereotipik të grave ose grupeve specifike të grave, si gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut”.⁴⁸⁵

⁴⁸⁰ Konventa e Stambollit (e cituar më parë), Neni 12.

⁴⁸¹ Amnesty International, Intervistë online me Shpresa Agushin, drejtore e Rrjetit Kosovar për Gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane, shtator 2022; Intervistë me Qendresa Ademin, deputete e Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, nëntor 2022.

⁴⁸² Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2022* (i cituar më parë), faqe 41.

⁴⁸³ Ministria e Drejtësisë, *Raport Vjetor mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave* (i cituar më parë), faqe 20.

⁴⁸⁴ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 30 (b) (i).

⁴⁸⁵ Komiteti CEDAW, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 (i cituar më parë), para. 30 (d).

NË FJALËT E VETË ATYRE

Amnesty International pyeti të mbijetuarat e dhunës në familje se çfarë duhet të ndryshojë në mënyrën se si autoritetet i trajtojnë rastet e dhunës në familje. Shumë të mbijetuara thanë se shteti duhet të bëjë më shumë për t'i informuar të mbijetuarat për të drejtat e tyre dhe shërbimet e disponueshme mbështetëse shtetërore për t'u larguar nga situatat e abuzimit në familje. Ato gjithashtu theksuan nevojën që zyrtarët shtetërorë të kenë një qasje më humane dhe profesionale ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje.

“Ana” nga Prishtina: “Çka mujn me ba institucionet është me i informu gratë, hala pa ndodhë diçka, që nëse të ndodhë diçka, e ki derën çelë edhe e ki mbështetje e shtetit. Nuk ki nevojë me u shqetësu se ku ki me shku... nëse don me u mshefë, mshefësh, nëse don ni kohë me metë pa punë për ni kohë, munësh... edhe nëse familja nuk të përkrahë, edhe nëse s'munesh me u kthynë shpi të babës, institucionet të përkrahin”.⁴⁸⁶

“Learta”: “Gjëja e parë që një person trans e mbijetuar e dhunës në familje kishte me pasë nevojë prej institucioneve shtetërore është vëmendja. Vëmendje nga policia, nga shërbimet sociale. Së dyti, ajo ka nevojë për strehë dhe fjalë inkurajuese sepse është keqtrajtu, pavarësisht nëse ka përjetu dhunë prej burrit të saj ose prej anëtarëve tjerë të familjes. Dhe ajo duhet me ditë se cilat janë të drejtat e saj; policia dhe të tjerët duhet me e informu atë për të drejtat e saj”.⁴⁸⁷

“Nita” nga Prishtina: “Policët që janë për dhunë në familje me kon taman e trajnum për krejt format e dhunës në familje, sidomos për dhunë psikologjike, [...] Mënyra e qasjes të policive me kon ma e butë, jo në mënyrë kërcënuese, jo në mënyrë të vrazhdë. Ata nuk duhet me të bo ty mu ni të kërcënime ose me të bo ty mu ni e pavlerë; kur ti mundohesh me i kallxu diçka që të ka ndodhë e ajo ta jep mendimin e vet paragjykes, kjo s'duhet me ndodhë.”.⁴⁸⁸

“Pati”, një grua trans nga Prizreni: “Policia duhet të jetë më e butë dhe më miqësore me personat LGBTI. Edhe ne jemi qenie njerëzore; ne kemi zemra dhe mendje dhe meritojmë të mbrohemi dhe të jetojmë të lirë”.⁴⁸⁹

“Diella” nga Prishtina: “Duhet me u trajnu punëtorët socialë për punën që e bajnë me viktimat, duhet me ditë që nuk shkon dikush aty [për ndihmë] që nuk është viktimitë; një gru që dokët e fortë, nuk don me thanëqëajo nuk është viktimitë. Duhet me i besu çka janë tu thanë viktimat”.⁴⁹⁰

“Syzana” nga Prishtina: “Dua me pasë një zgjidhje prej institucioneve për me pasë ni jetë temen. Du me pasë një banesë; nuk po thom ni banesë të madhe, veç ni kuzhinë, ni dhomë të vogël, një banjo.. Nuk du mu kthy [tek ai]”.⁴⁹¹

Nga 20 të mbijetuara të intervistuarat për këtë raport, 19 kishin duruar dhunë për shumë vite përpara se të kërkonin ndihmë.⁴⁹² Për 30 vjet, “Mejremi” vuajti dhunë të vazhdueshme brutale fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale nga duart e bashkëshortit. Më në fund ajo e denoncoi pasi ai tentoi ta vriste, duke i

⁴⁸⁶ Intervistë me “Anën” (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

⁴⁸⁷ Intervistë me “Leartën” (emri është ndryshuar për anonimitet), nëntor 2022.

⁴⁸⁸ Intervistë me “Nitën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

⁴⁸⁹ Intervistë me “Patinn” (emri është ndryshuar për anonimitet), tetor 2022.

⁴⁹⁰ Intervistë me “Diellën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

⁴⁹¹ Intervistë me “Syzanenën” (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

⁴⁹² Intervista me të mbijetuarat “Syzana”, “Edona”, “Gresa A”, “Eliza”, “Kaltrina”, “Dina”, “Filloreta”, “Maja”, “Vjollca”, “Gresa B”, “Diella”, “Nita”, “Andi”, “Pati”, “Merjem”, “Arjeta”, “Learta”, “Diana”, “Ana” (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-dhjetor 2022.

shkaktuar lëndime të rënda në kokë dhe në trup. "Për 30 vjet kom hangër ma shumë gjak se bukë", tha ajo. Pesë të mbijetuara të intervistuar kishin raportuar rastet e tyre vetëm kur filluan të kishin frikë se dhunuesi i tyre mund t'i vriste.⁴⁹³

Kur u pyetën se çfarë këshillash kanë për të mbijetuarat e tjera të dhunës në familje, pothuajse të gjitha thanë se duhet ta raportojnë dhunën në polici dhe të largohen nga dhunuesi menjëherë pas incidentit të parë të dhunës. Megjithatë, ato përmendën gjithashtu se sigurimi i mbështetjes financiare dhe strehimit alternativ është parakusht që duhet plotësuar para largimit nga një situatë e dhunës në familje.

"Shoqnia mundet dhe duhet me i ndihmu ni njeri në situatën teme. Familja ndoshta është mundu mrena mundësive të veta me ndihmu, por është shoqëria ajo që mundet me i ndihmu një njeri në situatën teme qoftë financiarisht, qoftë në aspekte të tjera si p.sh. përmes ofrimit të mbështetjes ligjore falas", tha "Kaltrina" nga Podujeva.⁴⁹⁴

"Nita" nga Prishtina: Në momentin e parë që ja nisë me luft me menje tane, që ja nis me t'nënçmu e me ta hupë vetbesimin, ik veç ik prej atij njeri! [...] Para se me dalë mas pari siguron finanacat, kado që të është, bile dikush me të pritë, venin me siguru me kon e sigurtë që kur të ik prej tina edhe direkt me fillu jetën sikur s'ka ekzistu hiç ajo pjesë e jetës tane!⁴⁹⁵

"I kisha lutë gratë që kanë dhunë mos e duroni dhunën, ik prej tina! Por duhet me na ndihmu, kena nevojë për naj banesë me na pagu bile nja nji muj a dy deri sa ta marrim veten.", tha Gresa A.⁴⁹⁶

"Diana", e mbijetuar e dhunës në familje dhe nënë e vetme e dy fëmijëve, konfirmoi: "Hapi i parë është pavarësia financiare. Është ndihmesë nëse një gru i ka paret e saj. Mirëpo, kur burrat nuk e paguajnë alimentacionin për fëmijët, shteti duhet me ndërhy dhe me ia ba pagesat grave, në mënyrë që ato me mujt me mbijetu dhe të mos me metë nën mëshirën e burrave. Masanej, duhet me qenë përgjegjësi e shtetit me t'i ndjekë burrat për me kthy borxhin që ia kanë shtetit".⁴⁹⁷

⁴⁹³ Intervista me "Mejremin", "Dianën", "Nitën", "Kaltrinën", "Leartën", (emrat janë ndryshuar për anonimitet), gusht-shtator 2022.

⁴⁹⁴ Intervistë me "Kaltrinën" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

⁴⁹⁵ Intervistë me "Nitën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

⁴⁹⁶ Intervistë me "Gresën A" (emri është ndryshuar për anonimitet), gusht 2022.

⁴⁹⁷ Intervistë me "Dianën" (emri është ndryshuar për anonimitet), shtator 2022.

REKOMANDIME

Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të përmirësuar përgjigjen e shtetit të Kosovës ndaj dhunës në familje – përmes harmonizimit të mëtejshëm të kornizës ligjore me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe miratimit të një strategjie kombëtare për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave – hulumtimi i Amnesty International zbuloi se politikat ekzistuese po dështojnë të përmbushin obligimet ndaj të mbijetuarave në shumë mënyra. Përgjigjia e shtetit fokusohet kryesisht në sistemin e drejtësisë penale dhe të mbijetuarat inkurajohen të raportojnë dhunën në polici. Në të njëjtën kohë, sistemi po dështon të sigurojë që të mbijetuarat të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me nevojat, shqetësimet dhe prioritetet e tyre për shkak të mungesës së burimeve të institucioneve kyçe, mungesës së stafit dhe mungesës së kapaciteteve profesionale për të trajtuar raste të tilla në një mënyrë të ndjeshme gjinore. Për më shumë, aspekte të tjera thelbësore të përgjigjes ndaj dhunës në familje po anashkalohen dhe neglizhohen. Ato përfshijnë vendosjen e politikave shumë të nevojshme për t'u ofruar të mbijetuarave mbështetje të mjaftueshme për aq kohë sa të jetë e nevojshme, të tilla si qasja me prioritet në strehim social ose publik dhe trajnimin profesional dhe forma tjera të mbështetjes për t'i fuqizuar ato të jetojnë të pavarura dhe të lira nga dhuna në afat të gjatë. Një aspekt tjetër i anashkaluar është parandalimi, i cili aktualisht është i kufizuar në fushata sporadike të ndërgjegjësimit publik, por i mungon një qasje sistematike. Qasja e tillë duhet të përfshijë të rinjtë në shkollë përmes ofrimit të edukimit gjithëpërfshirës seksual ose një formë tjetër të edukimit të bazuar në të drejtat e njeriut.

PËR QEVERINË E KOSOVËS

Lidhur me pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe të të mbijetuarave në zhvillimin e ligjeve dhe politikave mbi dhunën në familje

- Të sigurojë që politikat shtetërore në përgjigje të dhunës në familje të jenë mjaftueshëm të përqendruara te të mbijetuarat dhe të pasqyrojnë gamën e plotë të shqetësimeve dhe nevojave të të mbijetuarave, në lidhje me të drejtat, dinjitetin dhe agjencinë e të mbijetuarave. Për këtë qëllim, duhet të sigurohet një pjesëmarrje domethënëse e të mbijetuarave dhe organizatave të shoqërisë civile gjatë procesit të zhvillimit të ligjeve dhe politikave ose masave të tjera për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Çdo ndryshim në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Lidhur me strehimoret

- Të sigurojë që strehimoret në të gjithë vendin të kenë kapacitete të mjaftueshme për të akomoduar të gjitha të mbijetuarat që kanë nevojë për mbrojtje, strehim të përkohshëm dhe shërbime mbështetëse, sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për këtë qëllim, të sigurojë që strehimoret të financohen dhe të kenë burime adekuate dhe të vazhdueshme, dhe të jenë të disponueshme me një shtrirje të arsyeshme gjeografike proporcionale me popullsinë.
- Të intensifikojë përpjekjet për krijimin e strehimores së re të specializuar të propozuar për personat LGBTI. Ndërkohë, të sigurojë që të mbijetuarit LGBTI të dhunës në familje të kenë qasje në strehim tjetër të sigurt, mbështetje psikosociale dhe forma tjera të mbështetjes së nevojshme për të qenë në gjendje të largohen nga familjet ose partnerët abuzues.
- Të konsiderojë krijimin dhe mbështetjen e një rrjeti kombëtar strehimorësh dhe shërbimesh të tjera mbështetëse për të integruar dhe përmirësuar standardet e shërbimit, duke funksionalizuar një sistem kombëtar të mbledhjes së të dhënave dhe duke krijuar mundësi për ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira.

- Të sigurojë që rregullat e strehimoreve të respektojnë të drejtat dhe agjencinë e të mbijetuarave dhe të mos çojnë në viktimizim dytësor.
- Të sigurojë që strehimoret të ofrojnë trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm për stafin e tyre në kryerjen e vlerësimeve individuale të rrezikut dhe zhvillimin e një plani individual të sigurisë për çdo të mbijetuar, me synimin për t'ua lejuar atyre që kanë raste me rrezik të ulët të kontaktojnë familjet dhe shoqërinë më shpesh dhe pa mbikëqyrjen e stafit të strehimores.

Lidhur me parandalimin

- Të bëjë fushata të edukimit publik për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e publikut të gjerë për manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave, sipas Konventës së Stambollit. Për këtë qëllim, të japë gjithashtu informata mbi masat e disponueshme për të parandaluar akte të tilla dhune.
- Të inkurajojë mediat që të eliminojnë diskriminimin gjinor dhe format e tjera të diskriminimit, duke përfshirë portretizimin e dëmshëm dhe stereotipik të grave ose grupeve specifike të grave, veçanërisht në raportimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Lidhur me arrestimet e dyfishta

- Të mbledhë dhe të publikojë të dhënat anonime për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet të arrestuarve, ndër karakteristikat e tjera përkatëse.

Lidhur me qasjen në informata

- Të sigurojë që Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të krijojnë dhe mirëmbajnë një linjë të specializuar 24-orëshe ndihmëse që ofron informata dhe referime përkatëse për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe zotimet në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore (2022-2026). Të sigurojë që linja ndihmëse të jetë falas, anonime, konfidenciale, e disponueshme gjatë gjithë kohës, në të gjithë territorin dhe në të gjitha gjuhët përkatëse dhe formatet e qasshme, e aftë për të ofruar këshillim për viktimat dhe e operuar nga stafi i kualifikuar dhe i trajnuar.

PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME DHE POLICINË E KOSOVËS

Lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga policia

- Të sigurojnë që policia të jetë e trajnuar në mënyrë adekuate për t'u ofruar të mbijetuarave të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me mekanizmat e disponueshëm të mbrojtjes, shërbimet mbështetëse dhe ndihmën ligjore.
- Të sigurojnë që policia të ofrojë përgjigje profesionale dhe të ndjeshme ndaj gjinisë kur merret me rastet e dhunës në familje për të shmangur stigmatizimin dhe viktimizimin dytësor të viktimave gjatë të gjitha procedurave ligjore, përfshirë gjatë marrjes në pyetje, mbledhjes së provave dhe procedurave të tjera në lidhje me hetimin. Kjo kërkon një sërë masash, duke përfshirë:
 - trajnimin e shënjestruar të zyrtarëve policorë dhe hetuesve për të gjitha format e dhunës në familje, në veçanti dhunën psikologjike dhe ekonomike, si dhe mjetet dhe metodat për identifikimin e saj, hetimin dhe mbledhjen e provave; dhe
 - promovimin e qasjeve të përqendruara te të mbijetuarat dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për intervistimin e viktimave dhe mbledhjen e dëshmive.
- Të sigurojnë që çdokush, pavarësisht orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes gjinore ose karakteristikave gjinore, të mund të ushtrojë të drejtën për të pasur mbrojtjen e shtetit nga dhuna, diskriminimi dhe dëmet e tjera, qofshin ato të kryera nga zyrtarë shtetërorë ose nga ndonjë individ apo grup.
- Të sigurojnë që dispozitat kundër diskriminimit të bëhen pjesë integrale e procedurave standarde operative të policisë dhe të ekzistojnë mekanizma të ankimit që janë të përshtatshëm dhe të qasshëm për raportimin e trajtimit jo të duhur të rasteve nga policia.
- Të sigurojnë që të gjithë zyrtarët policorë që merren me rastet e dhunës nga partneri intim dhe të dhunës në familje, përveç trajnimit të detyrueshëm, të marrin trajnime të rregullta për ngritjen e

vazhdueshme të kapaciteteve, të dizajnuara në bashkëpunim me organizatat që punojnë me të mbijetuarat. Ndër të tjera, një trajnimet duhet të përfshijnë:

- o dispozitat ligjore dhe rolin e institucioneve përkatëse në përgjigjen e shtetit ndaj dhunës në familje;
 - o të kuptuarit e shkaqeve rrënjësore të dhunës, duke përfshirë dinamikën e pushtetit gjinor që ngërthehet brenda dhunës nga partneri intim, të nxitur nga diskriminimi dhe pabarazia gjinore strukturore dhe e rrënjësore thellë, dhe stereotipet dhe normat e dëmshme gjinore që ndikojnë në qëndrimet shoqërore dhe perceptimet e dhunës, duke përfshirë brenda policisë;
 - o përqendrimi në efektet e traumës mbi viktimat dhe eliminimin e faktorëve që shkaktojnë riviktimizimin; rëndësia e një qasjeje të ndjeshme gjinore dhe që vendos të mbijetuarat në qendër dhe çfarë do të thotë ajo në praktikë për policinë; dhe
 - o një perspektivë kundër diskriminimit, duke përfshirë informatat për të drejtat e personave LGBTI.
- Të lejojnë viktimat e dhunës në familje, veçanërisht viktimat LGBTI, të raportojnë rastet e tyre në stacione të tjera të policisë jashtë vendbanimit të tyre, pa zbatuar kompetencën e rreptë territoriale të policisë, si masë mbrojtëse kundër trajtimit potencialisht të njëanshëm nga policia.
 - Të sigurojnë që protokollet për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe programet e trajnimit për zyrtarët e zbatimit të ligjit të monitorohen, rishikohen dhe përshtaten rregullisht për të siguruar efektivitetin e tyre.

Lidhur me urdhrat mbrojtës

- Ministria e Drejtësisë duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, duke përfshirë edhe financimin adekuat për ta zbatuar atë.
- Policia duhet të sigurojë që urdhrat mbrojtës të monitorohen me rreptësi dhe të zbatohen.
- Policia duhet të sigurojë që të mbijetuarat të jenë të informuara siç duhet për gamën e gjerë të masave në dispozicion të tyre përmes urdhrave mbrojtës, duke përfshirë largimin e dhunuesit nga banesa/shtëpia e përbashkët, siç parashikohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, masat e përkohshme të pagesës së qirasë dhe alimentacionit.

Lidhur me arrestimet e dyfishta

- Të kërkojnë nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të japin shpjegim të detajuar për çdo arrestim të dyfishtë në rastet e dhunës në familje dhe të japin prova të qarta që mbështesin arrestimin e të dy partnerëve. Raporti duhet të shqyrtohet nga një mbikëqyrës i trajnuar dhe me njohuri për dhunën me bazë gjinore përpara se të shkojë në prokurori.
- Të mbledhin dhe të publikojnë të dhëna anonime për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënies ndërmjet të arrestuarve, ndër karakteristikat e tjera përkatëse.

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË

Lidhur me qasjen në informata

- Të ofrojë informata gjithëpërfshirëse dhe të qasshme mbi shërbimet dhe burimet në dispozicion për viktimat e dhunës në familje në mënyrë të vazhdueshme, përmes kanaleve të ndryshme, me përpjekje specifike për t'i informuar të mbijetuarat që përballen me forma të shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit, duke përfshirë të mbijetuarat nga komunitetet serbe, rome, ashkali dhe kosovaro-egjiptiane, të mbijetuarit LGBTI, personat që jetojnë në zona të largëta ose rurale dhe të mbijetuarat me aftësi të kufizuara.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në dëshmipërblim

- Të zhvillojë informata të qasshme në lidhje me Fondin e Kompensimit të Viktimave dhe t'i shpërndajë të mbijetuarat e dhunës në familje, në një gjuhë dhe format që e kuptojnë, dhe të sigurojë që mbrojtësit e viktimave, prokurorët dhe gjykatat të informojnë të gjitha viktimat për të drejtën e tyre për të kërkuar kompensim dhe të përcaktojnë qartë procesin e aplikimit dhe çfarë kërkohet.

Lidhur me hartimin e ligjeve dhe politikave

- Të sigurojë që organizatat e shoqërisë civile dhe të mbijetuarat e dhunës në familje të konsultohen në mënyrë domethënëse gjatë procesit të zhvillimit të masave të nevojshme legislative dhe politike, ose masave të tjera për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Të sigurojë që çdo ndryshim në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të jetë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Lidhur me Qendrat për Punë Sociale

- Të sigurojë burime të mjaftueshme dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve për stafin e Qendrave për Punë Sociale për të trajtuar rastet e dhunës në familje në mënyrë të ndjeshme, profesionale, efikase, pa vonesa të panevojshme dhe duke respektuar të drejtat, dinjitetin dhe agjencinë e të gjitha të mbijetuarave për të parandaluar viktimizimin dytësor dhe për të çrrënjësuar praktikën diskriminuese dhe aplikimin e stereotipeve të dëmshme gjinore. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë njohuri dhe aftësi për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të dhunës në familje; qasjen që vendos të mbijetuarat në qendër dhe zbatimin praktik të saj në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; stereotipet e dëmshme gjinore dhe të tjera; dinamikën gjinore të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; dhe ndikimin e dëmshëm të fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës. Trajnimi duhet të zhvillohet në konsultim të ngushtë me organizatat e të mbijetuarave, organizatat për të drejtat e grave dhe organizatat LGBTI dhe duhet të pasqyrojë shqetësimet specifike të kontekstit të të mbijetuarave në Kosovë.
- Të sigurojë që stafi i Qendrave për Punë Sociale të mos ushtrorë trysni të tërthortë ose të drejtpërdrejtë mbi të mbijetuarat për t'u kthyer në situata abuzive ose për t'u pajtuar me abuzuesit e tyre.
- Të zhvillojë dhe promovojë protokolle dhe trajnime për profesionistët për parandalimin dhe përgjigjen ndaj martesave të detyruara.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në dëmshpërblim

- Të marrë masa të mëtejme për të garantuar qasjen në dëmshpërblim për të mbijetuarat e dhunës në familje, veçanërisht duke siguruar që gjykatat të përdorin legjislacionin ekzistues për të dhënë kompensim në procedura gjyqësore penale.

PËR MINISTRINË E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE

Lidhur me strehimoret

- Siç rekomandon GREVIO i KE-së, të sigurojë fonde adekuate, të sigurt dhe të qëndrueshme për strehimoret për të garantuar që ato të mund të ofrojnë shërbime dhe mbështetje të përgjithshme dhe të specializuara për të mbijetuarat e dhunës në familje. Praktika e mirë përfshin sigurimin e një financimi të tillë përmes kontratave shumëvjeçare të cilat përshkruajnë standardet dhe kushtet e aplikueshme dhe parashikojnë monitorim dhe raportim të rregullt në lidhje me financat dhe zbatimin e standardeve.
- T'u sigurojë strehimoreve fonde për aktivitete jothelbësore si ndërgjegjësimi i publikut, avokimi, ngritja e kapaciteteve të stafit dhe trajnime profesionale të mbijetuarave të strehuara në strehimore.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në mbrojtje sociale

- Të sigurojë vendosjen e masave për të garantuar që të mbijetuarat e dhunës në familje dhe vartësit e tyre të kenë mundësi t'i qasen të drejtës së tyre për një standard të përshtatshëm jetese dhe pune, duke përfshirë edhe masat e synuara të mbrojtjes sociale. Masa të tilla duhet të jenë të arritshme dhe kriteret e përshtatshmërisë duhet të marrin parasysh realitetin e jetuar të të mbijetuarave, për shembull kur çështja mund të jetë në pritje në gjykatë, ose kur ato ende nuk e kanë paraqitur rastin në polici.
- Të sigurojë që të ketë një rrugëdalje të qartë nga marrëdhëniet abuzive për të mbijetuarat e dhunës në familje. Për këtë qëllim, të sigurojë që të mbijetuarat dhe vartësit e tyre të mbështeten me strehim urgjent dhe strehim social afatgjatë, aty ku është e mundur. Të mbijetuarat e dhunës në familje duhet të jenë ndër personat e trajtuar me prioritet për ndarjen e banesave sociale.
- Të sigurojë ndërmarrjen e hapave për zbatimin e zotimeve në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2022-2026) për të ofruar trajnim profesional dhe për të lehtësuar qasjen në mundësi punësimi për të mbijetuarat e dhunës në familje.

PËR MINISTRINË E ARSIMIT

Lidhur me parandalimin

- Të sigurojë edukim seksual gjithëpërfshirës të detyrueshëm, të përshtatshëm për moshën, të ndjeshëm ndaj gjinisë, të bazuar në fakte dhe shkencërisht të saktë për nxënësit dhe studentët e të gjitha gjinive në të gjitha nivelet e arsimit dhe për ata jashtë sistemit arsimor.
 - Kjo duhet të përfshijë edukimin për pëlqimin, autonominë trupore dhe seksuale dhe të drejtën për integritet trupor.
 - Gjithashtu duhet të shënjestrojë stereotipet e dëmshme për rolet gjinore dhe të promovojë vlerat e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë maskulinitetet jo të dhunshme, përmes integritetit të përmbajtjes mbi barazinë gjinore në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit, publik dhe privat, që nga fëmijëria e hershme e tutje dhe në programet arsimore me qasje të të drejtave të njeriut. Programe të tilla duhet të monitorohen, vlerësohen dhe rishikohen periodikisht.

PËR ZYRËN E KRYEPROKURORIT TË SHETIT

Lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje nga prokurorët

- Të sigurojë që prokurorët të marrin një qasje më proaktive në rastet e dhunës në familje dhe të mund të ofrojnë një përgjigje profesionale dhe të ndjeshme gjinore kur merren me rastet e dhunës në familje për të shmangur stigmatizimin dhe viktimizimin dytësor të viktimave gjatë të gjitha procedurave ligjore, duke përfshirë gjatë marrjes në pyetje, mbledhjes së provave dhe procedurave të tjera që lidhen me hetimin. Kjo kërkon një sërë masash, duke përfshirë:
 - trajnimin e shënjestruar të prokurorëve për të gjitha format e dhunës në familje, përfshirë dhunën psikologjike dhe ekonomike, si dhe mjetet dhe metodat për ta identifikuar, dëshmuar dhe ndjekur penalisht; dhe
 - promovimin e qasjes së përqendruar të mbijetuarat dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për intervistimin e viktimave dhe mbledhjen e dëshmive.

Lidhur me arrestimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje

- Të sigurojë që prokurorët të shqyrtojnë me kujdes kallëzimet penale nga policia në rastet e arrestimit të dyfishtë në rastet e dhunës në familje dhe të shqyrtojnë nëse mund të ketë pasur përdorim të vetëmbrojtjes.
- Të mbledhë dhe të publikojë të dhëna anonime për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet të arrestuarve, ndër karakteristikat e tjera përkatëse.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në dëshmipërblim dhe dhënies fund të mosdëshkimit për kryesit

- Të sigurojë që Zyrat për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në të gjithë vendin të kenë staf dhe burime të mjaftueshme, dhe të kryejë trajnime për ngritjen e kapaciteteve me mbrojtësit e viktimave për të përmirësuar performancën e tyre dhe për t'ua mundësuar t'i plotësojnë nevojat e të mbijetuarave.

PËR ZYRËN E MBROJTËSVE TË VIKTIMAVE

Lidhur me qasjen e viktimave në dëshmipërblim

- Të sigurojë që të mbijetuarat e dhunës në familje të jenë të informuara dhe të marrin ndihmën e nevojshme për të bërë kërkesa për kompensim sipas kërkesave ligjore për marrjen e dëshmipërblimit në proceset gjyqësore penale.

Lidhur me rastet e dhunës nga partneri intim ku të dyja palët akuzohen për dhunë në familje

- Të mbledhë dhe të publikojë të dhëna anonime për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet të arrestuarve, ndër karakteristikat e tjera përkatëse.

PËR AKADEMINË E DREJTËSISË

- Të sigurojë që gjyqtarët dhe prokurorët të marrin trajnime të rregullta në të drejtën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut rreth shqiptimit të sanksioneve efektive proporcionale dhe

dekurajuese në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke u mbështetur në praktikat më të mira. Trajnimi duhet të përfshijë gjithashtu njohuri për të gjitha format e dhunës në familje, duke përfshirë dhunën psikologjike dhe ekonomike; natyrën gjinore të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, stereotipet e dëmshme gjinore që mbështesin një dhunë të tillë dhe promovimin e qasjeve të përqendruara të mbijetuarat dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për trajtimin e rasteve të tilla, marrjen në pyetje/intervistimin e viktimave dhe mbledhjen e dëshmive për të parandaluar viktimizimin dytësor dhe për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave, dinjitetit dhe mëvetësisë së viktimave.

- Të sigurojë që gjyqtarët të marrin trajnime të rregullta në lidhje me ndarjen e pasurisë martesore dhe alimentacionin.
- Të sigurojë që zyrtarët e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët të jenë të trajnuar dhe të përgatitur për të trajtuar rastet e dhunës nga partneri intim dhe dhunës ndaj grave në familje dhe të jenë në gjendje të identifikojnë përdorimin e vetëmbrojtjes në mënyrë që të minimizohet arrestimi i dyfishtë ose i gabuar i viktimave.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në dëshmipërblim

- Të sigurojë që mbrojtësit e viktimave të marrin trajnime shtesë për të informuar dhe ndihmuar më mirë viktimat e dhunës në familje drejt kërkimit të kompensimit brenda procedurave penale, si dhe në përdorimin e rrugëve të tjera ligjore në dispozicion për të ushtruar të drejtën e tyre për kompensim.

PËR GJYQËSORIN

Lidhur me alimentacionin

- Të sigurojë që gjykatat t'i japin prioritet nxjerrjes së vendimeve për alimentacionin në kohën e duhur, duke ndjekur praktikën e mirë në përcaktimin e shumës bazuar në një vlerësim real aq sa është e mundur të të ardhurave të kryesit dhe të vendosin mekanizma efektivë për zbatimin e vendimeve të tilla në rastet kur kryesit refuzojnë të paguajnë alimentacionin.

Lidhur me urdhrat mbrojtës

- Të sigurojë që të mbijetuarat të jenë të informuara siç duhet për gamën e gjerë të masave në dispozicion të tyre nëpërmjet urdhrave mbrojtës, duke përfshirë masat e përkohshme të pagesës së qirasë dhe alimentacionit.
- Të konsiderojë marrjen e masave më të larmishme mbrojtëse për të garantuar mbrojtje dhe siguri të menjëhershme, si dhe marrjen e masave për të garantuar mirëqenien e të mbijetuarave të dhunës në familje.
- Të sigurojë që urdhrat mbrojtës të lëshohen në një mënyrë që zbaton Ligjin në fuqi për mbrojtjen nga dhuna në familje, ku thuhet se kryesi i dyshuar duhet të largohet nga objektet e përbashkëta të banimit dhe që gjykatat të mos e urdhërojnë kryesin e dyshuar të ndajë banesën me viktimën.
- Të sigurojë që urdhrat mbrojtës t'ua ndalojnë kryesve qëndrimin në afërsi të viktimës.

Lidhur me qasjen e të mbijetuarave në dëshmipërblim dhe dhënies fund të pandëshkueshmërisë ndaj kryesve

- Të sigurojë që dënimet për kryesit e dhunës në familje të jenë në përpjesëtim me peshën e veprës penale, proporcionale, efektive dhe dekurajuese dhe të mos kontribuojnë në vazhdimësinë e një klime mosdëshkimi. Për këtë qëllim, gjyqësori duhet të zbatojë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme dhe të monitorojë zbatimin e tij në mënyrë periodike, në bashkëpunim me organizatat e të mbijetuarave.

Lidhur me transparencën dhe të drejtën për privatësi

- Të sigurojë që vendimet të publikohen brenda kornizës kohore ligjore.
- Të rishikojë të gjitha vendimet e publikuara të gjykatës dhe të heqë të dhënat personale ose informata të tjera që identifikojnë viktimat, si emri i kryesit, numri i telefonit ose informata të tjera identifikuese indirekte, për të mbrojtur të drejtën e viktimave për privatësi.

Lidhur me rastet e dhunës nga partneri intim ku të dyja palët akuzohen për dhunë në familje

- Të shqyrtojë me kujdes faktet dhe provat në rastet e dhunës nga partneri intim dhe të kontrollojë aktakuzat madje edhe në rastet kur të dyja palët pranojnë fajësinë. Gjyqësori duhet të vlerësojë me

kujdes nëse aktet e dhunshme të kryera në përgjigje të dhunës përbëjnë vetëmbrojtje, duke marrë parasysh siç duhet dinamikat e pushtetit të bazuara në gjini dhe ndërthurjen e tyre me pabarazitë e tjera, ndërmjet partnerëve intimë.

- Të mbledhë dhe të publikojë të dhëna anonime për arrestimet dhe dënimet e dyfishta në rastet e dhunës në familje. Këto të dhëna duhet të ndahen sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe marrëdhënieve ndërmjet të arrestuarve, ndër karakteristikat e tjera përkatëse.

PËR KUVENDIN

- Të ndryshojë Kodin e ri të Procedurës Penale në mënyrë që gjykatat të mund të urdhërojnë Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimeve t'ua paguajnë dëmshpërblimin viktimave të krimeve drejtpërdrejt në rastet kur kryesit nuk janë në gjendje të paguajnë.
- Të sigurojë, në përputhje me rekomandimet e Raportuesit Special të OKB-së për të drejtën për strehim të përshtatshëm, që legjislacioni për dhunën në familje njih lidhjen me të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe përfshin mbrojtje ligjore për të mbijetuarat dhe vartësit e tyre për të realizuar këtë të drejtë, duke përfshirë përmes ofrimit të strehimit alternativ të përshtatshëm për të mbijetuarat dhe vartësit e tyre.
- Të sigurojë që Ligji i ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje të përfshijë përkufizime të të gjitha formave të dhunës në familje, përfshirë dhunën psikologjike dhe ekonomike.
- Të sigurojë që Kodi Civil të përfshijë dispozita që rregullojnë ndarjen e barabartë të pasurisë së përbashkët bashkëshortore për të gjitha çështjet gjyqësore në prit

**AMNESTY INTERNATIONAL
ËSHTË LËVIZJE
GLOBALE
PËR TË DREJTAT
E NJERIUT.
KUR PADREJTËSIA
I NDODHË NJË PERSONI,
KA RËNDËSI
PËR NE TË GJITHË.**

CONTACT US



info@amnesty.org



+44 (0)20 7413 5500

JOIN THE CONVERSATION



www.facebook.com/AmnestyGlobal



[@Amnesty](https://twitter.com/Amnesty)

NGA LETRA NË PRAKTIKË

KOSOVA DUHET T'I PËRMBUSHË ZOTIMET NDAJ TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë, shumica e të cilave janë gra dhe vajza, përballen me pasiguri dhe mungesë të mbështetjes kur provojnë të largohen nga situatat abuzive. Mbështetja e ofruar nga shteti është e pamjaftueshme për t'ia mundur të jetojnë të pavarura, që i detyron ato të kthehen në situata abuzive, në rrethin vicioz të dhunës.

Ekziston një mundësi monumentale për Kosovën për ta ndryshuar këtë. Qeveria e tanishme e ka bërë adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave prioritet të qartë nacional dhe është zotuar që këtë ta bëjë duke marrë një qasje që vë në qendër të mbijetuarën. Në nëntor 2020, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Kushtetutën e vendit për t'i dhënë zbatim të drejtëpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventën e Stambollit).

Megjithatë, hulumtimi i Amnesty International gjeti se këto përpjekje kanë qenë të pamjaftueshme. Pavarësisht zotimit të fuqishëm, shteti po dështon t'i përmbushë detyrimet për të drejtat e njeriut dhe të ndërmarrë masat e duhura në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Këto kërkojnë nga Kosova që të zbatojë politika parandaluese dhe të sigurojë që të mbijetuarat të kenë mbrojtje të mjaftueshme e të përshtatshme, të kenë mbështetje për t'u larguar nga situatat abuzive dhe qasje në drejtësi, në dëmshpërbim në përputhje me nevojat dhe prioritetet e tyre.